



KOLANA: DOKUMENTET E KISHËS KATOLIKE

1. Karta e të Drejtave të Familjes
2. Bashkësia Familjare (*Familiaris Consortio*)
3. Kisha nga Eukaristia (*Ecclesia de Eucharistia*)
4. Rerum Novarum
5. Paqja në Tokë (*Pacem in Terris*)
6. Hyji është Dashuri (*Deus caritas est*)
7. Zhvillimi i popuive (*Populorum Progressio*)
8. Besimtarët laikë të Krishtit (*Christifideles laici*)
9. Sakramenti i dashurisë (*Sacramentum Caritatis*)
10. Lufta kundër korrupsionit
11. Dashuria në të Vërtetën (*Caritas in Veritate*)
12. Dinjiteti i Gruas (*Mulieris Dignitatem*)
13. Fjala e Zotit (*Verbum Domini*)
14. Dhuratë dhe Mister (*Papa Gjon Pali II*)
15. Evangelii Nuntiandi (*Papa Pali VI*)
16. Novo Millennio Ineunte (*Papa Gjon Pali II*)
17. Besoj. Koment i shkurtër i Besojmës
Apostolike (*Imzot Angelo Massafra*)
18. Lumen Fidei - Drita e Fesë (*Papa Françesku*)
19. Gëzimi i Ungjillit - *Evangelii Gudium*
(*Papa Françesku*)
20. Bashkësia Familjare - *Familiaris Consortio*
(*Ribotim*)
21. Fytyra e Mëshirës - *Misericordie Vultus*
(*Papa Françesku*)
22. Ti qofsh lëvduar - *Laudato si'* (*Papa Françesku*)

LETRA ENCIKLIKE

TI QOFSH LËVDUAR

E ATIT TË SHENJTË
FRANÇESKUT

MBI KUJDESHIN
PËR SHTËPINË E PËRBASHKËT



Nën kujdesin
e Arqipeshkvisë Shkodër - Pult
Dhjetor 2015

Përkthyesë
Angjelina Gjeka

Korektor
Dom Prekë Lazri

Redaktore
Emanuela Marku Matija

Faqosja dhe grafikat
Luigj Mila

© Copyright
www.vatican.va

© Copyright në shqip
Arqipeshkvia Metropolitane
Shkodër - Pult

Shtypur
Shtypshkronja “Volaj”

Dhjetor 2015

PARAQITJE

Ai që, sikurse unë, është rritur dhe ka jetuar në një mjedis françeskan, e njeh mirë vlerën e fjalëve “Qofsh lëvduar!”. Ato na kujtojnë një stil specifik jete thellësisht ungjillore dhe bëhen pothuajse një moto për ndjekësit e Françeskut të Asizit.

Kënga e Vëllait Diell e kthen gjithë botën e krijuar te Krijuesi, ia kthen Hyjit qendërsinë e tij. Dhe nëse kjo vlente në kohët e Varfanjakut të Asizit, aq më tepër vlen sot që, prej revolucionit industrial e më tutje, e kemi përjashtuar Hyjin prej horizontit njerëzor, ndoshta pa e mohuar, por sigurisht duke e lënë atë mënjanë. Tundimi i hershëm i prindërve të parë riparaqitet periodikisht në histori, ndoshta në forma të ndryshme, por me një forcë gjithnjë e më të madhe.

Poezia që buron prej zemrës së Gaztori të Hyjit është urti e pastër e të thjeshtëve, e atyre shpirtave të pastër të cilëve Hyji u dhuron urtinë e vërtetë që ta shohin të vërtetën dhe të dinë t’ua tregojnë atë të gjithëve.

Pra, mund të përfytyrohet gëzimi im duke parë

se Papa Françesku ka zgjedhur këtë titull për Enciklikën mbi Kujdesin për shtëpinë e përbashkët, Botën e krijuar. Dhe ky gëzim sot përtërihet duke ju paraqitur juve përkthimin e kësaj Enciklike në gjuhën shqipe, me shpresën që ajo të hyjë në të gjitha shtëpitë e katolikëve, para së gjithash, por edhe të të gjithë burrave e grave vullnetmirë.

Toka jonë shqiptare është një përqendrim bukurie natyrore, një dhuratë e Krijuesit ndaj neve, krijesave të tij: kemi terrene pjellore, pyje, male, lumenj, liqene dhe detin, së bashku me panorama që, po t'i sodisim, mbetemi të mahnitur dhe pa frymë, aq e madhe është bukuria e tyre.

Si të mos mendojmë, përballë këtij spektakli të natyrës, për atë që është autori, për Hyjin? Si është e mundur që ndërsa dikush na tregon hënën me gisht ne të rrimë e të shohim gishtin në vend që të shohim hënën e cila na tregohet? Bota e krijuar është si një tabelë shumë e madhe rrugore që na kujton një të vërtetë më të madhe: Krijuesin.

Enciklika e Papa Françeskut, ndërsa na ndihmon të ngjitemi prej krijesave te Krijuesi, na jep edhe nxitje të rëndësishme që të mësojmë ta vlerësojmë botën e krijuar si dhuratë. Deliri i gjithëpushtetësisë i njeriut e bën atë shpesh ta shkatërrojë natyrën ose, të paktën, të mos kujdeset për të. Nëse Hyji e ka vënë njeriun në një shkallë më të lartë në krahasim me krijesat e

tjera, kjo nuk do të thotë se duhet t'i mposhtë ato apo t'i keqpërdorë deri në shkatërrimin e tyre. Fakti se jemi më lart, nuk na autorizon të shkatërrojmë: në të vërtetë, kjo na ngarkon me një përgjegjësi, atë që të jemi rojtarë dhe mbrojtës.

Ati i Shenjtë në Enciklikë nis nga një përshkrim i përpiktë i problematikave kryesore të lidhura me degradimin mjedisor, kujton pastaj themelet biblike të teologjisë së botës së krijuar dhe, para se të japë udhëzimet baritore, përvijon një kuadër të vizionit që njeriu i sotëm ka për vetveten, një vizion me një rrënjë antropologjike të shtrembër që është shkaku i problemit ekologjik kaq të madh në kohën që jemi duke jetuar.

Bashkohem me ndjenjat e Papa Françeskut dhe, megjithëse duke mos gjetur në Atdheun tonë të njëjtat problematika të rënda që jeton bota perëndimore, gjithsesi nuk mund të rri i palëvizur përballë rrezikut të një përvetësimi pasiv të asaj kulture materialiste e konsumiste që shoqërohen në mënyrë të pashmangshme me teknologjinë e progresin dhe që dukshëm janë duke e ndryshuar fytyrën e shoqërisë shqiptare, në të mirë e në të keq.

Por, jemi ende në kohë për ta ndrequr këtë. Nuk duhet thënë se Kisha nuk ka asgjë për të thënë në lidhje me problemet shoqërore: ajo e

shikon njerëzimin ashtu sikurse Hyji e ka shikuar dhe e ka dashur, dhe ka detyrën morale t'u tregojë burrave e grave të kohës së vet rrugën kryesore që duhet ndjekur për të arritur të mirën e vërtetë.

Duke jua paraqitur frytin e kësaj pune të gjithëve, ju nxis ta marrim në konsideratë seriozisht, të reflektojmë së bashku me Papën mbi vlerën e jetës dhe të botës së krijuar, të marrim përsipër përgjegjësitë që na takojnë si bashkëpunëtorë të Hyjit në veprën e krijimit dhe të veprojmë konkretisht për të krijuar kushtet më të përshtatshme në mënyrë që Bota e krijuar të vazhdojë ta lëvdojë veprën e Krijuesit në gjithë bukurinë dhe shkëlqimin e vet.

Edhe prej Shqipërisë sonë le të lartësohet himni drejt Qiellit: O Zoti im, ti qofsh lëvduar!

+ Angelo Massafra OFM
Arqipeshkv Metropolit i Shkodër-Pult
President i Konferencës Ipeshkvore
të Shqipërisë

1. «O Zoti im, ti qofsh lëvduar», këndonte shën Françesku i Asizit. Në këtë këngë të bukur na kujtonte se shtëpia jonë e përbashkët është edhe si një motër, me të cilën bashkëndajmë ekzistencën, dhe si një nënë e bukur, që na merr në krahët e vet: «O Zoti im, ti qofsh lëvduar për tokën nënën tonë, e cila na mbështet dhe drejton, prodhon fryte të ndryshme me ngjyra të luleve dhe të barit» .^[1]

2. Kjo motër proteston për të keqen që i bëjmë, për shkak të përdorimit të papërgjegjshëm dhe të keqpërdorimit të të mirave që Hyji ka vënë në të. Jemi rritur duke menduar se ishim zotëruesit dhe sunduesit e saj, të autorizuar që ta plaçkisim. Dhuna që është në zemrën njerëzore të plagosur prej mëkatit dëftohet edhe në simptomat e sëmundjes që ndiejmë në tokë, në ujë,

në ajër dhe në qeniet e gjalla. Prandaj, mes të varfërve më të braktisur dhe të keqtrajtuar, gjendet toka jonë e shtypur dhe e shkatërruar, që «gjëmon dhe vuan në dhimbjet e lindjes» (Rom 8,22). Harrojmë se ne vetë jemi tokë (krh. Zan 2,7). Vetë trupi ynë është i përbërë prej elementeve të planetit, ajri i tij është ai që na jep frymëmarrjen dhe uji i tij na gjallëron e na freskon.

Asgjë e kësaj bote nuk është për ne e parëndësishme

3. Më se pesëdhjetë vjet më parë, ndërsa bota lëkundej në buzë të një krize bërthamore, shën Gjoni XIII Papë shkroi një Enciklikë me të cilën nuk u kufizua vetëm që të kundërshtonte luftën, por deshi edhe të bënte një propozim paqeje. Porosinë e vet *Pacem in terris* ia drejtoi gjithë “botës katolike”, dhe shtoi “edhe të gjithë njerëzve vullnetmirë”. Tani, përballë përkeqësimit global të mjedisit, dua t’i drejtohem çdo personi që banon

në këtë planet. Në Nxitjen time *Evangelii gaudium*, u kam shkruar anëtarëve të Kishës për të nxitur një proces reforme misionare që ende duhet kryer. Në këtë Enciklikë dua në mënyrë të veçantë të hyj në dialog me të gjithë në lidhje me shtëpinë tonë të përbashkët.

4. Tetë vjet pas *Pacem in terris*, në vitin 1971, i lumi Pali VI Papë iu referua problematikës ekologjike, duke e paraqitur atë si një krizë që është «një pasojë dramatike» e veprimtarisë së pakontrolluar të qenies njerëzore: «Nëpërmjet një shfrytëzimi të pamend të natyrës, ai rrezikon ta shkatërrojë dhe të jetë edhe vetë viktimë e këtij degradimi».² Foli edhe në FAO mbi mundësinë, «nën efektin e kundërgoditjeve të qytetërimit industrial, për [...] një katastrofë të vërtetë ekologjike», duke theksuar «ngutshmërinë dhe nevojën për një ndryshim rrënjësor në sjelljen e njerëzimit», sepse «përparimet shkencore më të jashtëzakonshme, aftësitë teknike më të mahnitshme, rritja

ekonomike më e mrekullueshme, nëse nuk janë të bashkuara me një përparim të njëmendtë shoqëror e moral, në fund të fundit, kthehen kundër njeriut».^[3]

5. Shën Gjon Pali II është kujdesur për këtë temë me një interes në rritje. Në Enciklikën e tij të parë, vuri në dukje se qenia njerëzore duket se «nuk percepton domethënie të tjera të mjedisit të vet natyror, por vetëm ato që u shërbejnë qëllimeve të një përdorimi dhe konsumi të menjëhershëm».^[4] Më pas ftoi në një *kthim* ekologjik global.^[5] Por në të njëjtën kohë vuri në dukje se angazhohemi tepër pak për «të mbikëqyrur kushtet morale të një ekologjie të njëmendtë njerëzore».^[6] Shkatërrimi i mjedisit njerëzor është diçka shumë serioze, jo vetëm sepse Hyji ia ka besuar botën qenies njerëzore, por sepse vetë jeta njerëzore është një dhuratë që duhet të mbrohet nga format e ndryshme të degradimit. Çdo aspiratë për t'u kujdesur për botën dhe për ta përmirësuar atë kërkon që të

ndryshohen thellësisht «stilet e jetës, modelet e prodhimit e të konsumit, strukturat e ndërtuara të pushtetit që sot mbajnë shoqëritë».^[7] Zhvillimi i njëmendtë njerëzor ka një karakter moral dhe nënkupton respektimin e plotë të personit njerëzor, por duhet t'i kushtojë vëmendje edhe botës natyrore e «të mbajë parasysht natyrën e secilës qenie dhe lidhjen e saj të ndërsjellë në një sistem të rregulluar».^[8] Prandaj, aftësia e qenies njerëzore për ta shndërruar realitetin duhet të zhvillohet në bazë të dhurimit të parë burimor të gjërave nga ana e Hyjit.^[9]

6. Paraardhësi im Benedikti XVI përsëriti ftesën «për t'i zhdukur shkaqet strukturore të mosfunksionimeve të ekonomisë botërore dhe të rregullohen modelet e rritjes që duken të paaftha të garantojnë respektimin e mjedisit».^[10] Ai kujtoi faktin se bota nuk mund të analizohet vetëm duke izoluar një prej aspekteve të saj, sepse «libri i natyrës

është një dhe i pandashëm» dhe përfshin mjedisin, jetën, seksualitetin, familjen, marrëdhëniet shoqërore, si dhe aspekte të tjera. Si rrjedhojë, «përkeqësimi i natyrës është i lidhur ngushtë me kulturën që shëmbëllen bashkëjetesën njerëzore».

[11] Papa Benedikti na ka propozuar të pranojmë se mjedisi natyror është plot me plagë të shkaktuara nga sjellja jonë e papërgjegjshme. Edhe mjedisi shoqëror i ka plagët e veta. Por në fund të fundit të gjitha i shkaktoi e njëjta e keqe, pra i shkaktoi ideja se nuk ekzistojnë të vërteta të padiskutueshme të cilat drejtojnë jetën tonë, prandaj liria njerëzore nuk ka kufij. Harrohet se «njeriu nuk është vetëm një liri që krijohet nga vetvetja. Njeriu nuk e krijon vetveten. Ai është shpirt e vullnet, por është edhe natyrë».[12] Me shqetësim atëror na ftoi të pranojmë se krijimi dëmtohet «aty ku ne vetë jemi instancat e fundit, aty ku tërësia është thjesht pronë e jona të cilën e konsumojmë vetëm për vetveten. Shkapërderdhja e krijimit fillon aty ku nuk njohim më

asnjë instancë mbi ne, por shohim vetëm vetveten».^[13]

Të bashkuar nga i njëjti shqetësim

7. Këto ndihmesa të Papëve përmbledhin reflektimin e shkencëtarëve të panumërt, filozofëve, teologëve të organizatave shoqërore që kanë pasuruar mendimin e Kishës në lidhje me këto çështje. Por nuk mund të lëmë pas dore faktin se edhe jashtë Kishës Katolike, Kisha e Bashkësi të tjera të krishtera – ashtu si edhe besime të tjera – kanë zhvilluar një shqetësim të thellë dhe një reflektim të çmueshëm mbi këto tema që i kemi për zemër të gjithë ne. Për të cituar vetëm një shembull veçanërisht domethënës, dua të sjell shkurtimisht një pjesë të ndihmesës së Patriarkut të dashur Ekumenik Bartolomeu, me të cilin bashkëndajmë shpresën për bashkimin e plotë kishtar.

8. Patriarku Bartolomeo i është

referuar veçanërisht nevojës që secili të pendohet për mënyrën e vet të keqtrajtimit të planetit, sepse «në masën në të cilën të gjithë ne shkaktojmë dëme të vogla ekologjike», jemi të thirrur ta pranojmë «ndihmesën tonë, të vogël apo të madhe, në përshtjellimin dhe në shkatërrimin e mjedisit».^[14] Në lidhje me këtë pikë, ai është shprehur vazhdimisht në formë të vendosur dhe nxitëse, duke na ftuar t'i pranojmë mëkatet kundër krijimit: «Që qeniet njerëzore të shkatërrojnë larminë biologjike në krijimin e Hyjit; që qeniet njerëzore të dëmtojnë integritetin e tokës dhe të ndihmojnë në ndryshimin klimatik, duke e zhveshur tokën nga pyjet e saj natyrore apo duke shkatërruar zonat e saj të lagështa; që qeniet njerëzore të ndotin ujërat, dheun, ajrin: të gjitha këto janë mëkate».^[15] Sepse «një krim kundër natyrës është një krim kundër neve vetë dhe një mëkat kundër Hyjit».^[16]

9. Në të njëjtën kohë, Bartolomeo

ka tërhequr vëmendjen nga rrënjët etnike dhe shpirtërore të problemeve mjedisore, që na ftojnë të kërkojmë zgjidhje jo vetëm në teknikë, por edhe në një ndryshim të qenies njerëzore, sepse përndryshe do të përballonim vetëm pasojat. Na ka propozuar të kalojmë nga konsumi në sakrificë, nga grykësia në bujari, nga shkapërderdhja në aftësinë për të bashkëndarë, në një askezë që «do të thotë të mësojmë të japim, e jo thjesht të heqim dorë. Është një mënyrë për të dashur, për të kaluar gradualisht nga ajo që unë dua në atë për të cilën ka nevojë bota e Hyjit. Është lirim prej frikës, prej grykësisë dhe prej varësisë».^[17] Gjithashtu, ne të krishterët jemi të thirrur «ta pranojmë botën si sakrament bashkimi, si mënyrë për të bashkëndarë me Hyjin dhe me të afërmin në një shkallë globale. Është bindje e jona e përvuajtur se hyjnorja dhe njerëzorja takohen në hollësinë më të vogël të petkut pa qepje të krijimit të Hyjit, madje edhe në kokrrën e fundit të

pluhurit të planetit tonë».^[18]

Shën Françesku i Asizit

10. Nuk dua të vazhdoj në këtë Enciklikë pa sjellë një shembull të bukur dhe motivues. Kam marrë emrin e tij si udhërrëfyes dhe si frymëzim në çastin e zgjedhjes sime si Ippeshkëv i Romës. Besoj se Françesku është shembulli më i shkëlqyer i kujdesit për atë që është e dobët dhe i ekologjisë në tërësi, e jetuar me gëzim dhe njëmendësi. Është shenjt i pajtor i të gjithë atyre që studiojnë e punojnë në fushën e ekologjisë, i dashur edhe nga shumë njerëz që nuk janë të krishterë. Ai tregoi një vëmendje të veçantë ndaj krijimit të Hyjit dhe ndaj më të varfërve e të braktisurve. Donte dhe e donin për gëzimin e tij, për kushtimin e tij bujar, për zemrën e tij universale. Ishte një mistik dhe një shtegtar që jetonte në thjeshtësi dhe në një harmoni të mrekullueshme me Hyjin, me të tjerët, me natyrën dhe me vetveten. Në

të vërehet se deri në çfarë pike janë të pandashëm shqetësimi për natyrën, drejtësia ndaj të varfërve, angazhimi në shoqëri dhe paqja e brendshme.

11. Dëshmia e tij na tregon edhe se ekologjia në tërësi kërkon hapje ndaj kategorive që e tejkalojnë gjuhën e shkencave të sakta apo të biologjisë dhe na lidhin me thelbin e njerëzores. Ashtu sikurse ndodh kur dashurohemi me një person, sa herë që Françesku shikonte diellin, hënën, kafshët më të vogla, reagimi i tij ishte të këndonte, duke përfshirë në lavdin e vet të gjitha krijesat e tjera. Ai hynte në komunikim me gjithë botën e krijuar, e u predikonte madje edhe luleve dhe «i ftonte ta lëvdonin e ta donin Hyjin, si qenie të pajisura me arsye».^[19] Reagimi i tij ishte shumë më tepër se një vlerësim intelektual apo një llogaritje ekonomike, sepse për të çfarëdo krijese ishte një motër, e bashkuar me të përmes lidhjesh dashurie. Prandaj ndihej i thirrur

të kujdesej për gjithçka që ekziston. Nxënësi i tij shën Bonaventura tregonte se ai, «duke konsideruar se të gjitha gjërat kanë një zanafillë të përbashkët, ndihej i mbushur me mëshirë edhe më të madhe dhe i thërriste krijesat, sado të vogla, me emrin vëlla apo motër».

[20] Kjo bindje nuk mund të përbuzet si një romantizëm i pa arsye, sepse ndikon në zgjedhjet që përcaktojnë sjelljen tonë. Nëse ne i afrohem natyrës dhe mjedisit pa këtë hapje ndaj mahnitjes dhe ndaj mrekullimit, nëse nuk flasim më gjuhën e vëllazërisë dhe të bukurisë në marrëdhënien tonë me botën, qëndrimet tona do të jenë ato të sunduesit, të konsumatorit apo të shfrytëzuesit të thjeshtë të burimeve natyrore, i paaftë për t'u vënë një kufi interesave të veta të menjëhershme. Përkundrazi, nëse ndihemi thellësisht të bashkuar me gjithçka që ekziston, përkora dhe kujdesi do të burojnë në mënyrë të vetvetishme. Varfëria dhe vetëpërmbytja e shën Françeskut nuk

ishin një asketizëm vetëm i jashtëm, por diçka më rrënjësore: një heqje dorë nga të bërit e realitetit një objekt të thjeshtë përdorimi dhe sundimi.

12. Nga ana tjetër, shën Françesku, besnik ndaj Shkrimnit, na propozon ta njohim natyrën si një libër të shkëlqyer në të cilin Hyji na flet dhe na përçon diçka prej bukurisë së tij dhe prej mirësisë së tij: «Sepse prej madhërisë dhe bukurisë së krijesave mund të njihet me krahasim Krijuesi i tyre» (*Urt* 13,5) dhe «pushteti i tij i amshuar dhe hyjnia, atje që prej krijimit të botës, mund të shihen me anë të mendjes në saje të veprave të tij» (*Rom* 1,20). Prandaj kërkonte që në kuvend të lihej gjithmonë një pjesë e kopshtit e pakultivuar, që aty të rriteshin barërat e egra, në mënyrë që ata që do t'i admironin të mund ta lartësonin mendimin te Hyji, autori i një bukurie të tillë.^[21] Bota është diçka më shumë se një problem për t'u zgjidhur, është një mister i hareshëm që e sodisim në gëzim dhe në lavd.

Thirrja ime

13. Sfida urgjente për ta mbrojtur shtëpinë tonë të përbashkët përfshin shqetësimin për ta bashkuar gjithë familjen njerëzore në kërkimin e një zhvillimi të arsyeshëm dhe të tërësishëm, sepse e dimë se gjërat mund të ndryshojnë. Krijuesi nuk na braktis, nuk kthehet kurrë prapa në planin e tij të dashurisë, nuk pendohet se na ka krijuar. Njerëzimi ka ende aftësinë të bashkëpunojë për të ndërtuar shtëpinë tonë të përbashkët. Dëshiroj t'u shpreh mirënjohjen, t'i nxis dhe t'i falënderoj të gjithë ata që, në sektorët më të ndryshëm të veprimtarisë njerëzore, janë duke punuar për të garantuar mbrojtjen e shtëpisë që bashkëndajmë. Meritojnë një mirënjohje të veçantë ata që luftojnë me forcë për të zgjidhur rrjedhojat dramatike të degradimit mjedisor në jetën e më të varfërve të botës. Të rinjtë kërkojnë prej nesh një ndryshim. Ata pyesin se si është e mundur që të pretendohet të ndërtohet

një e ardhme më e mirë pa menduar për krizën mjedisore dhe për vuajtjet e të përjashtuarve.

14. Po drejtoj një ftesë urgjente për ta përtërirë dialogun në lidhje me mënyrën me të cilën jemi duke ndërtuar të ardhmen e planetit. Kemi nevojë për një ballafaqim që na bashkon të gjithëve, sepse sfida mjedisore që po jetojmë, dhe rrënjët e saj njerëzore, na përkasin e na prekin të gjithëve. Lëvizja ekologjike botërore tashmë ka bërë një rrugëtim të gjatë e një ecje të pasur, dhe u ka dhënë jetë grupimeve të shumta të qytetarëve që kanë favorizuar një ndërgjegjësim. Mjerisht, shumë përpjekje për të kërkuar zgjidhje konkrete për krizën mjedisore shpesh janë bërë të kota jo vetëm prej refuzimit të të fuqishëmve, por edhe prej mosinteresimit të të tjerëve. Qëndrimet që i pengojnë rrugët e zgjidhjes, edhe mes besimtarëve, shkojnë nga mohimi i problemit deri te mospërfillja, te pranimi i leverdisshëm, ose te besimi

i verbër në zgjidhjet teknike. Kemi nevojë për një solidaritet të ri universal. Siç kanë thënë Ipeshkvinjtë e Afrikës së Jugut, «talentet dhe përfshirja e të gjithëve janë të nevojshme për të ndrequr dëmin që njerëzit i kanë shkaktuar krijimit të Hyjit».^[22] Të gjithë mund të bashkëpunojmë si mjete të Hyjit për ruajtjen e krijimit, secili me kulturën dhe përvojën e vet, me nismat dhe aftësitë e veta.

15. Shpresoj që kjo Letër enciklike, e cila i shtohet Magjisterit shoqëror të Kishës, të na ndihmojë të njohim madhështinë, urgjencën dhe bukurinë e sfidës që na paraqitet. Në radhë të parë, do të bëj një përshkrim të shkurtër nëpërmjet aspekteve të ndryshme të krizës aktuale ekologjike me qëllim që të marrim frytet më të mira të kërkimit shkencor që disponojmë sot, që të lejojmë të prekemi në thellësi dhe t'i japim një bazë konkretësie rrugëtimit etik e shpirtëror që vijon. Duke nisur nga kjo panoramikë,

do të rimarr disa argumentime që dalin nga tradita judeo-e krishterë, me qëllim që t'i japim koherencë më të madhe angazhimit tonë për mjedisin. Pastaj do të përpiqem të arrij te rrënjët e situatës aktuale, në mënyrë që të gjejmë jo vetëm simptomat por edhe shkaqet më të thella të saj. Kështu do të mund të propozojmë një ekologji që, në përmasat e saj të ndryshme, të integrojë vendin specifik që qenia njerëzore zë në këtë botë dhe marrëdhëniet e saj me realitetin që e rrethon. Në dritën e këtij reflektimi do të doja të bënim një hap përpara në disa linja të gjera të dialogut e të veprimit që përfshijnë qoftë secilin prej nesh, qoftë politikën ndërkombëtare. Së fundi, meqenëse jam i bindur se çdo ndryshim ka nevojë për motivime dhe për një ecje edukative, do të propozoj disa linja pjekurimi njerëzor të frymëzuara nga thesari i përvojës shpirtërore të krishterë.

16. Çdo kapitull, megjithëse ka një tematikë të vetën dhe një metodologji

specifike, trajton, nga një perspektivë e re, çështje të rëndësishme të përballuara në kapitujt e mëparshëm. Kjo i përket veçanërisht disa shtyllave bartëse që përshkojnë gjithë Enciklikën. Për shembull: marrëdhënia intime mes të varfërve dhe brishtësisë së planetit; bindja se e gjithë bota është e lidhur në mënyrë intime; kritika ndaj paradigmës së re dhe ndaj formave të pushtetit që rrjedhin nga teknologjia; ftesa për të kërkuar mënyra të tjera për të kuptuar ekonominë dhe përparimin; vlera përkatëse e çdo krijese; kuptimi njerëzor i ekologjisë; nevoja për debate të sinqerta dhe të ndershme; përgjegjësia e madhe e politikës ndërkombëtare e lokale; kultura e skartimit dhe propozimi i një stili të ri jete. Këto tema nuk mbyllen apo braktisen kurrë, por madje rimerren dhe pasurohen vazhdimisht.

KAPITULLI I PARË

AJO QË PO I NDODH SHTËPISË SONË

17. Reflektimet teologjike apo filozofike mbi situatën e njerëzimit dhe të botës mund të tingëllojnë si një mesazh i përsëritur dhe i zbrazët, nëse nuk paraqiten përsëri duke nisur nga një ballafaqim me kontekstin aktual, në atë që ka të panjohur për historinë e njerëzimit. Prandaj, para se të pohojmë se si feja sjell motivime dhe kërkesa të reja përballë botës në të cilën bëjmë pjesë, propozoj të ndalemi shkurtimisht për të konsideruar atë që po i ndodh shtëpisë sonë të përbashkët.

18. Përshpejtimi i vazhdueshëm i ndryshimeve të njerëzimit dhe të planetit sot bashkohet me intensifikimin e ritmeve të jetës dhe të punës, në atë që në spanjisht disa e quajnë "*rapidación*" (shpejtësim). Megjithëse ndryshimi

bën pjesë në dinamikën e sistemeve komplekse, shpejtësia që veprimet njerëzore i imponojnë sot është në kundërshtim me ngadalësinë natyrore të evolucionit biologjik. Kësaj i shtohet problemi se objektivat e këtij ndryshimi të shpejtë e të vazhdueshëm jo patjetër janë të orientuar nga e mira e përbashkët dhe nga një zhvillim njerëzor, i pranueshëm dhe integral. Ndryshimi është diçka e dëshirueshme, por bëhet shqetësues kur kthehet në prishje të botës dhe të cilësisë së jetës së një pjese të madhe të njerëzimit.

19. Pas një kohe besimi të paarsyeshëm në përparimin dhe në aftësitë njerëzore, një pjesë e shoqërisë është duke hyrë në një fazë vetëdijeje më të madhe. Vërehet një ndjeshmëri në rritje në lidhje me mjedisin dhe me kujdesin për natyrën, dhe po piquet një shqetësim i sinqertë dhe i dhimbshëm për atë që po i ndodh planetit tonë. Le të bëjmë një rrugëtim, që me siguri do të jetë i paplotë, nëpërmjet

atyre çështjeve që sot na shkaktojnë shqetësim dhe që tashmë nuk mund t'i fshehim më nën qilim. Objektivi nuk është që të mbledhim informacione apo të shuajmë kureshtjen tonë, por të ndërgjegjësohemi në mënyrë të dhimbshme, të guxojmë ta shndërrojmë në vuajtje personale atë që po i ndodh botës, dhe kështu të njohim se cila është ndihmesa që mund të japë secili.

I. NDOTJA DHE NDRYSHIMET KLIMATIKE

Ndotja, mbeturinat dhe kultura e skartimit

20. Ekzistojnë forma ndotjeje që i godasin përditë personat. Kontakti me ndotësit atmosferikë prodhon një spektër të gjerë efektesh mbi shëndetin, veçanërisht mbi atë të më të varfërve, dhe shkakton miliona vdekje të parakohshme. Njerëzit sëmuren, për shembull, për shkak të thithjes së sasive të mëdha të tymit të prodhuar

nga karburantet e përdorura për të gatuar apo për t'u ngrohur. Kësaj i shtohet ndotja që i godet të gjithë, e shkaktuar nga transporti, nga tymrat e industrisë, nga shkarkimi i substancave që ndihmojnë në acidifikimin e dheut dhe të ujit, nga fertilizuesit, fungicidet, herbicidet dhe pesticidet toksike në përgjithësi. Teknologjia që, e lidhur me financën, pretendon të jetë e vetmja zgjidhje e problemeve, faktikisht nuk është në gjendje ta shohë misterin e marrëdhënieve të shumta që ekzistojnë mes gjërave, dhe prandaj nganjëherë zgjidh një problem duke krijuar probleme të tjera.

21. Duhet konsideruar edhe ndotja e prodhuar prej mbeturinave, përfshirë edhe ato të rrezikshme të pranishme në mjedise të ndryshme. Prodhohen mijëra milionë tonelata mbeturinash në vit, shumë prej të cilave nuk janë të biodegradueshme: mbeturina shtëpiake dhe komerciale, mbetje rrënimesh,

mbeturina klinike, elektronike apo industriale, mbeturina shumë toksike dhe radioaktive. Toka, shtëpia jonë, duket se po shndërrohet gjithnjë e më shumë në një depozitë të stërmadhe plehrash. Në shumë vende të planetit, të moshuarit kujtojnë me mall peizazhet e kohërave të tjera, që tani duken të mbuluara nga mbeturinat. Si mbeturinat industriale ashtu edhe prodhimet kimike të përdorura në qytete e në fshatra, mund të prodhojnë një efekt biogrubullimi në organizmat e banorëve të zonave të afërta, që verifikohet edhe kur niveli i pranisë së një elementi toksik në një vend është i ulët. Shumë herë merren masa vetëm kur janë prodhuar efekte të pakthyeshme për shëndetin e personave.

22. Këto probleme janë të lidhura ngushtë me kulturën e skartimit, që godet qoftë qeniet njerëzore të përjashtuara qoftë gjërat që shndërrohen shpejt në mbeturina. Le të bindemi, për

shembull, se pjesa më e madhe e letrës që prodhohet hidhet dhe nuk riciklohet. E kemi të vështirë të pranojmë se funksionimi i ekosistemeve natyrore është shembullor: bimët sintetizojnë substanca ushqyese të cilat ushqejnë barngrënësit; këta, nga ana e tyre, ushqejnë mishngrënësit, që japin sasi të rëndësishme mbetjesh organike, të cilat i japin jetë një brezi të ri vegjetalësh. Përkundrazi, sistemi industrial, në fund të ciklit të prodhimit dhe të konsumit, nuk e ka zhvilluar aftësinë për të përvetësuar dhe ripërdorur mbeturinat dhe skoriet. Nuk është arritur ende të përdoret një model qarkullor prodhimi që siguron burime për të gjithë dhe për brezat e ardhshëm, e që kërkon të kufizohet në maksimum përdorimi i burimeve jo të përtëritshme, të moderohet konsumi, të maksimizohet efienca e shfrytëzimit, të bëhet ripërdorimi dhe riciklimi. Përballimi i kësaj çështjeje do të ishte një mënyrë për t'i kundërshtuar kulturës së skartimit që arrin ta dëmtojë krejt

planetin, por vërejmë se përparimet në këtë drejtim janë ende shumë të pakta.

Klima si e mirë e përbashkët

23. Klima është një e mirë e përbashkët, e të gjithëve dhe për të gjithë. Ajo, në nivel global, është një sistem kompleks në marrëdhënie me shumë kushte thelbësore për jetën njerëzore. Ekziston një kontekst shkencor shumë i qëndrueshëm që tregon se jemi në praninë e një ngrohjeje shqetësuese të sistemit klimatik. Në dhjetëvjeçarët e fundit kjo ngrohje është shoqëruar nga ngritja e vazhdueshme e nivelit të detit, dhe po ashtu është e vështirë të mos e vëmë atë në lidhje me shtimin e ngjarjeve meteorologjike të skajshme, pavarësisht prej faktit se nuk mund t'i lihet një shkak shkencërisht i përcaktueshëm çdo dukurie të veçantë. Njerëzimi është i thirrur të ndërgjegjësohet për nevojën e ndryshimeve të stileve të jetës, të prodhimit e të konsumit, për

të luftuar këtë ngrohje ose, të paktën, shkaqet njerëzore që e prodhojnë apo e theksojnë. Është e vërtetë se ka edhe faktorë të tjerë (sikurse vullkanizmi, ndryshimet e orbitës dhe të boshtit tokësor, cikli diellor), por shumë studime shkencore tregojnë se pjesa më e madhe e ngrohjes globale të dhjetëvjeçarëve të fundit shkaktohet nga përqendrimi i madh i gazrave serrë (anhidridi karbonik, metani, oksidi i azotit e të tjerë) të lëshuar sidomos për shkak të veprimtarisë njerëzore. Përqendrimi i tyre në atmosferë nuk lejon që ngrohtësia e rrezeve diellore të reflektuara nga toka të shpërndahet në hapësirë. Kjo fuqizohet veçanërisht prej modelit të zhvillimit të bazuar në përdorimin intensiv të karburanteve fosile, që gjendet në qendër të sistemit energjetik botëror. Ka ndikuar edhe shtimi i praktikës së ndryshimit të përdorimit të tokës, kryesisht shpyllëzimi për qëllim bujqësor.

24. Ngrohja, nga ana e vet, ka efekte

mbi ciklin e karbonit. Krijon një rreth vicioz që e rëndon edhe më shumë situatën dhe që do të ndikojë në disponibilitetin e burimeve thelbësore si uji i pijshëm, energjia dhe prodhimi bujqësor i zonave më të nxehta, dhe do të shkaktojë zhdukjen e një pjese të biodiversitetit të planetit. Shkrirja e akullnajave polare dhe e atyre të kuotave të larta kërcënon daljen jashtë shumë të rrezikshme të gazit metan, dhe dekompozimi i lëndës organike të ngrirë mund ta shtojë edhe më shumë lëshimin e anhidritit karbonik. Gjithashtu, humbja e pyjeve tropikale i përkeqëson gjërat, meqenëse ato ndihmojnë të zbutet ndryshimi klimatik. Ndotja e prodhuar nga anhidridi karbonik e shton aciditetin e oqeanëve dhe dëmton zinxhirin ushqimor detar. Nëse prirja aktuale vazhdon, ky shekull mund të jetë dëshmitar i ndryshimeve klimatike të padëguara dhe i një shkatërrimi të pashoq të ekosistemeve, me pasoja të rënda për të gjithë ne. Ngritja e nivelit

të detit, për shembull, mund të krijojë situata shumë të rënda nëse mbajmë parasysh se një e katërta e popullsisë botërore jeton në breg të detit apo shumë afër tij, dhe pjesa më e madhe e megalopoleve janë të vendosura në zona bregdetare.

25. Ndryshimet klimatike janë një problem global me rrjedhoja të rënda mjedisore, shoqërore, ekonomike, distributive e politike, dhe përbëjnë një nga sfidat kryesore aktuale për njerëzimin. Efektet më të rënda ka të ngjarë që të bien, në dhjetëvjeçarët e fundit, mbi Vendet në rrugë zhvillimi. Shumë të varfër jetojnë në vende veçanërisht të goditura prej dukurive të lidhura me ngrohjen, dhe mjetet e tyre të jetesës varen shumë prej rezervave natyrore dhe prej të ashtuquajturave shërbime të ekosistemit, si bujqësia, peshkimi dhe burimet pyjore. Nuk kanë disponibilitete të tjera ekonomike dhe burime të tjera që u lejojnë t'u përshtaten

efekteve klimatike apo të përballojnë situata katastrofike, dhe kanë pak mundësi për shërbime shoqërore e tutele. Për shembull, ndryshimet klimatike i japin fill migrimeve të kafshëve e vegjetalëve që jo gjithmonë mund të përshtaten, dhe kjo, nga ana e vet, dëmton burimet prodhuese të më të varfërve, të cilët gjithashtu janë të detyruar të migrojnë me një pasiguri të madhe për të ardhmen e jetës së tyre dhe të bijve të tyre. Është tragjik shtimi i migrantëve që ikin nga mjerimi i rënduar prej degradimit mjedisor, të cilët nuk njihen si refugjatë në konventat ndërkombëtare dhe bartin peshën e jetës së tyre të braktisur pa asnjë tutelim normativ. Mjerisht ka një mospërfillje të përgjithshme përballë këtyre tragjediëve, që ndodhin ende në anë të ndryshme të botës. Mungesa e reagimeve përballë këtyre dramave të vëllezërve e motrave tona është një shenjë e humbjes së asaj ndjenje përgjegjësie për të ngjashmit tanë mbi të cilën bazohet çdo shoqëri

civile.

26. Shumë prej atyre që zotërojnë më shumë burime dhe pushtet ekonomik apo politik duket se përqendrohen sidomos në maskimin e problemeve dhe fshehjen e simptomave të tyre, duke u përpjekur vetëm të pakësojnë disa efekte negative të ndryshimeve klimatike. Por shumë simptoma tregojnë se këto efekte mund të jenë gjithnjë e më të këqija nëse vazhdojmë me modelet aktuale të prodhimit e të konsumit. Prandaj është bërë urgjent dhe i domosdoshëm zhvillimi i politikave në mënyrë që në vitet e ardhshme lëshimi i anhidritit karbonik dhe i gazrave të tjera shumë ndotëse të pakësohet në mënyrë drastike, për shembull, duke i zëvendësuar karburantet fosile dhe duke zhvilluar burime energjie të përtëritshme. Në botë ka një nivel të ultë përdorimi të energjive të pastra e të përtëritshme. Ka ende nevojë të zhvillohen teknologji të përshtatshme grumbullimi. Megjithatë, në disa Vende

ka pasur përparime që po fillojnë të jenë domethënëse, megjithëse janë larg prej arritjes së një mase të rëndësishme. Ka pasur edhe disa investime në modalitete prodhimi e transporti që konsumojnë më pak energji dhe kërkojnë më pak sasi lëndësh të para, ashtu si edhe në modalitete ndërtimi apo rindërtimi të ndërtesave që përmirësojnë eficiencën e tyre energjetike. Por këto praktika të mira janë larg nga të bërit të përgjithshme.

II. ÇËSHTJA E UJIT

27. Sinjalizues të tjerë të situatës aktuale janë të lidhur me shterimin e burimeve natyrore. E njohim mirë pamundësinë për të përballuar nivelin aktual të konsumit të Vendeve më të zhvilluara dhe të sektorëve më të pasur të shoqërisë, ku zakoni për të shkapërderdhur e hedhur tutje arrin nivele të padëgjueshme. Tashmë janë kapërcyer disa kufij maksimalë të shfrytëzimit të planetit, ndërkohë që

nuk është zgjidhur problemi i varfërisë.

28. Uji i pijshëm dhe i pastër përfaqëson një çështje me rëndësi parësore, sepse është i domosdoshëm për jetën njerëzore dhe për të ruajtur ekosistemet tokësore e ujore. Burimet e ujit të ëmbël furnizojnë sektorët shëndetësorë, agrolegtoralë dhe industrialë. Disponibiliteti i ujit ka mbetur relativisht i qëndrueshëm për një kohë të gjatë, por tani në shumë vende kërkesa e tejkalon ofertën e mundshme, me pasoja të rënda afatshkurtra dhe afatgjata. Qytete të mëdha, që varen nga rezerva të rëndësishme hidrike, vuajnë periudha mangësie të këtij burimi, që në momentet kritike nuk administrohet gjithmonë me një koordinim të përshtatshëm dhe me paanshmëri. Varfëria e ujit publik ekziston veçanërisht në Afrikë, ku sektorë të mëdhenj të popullsisë nuk kanë ujë të pijshëm të sigurt, ose pësojnë thatësira që e bëjnë të vështirë prodhimin e ushqimit. Në disa vende ka krahina me begati uji, ndërsa

të tjera vuajnë një mungesë të madhe të tij.

29. Një problem veçanërisht serioz është ai i cilësisë së ujit të disponueshëm për të varfrit, që shkakton shumë vdekje çdo ditë. Mes të varfërve janë të shpeshta sëmundjet e lidhura me ujin, përfshirë edhe ato të shkaktuara nga mikroorganizma dhe nga substanca kimike. Disenteria dhe kolera, të shkaktuara nga shërbimet higjienike dhe rezervat e papërshtatshme të ujit, janë një faktor domethënës i vuajtjes dhe i vdekshmërisë foshnjore. Shtresat e nëndheshme të ujit në shumë vende janë të kërcënuara nga ndotja që prodhojnë disa veprimtari nxjerrëse, bujqësore dhe industriale, sidomos në Vende ku mungojnë zbatimi i normave përkatëse dhe kontrollet e mjaftueshme. Nuk mendojmë vetëm për mbeturinat e fabrikave. Larësit dhe prodhimet kimike që popullsia përdor në shumë vende të botës vazhdojnë të derdhen në lumenj,

liqene dhe dete.

30. Ndërsacilësia e ujit të disponueshëm keqësohet vazhdimisht, në disa vende shtohet prirja për ta privatizuar këtë burim të mangët, të shndërruar në mall të nënshtruar ligjeve të tregut. Në të vërtetë, *përdorimi i ujit të pijshëm dhe të sigurt është një e drejtë njerëzore thelbësore, themelore dhe universale, sepse përcakton mbijetesën e personave, dhe prandaj është kusht për ushtrimin e të drejtave të tjera njerëzore.* Kjo botë u ka një borxh të madh shoqëror të varfërve që nuk mund të kenë përdorimin e ujit të pijshëm, sepse kjo do të thotë t'u mohohet atyre e drejta për jetë e rrënjësor në dinjitetin e tyre të pacenueshëm. Ky borxh shlyhet pjesërisht me ndihmesa më të mëdha ekonomike për të furnizuar me ujë të pastër dhe shërbime filtrimi popullsitë më të varfra. Por vërehet një shkapërderdhje uji jo vetëm në Vendet e zhvilluara, por edhe në ata në rrugë zhvillimi që kanë rezerva të mëdha. Kjo vë në dukje se problemi i

ujit është pjesërisht një çështje edukative dhe kulturore, sepse nuk ekziston vetëdija për peshën e këtyre sjelljeve në një kontekst pabarazie të madhe.

31. Një mangësi më e madhe uji do të shkaktojë shtimin e kostos së ushqimeve dhe të prodhimeve të ndryshme që varen prej përdorimit të tij. Disa studime kanë lajmëruar për rrezikun që të pësohet një mangësi e fortë uji brenda pak dhjetëvjeçarësh nëse nuk veprohet me ngutshmëri. Efektet mjedisore mund të godasin miliarda persona, dhe nga ana tjetër është e parashikueshme që kontrolli i ujit nga ana e firmave të mëdha botërore të shndërrohet në një prej burimeve kryesore të konfliktit të këtij shekulli.^[23]

III. HUMBJA E BIODIVERSITETIT

32. Edhe burimet e tokës po shkatërrohen për shkak të mënyrave të të kuptuarit të ekonomisë dhe

veprimtarisë tregtare e prodhuese tepër të lidhura me rezultatin e menjëhershëm. Humbja e pyjeve sjell në të njëjtën kohë humbjen e specieve që mund të përbëjnë në të ardhmen burime tejet të rëndësishme, jo vetëm për të ushqyerit, por edhe për kurimin e sëmundjeve dhe për shërbime të shumta. Speciet e ndryshme përmbajnë gene që mund të jenë burime-kyçe për t'iu përgjigjur në të ardhmen ndonjë nevoje njerëzore apo për të zgjidhur ndonjë problem mjedisor.

33. Por nuk mjafton të mendojmë për speciet e ndryshme vetëm si "burime" të ndryshme të shfrytëzueshme, duke harruar se kanë një vlerë në vetvete. Çdo vit zhduken mijëra specie vegjetale dhe shtazore që nuk do të mund t'i njohim më, që bijtë tanë nuk do të mund t'i shohin, të humbura përgjithmonë. Shumica e stërmadhe zhduket për arsye që kanë të bëjë me ndonjë veprimtari njerëzore. Për shkakun tonë, mijëra

specie nuk do t'i japin lavdi Hyjit me ekzistencën e tyre e as nuk do të mund të na komunikojnë mesazhin e tyre. Nuk kemi të drejtë ta bëjmë këtë.

34. Ndoshta shqetësohemi kur marrim vesh për zhdukjen e një gjitari apo të një shpendi, për dukshmërinë e tyre më të madhe. Por për funksionimin e mirë të ekosistemeve janë të nevojshme edhe këpurdhat, algat, krimbat, insektet e vogla, zvarranikët dhe varietetet e panumërta të mikroorganizmave. Disa specie jo të shumta në numër, që zakonisht kalojnë pa u vënë re, luajnë një rol kritik themelor për të vendosur ekuilibrin e një vendi. Është e vërtetë se qenia njerëzore duhet të ndërhyjë kur një gjeosistem hyn në një stad kritik, por sot niveli i ndërhyrjes njerëzore në një realitet kaq kompleks si natyra është i tillë që katastrofat e vazhdueshme të shkaktuara nga qenia njerëzore nxisin një ndërhyrje të saj të re, në mënyrë që veprimtaria njerëzore bëhet e

gjithëpranishme, me të gjitha rreziqet që sjell kjo. Krijohet kështu një rreth vicioz në të cilin ndërhyrja e qenies njerëzore për të zgjidhur një vështirësi shumë herë e rëndon edhe më shumë situatën. Për shembull, shumë zogj dhe insekte që po zhduken për arsye të pesticideve toksike të krijuara nga teknologjia, janë të dobishëm për vetë bujqësinë, dhe zhdukja e tyre do të duhet të ndreqet me një tjetër ndërhyrje teknologjike që ndoshta do të sjellë efekte të reja të dëmshme. Janë të lavdërueshme dhe nganjëherë të admirueshme përpjekjet e shkencëtarëve dhe teknikëve që përpiqen të zgjidhin problemet e krijuara nga qenia njerëzore. Por duke vërejtur botën shohim se ky nivel i ndërhyrjes njerëzore, shpesh në shërbim të financës dhe të konsumizmit, në realitet bën që toka në të cilën jetojmë të bëhet më pak e pasur dhe e bukur, gjithnjë e më e kufizuar dhe gri, ndërsa njëkohësisht zhvillimi i teknologjisë dhe i ofertave të konsumit vazhdon të përparojë pa

kufizime. Në këtë mënyrë, duket se gënjejmë veten se mund ta zëvendësojmë një bukuri të papërsëritshme dhe të parekuperueshme me një tjetër të krijuar prej nesh.

35. Kur analizohet ndikimi mjedisor i ndonjë nisme ekonomike, është zakon të konsiderohen efektet mbi dheun, mbi ujin dhe mbi ajrin, por jo gjithmonë përfshihet një studim i vëmendshëm i ndikimit mbi biodiversitetin, a thua se humbja e disa specieve apo grupeve shtazore ose vegjetale janë diçka jo shumë e rëndësishme. Rrugët, kulturat e reja, rrethimet, pellgjet hidrike dhe ndërtime të tjera, kanë filluar të zotërojnë habitatet dhe nganjëherë i copëzojnë ata në mënyrë të tillë që popullsitë shtazore nuk mundën më as të migrojnë e as të zhvendosen lirisht, kështu që disa specie rrezikojnë të zhduken. Ekzistojnë alternativa që të paktën e zbusin ndikimin e këtyre veprave, sikurse krijimi i korridoreve biologjike, por në

pak Vende ndeshet një kujdes i tillë dhe një vëmendje e tillë. Kur shfrytëzohen për tregti disa specie, jo gjithmonë studiohet modaliteti i tyre i rritjes, për të shmangur pakësimin e tyre të tepërt me pasojë çekuilibrin e ekosistemit.

36. Mbrojtja e ekosistemeve kërkon një vështrim që shkon përtej të menjëhershmes, sepse kur kërkohet vetëm një përfitim ekonomik i shpejtë dhe i lehtë, askujt nuk i intereson me të vërtetë ruajtja e tyre. Por kostoja e dëmeve të shkaktuara nga moskujdesi egoist është shumë më e lartë se sa dobia ekonomike që mund të arrihet. Në rastin e humbjes apo të dëmtimit serioz të disa specieve, jemi duke folur për vlera që tejkalojnë çfarëdo llogaritjeje. Prandaj mund të jemi dëshmitarë memecë padrejtësish shumë të rënda kur pretendojmë të arrijmë fitime të rëndësishme duke bërë ta paguajë pjesa tjetër e njerëzimit, të tashëm dhe të ardhshëm, kostot shumë të larta të

degradimit mjedisor.

37. Disa Vende kanë bërë përparime në ruajtjen efikase të vendeve dhe zonave të caktuara - në tokë dhe në oqeanë - ku ndalohet çdo ndërhyrje njerëzore e cila mund ta modifikojë fizionominë e tyre apo të tjetërsojë përbërjen e tyre origjinale. Në mbrojtjen e biodiversitetit, specialistët këmbëngulin për nevojën që t'u kushtohet një vëmendje e veçantë zonave më të pasura me larmi specimesh, me specie endemike, jo të shpeshta ose me shkallë më të vogël mbrojtjeje efikase. Ka vende që kërkojnë një kujdes të veçantë për shkak të rëndësisë së tyre shumë të madhe për ekosistemin botëror, ose që përbëjnë burime domethënëse uji dhe kështu sigurojnë forma të tjera jete.

38. Le të kujtojmë, për shembull, ato mushkëri të planetit plot me biodiversitet që janë Amazona dhe pellgu lumor i Kongos, ose shtresat e mëdha ujëmbajtëse dhe akullnajat. Njihet mirë

rëndësia e këtyre vendeve për tërësinë e planetit dhe për të ardhmen e njerëzimit. Ekosistemet e pyjeve tropikale kanë një biodiversitet me kompleksitet të madh, pothuajse të pamundur për t'u njohur krejtësisht, por kur këto pyje digjen ose priten deri në rrënjë për të shtuar kultivimet, në pak vjet humbasin specie të panumërta, ose këto zona shndërrohen në shkretëtira të thata. Megjithatë, një ekuilibër delikat imponohet kur flitet për këto vende, sepse as nuk mund të shpërfillen interesat tejet të mëdha ekonomike ndërkombëtare që, me pretekstin se kujdesen për to, mund të vënë në rrezik sovranitetet kombëtare. Faktikisht ekzistojnë «propozime për ndërkombëtarizim të Amazonës, që u shërbejnë vetëm interesave ekonomike të multinacionaleve».^[24] Është për t'u lavdëruar angazhimi i organizmave ndërkombëtare dhe i organizatave të shoqërisë civile që sensibilizojnë popullsitë dhe bashkëpunojnë në mënyrë kritike, edhe duke përdorur

mekanizma të ligjshëm presioni, me qëllim që çdo qeveri të kryejë detyrën e vet të padelegueshme për të ruajtur mjedisin dhe burimet natyrore të Vendit të vet, pa iu shitur interesave të dyshimta lokale apo ndërkombëtare.

39. As zëvendësimi i florës së egër me zona të mbjella me pyje, që përgjithësisht janë monokultura, nuk është zakonisht objekt i një analize të duhur. Në të vërtetë, ai mund ta godasë ashpër një biodiversitet që nuk banohet prej specieve të reja që mbillen. Disa zona të lagështa, që shndërrohen në terren bujqësor, e humbasin biodiversitetin tejet të madh që kishin. Në disa zona bregdetare është shqetësuese zhdukja e ekosistemeve të përbëra nga vegjetacioni i zonave tropikale.

40. Oqeanet jo vetëm përmbajnë pjesën më të madhe të ujit të planetit, por edhe pjesën më të madhe të varietetit të gjerë të qenieve të gjalla, shumë

prej të cilave janë ende të panjohura nga ne dhe të kërcënuara nga shkaqe të ndryshme. Nga ana tjetër, jeta në lumenjtë, në liqenet, në detet dhe në oqeanet, që ushqen një pjesë të madhe të popullsisë botërore, goditet prej marrjes së pakontrolluar të burimeve të peshkut, që shkakton pakësime drastike të disa specieve. Ende vazhdojnë të zhvillohen modalitete përzgjedhëse peshkimi që skartojnë një pjesë të madhe të specieve të zëna. Janë veçanërisht të kërcënuar organizmat detare që nuk i mbajmë në konsideratë, ashtu sikurse disa forma të *plancton* që përfaqësojnë një përbërës shumë të rëndësishëm në zinxhirin ushqimor detar, dhe prej të cilave varen, në fund të fundit, specie që përdoren për të ushqyerit e njeriut.

41. Duke depërtuar në detet tropikale e subtropikale, takojmë barrierat koraline, që u ngjasojnë pyjeve të mëdha të tokës, sepse mirëpresin afërsisht një milion specie, përfshirë peshqit, gaforret,

butakët, sfungjerët, algat. Shumë prej barrierave koraline të botës sot janë të shterpëta ose janë në pakësim të vazhdueshëm: «Kush e ka shndërruar botën e mrekullueshme detare në varreza nënujore pa jetë dhe pa ngjyrë?». ^[25] Kjo dukuri shkaktohet në pjesën më të madhe prej ndotjes që arrin në det si rezultat e shpyllëzimit, i monokulturave bujqësore, i mbetjeve industriale dhe i metodave shkatërrimtare të peshkimit, sidomos atyre që përdorin cianurin dhe dinamitin. Është rënduar prej shtimit të temperaturës së oqeanëve. E gjithë kjo na ndihmon të kuptojmë se si çfarëdo veprimi mbi natyrën mund të ketë pasoja që nuk i vërejmë menjëherë, dhe se disa forma të shfrytëzimit të burimeve arrihen duke shkaktuar një degradim që arrin deri në fund të oqeanëve.

42. Është e nevojshme të investohet shumë më tepër në kërkimin, për ta kuptuar më mirë sjelljen e ekosistemeve dhe të analizohen siç duhen variantet e

ndryshme të efektit të çfarëdo modifikimi të rëndësishëm në mjedis. Meqenëse të gjitha krijesat janë të lidhura mes tyre, secilës duhet t'i njihet vlera e vet me dashuri dhe admirim, dhe të gjithë ne qeniet e krijuara kemi nevojë për njëri-tjetrin. Çdo territor ka një përgjegjësi në kujdesin për këtë familje, prandaj duhet të bëjë një inventar të kujdesshëm të specieve që ka brenda, për të zhvilluar programe dhe strategji mbrojtjeje, duke u kujdesur me vëmendje të veçantë për speciet në zhdukje.

IV. PËRKEQËSIMI I CILËSISË SË JETËS NJERËZORE DHE DEGRADIMI SHOQËROR

43. Nëse mbajmë parasysh faktin se edhe qenia njerëzore është një krijesë e kësaj bote, që ka të drejtë të jetojë dhe të jetë e lumtur, dhe gjithashtu ka një dinjitet të veçantë, nuk mund të lëmë pa konsideruar efektet e degradimit mjedisor, të modelit aktual të zhvillimit

dhe të kulturës së skartimit mbi jetën e personave.

44. Sot ndeshemi, për shembull, me rritjen e pamasë dhe të çrregullt të shumë qyteteve që janë bërë të pajetueshme nga këndvështrimi i shëndetit, jo vetëm prej ndotjes së shkaktuar nga lëshimet toksike, por edhe për kaosin urban, problemet e transportit dhe ndotjen vizive e akustike. Shumë qytete janë struktura të mëdha jo eficiente që konsumojnë me tepri ujë dhe energji. Ka lagje që, megjithëse të ndërtuara kohët e fundit, janë të mbipopulluara dhe të çrregullta, pa hapësira të gjelbra të mjaftueshme. Nuk u përshtatet banorëve të këtij planeti të jetojnë gjithnjë e më të zhytur në çimento, asfalt, xham e metale, të privuar nga kontakti fizik me natyrën.

45. Në disa vende, rurale dhe urbane, privatizimi i hapësirave e ka bërë të vështirë hyrjen e shtetasve në zona me bukuri të veçantë; gjetiu janë krijuar lagje rezidenciale “ekologjike” vetëm në

dispozicion të pak vetëve, ku shmanget hyrja e të tjerëve që mund të shqetësojnë një qetësi artificiale. Shpesh gjendet një qytet i bukur dhe plot me hapësira të gjelbra të mbajtura me kujdes në disa zona “të sigurta”, por jo e njëjta gjë në zona më pak të dukshme, ku jetojnë të skartuarit e shoqërisë.

46. Mes përbërësve shoqërorë të ndryshimit global përfshihen efektet në lidhje me punësimin të disa risive teknologjike, përjashtimi shoqëror, pabarazia në disponibilitetin dhe në konsumin e energjisë dhe të shërbimeve të tjera, fragmentizimi shoqëror, shtimi i dhunës dhe lindja e formave të reja të agresivitetit shoqëror, narkotrafiku dhe konsumi në rritje i drogave mes më të rinjve, humbja e identitetit. Janë shenja, mes shumë të tjerash, që tregojnë se si rritja e dy shekujve të fundit nuk ka treguar në të gjitha aspektet e veta një përparim të vërtetë të tërësishëm dhe një përmirësim të cilësisë së jetës. Disa prej

këtyre shenjave janë në të njëjtën kohë simptoma të një degradimi të vërtetë shoqëror, të një këputjeje të heshtur të lidhjeve të integritetit dhe të bashkimit shoqëror.

47. Kësaj i shtohen dinamikat e mediave dhe të botës dixhitale, që, kur bëhen të gjithëpranishme, nuk favorizojnë zhvillimin e një aftësie për të jetuar me urti, për të menduar në thellësi, për të dashur me zemërgjerësi. Të dijsmit e mëdhenj të së kaluarës, në këtë kontekst, do të rrezikojnë ta shihnin të shuar urtinë e tyre në mes të zhurmës pështjelluese të informacionit. Kjo na kërkon një përpjekje në mënyrë që këto mjete të kthehen në një zhvillim të ri kulturor të njerëzimit dhe jo në një dëmtim të pasurisë së tij më të thellë. Urtia e vërtetë, fryti i reflektimit, i dialogut dhe i takimit zemërgjerë mes personave, nuk fitohet me një grumbullim të thjeshtë të të dhënave që arrin të na marrë frymën e të na pështjellojë, një

njëfarë ndotjeje mendore. Në të njëjtën kohë, marrëdhëniet reale me të tjerët, me të gjitha sfidat që sjellin ato, priren të zëvendësohen nga një lloj komunikimi i ndërmjetësuar nga interneti. Kjo lejon të përzgjidhen apo të zhduken marrëdhëniet sipas vullnetit tonë, dhe kështu lind shpesh një lloj i ri emocionesh artificiale, që kanë të bëjnë më shumë me dispozitivat dhe ekranet se sa me personat dhe natyrën. Mjetet aktuale lejojnë që të komunikojmë mes nesh dhe që të bashkëndajmë njohjet e ndjenjat. Megjithatë, nganjëherë edhe na pengojnë të kemi kontakt të drejtpërdrejtë me ankthin, me drithërimën, me gëzimin e tjetrit dhe me kompleksitetin e përvojës së tij personale. Prandaj nuk duhet të na çudisë fakti që, së bashku me ofertën mbytëse të këtyre prodhimeve, shkon duke u rritur një pakënaqësi e thellë e malinkonike në marrëdhëniet ndërpersonale, ose një izolim i dëmshëm.

V. PADREJTËSIA PLANETARE

48. Mjedisi njerëzor dhe mjedisi natyror degradohen së bashku, dhe nuk do të mund ta përballojmë siç duhet degradimin mjedisor nëse nuk u kushtojmë vëmendje shkaqeve që kanë lidhje me degradimin njerëzor e shoqëror. Faktikisht, përkeqësimi i mjedisit dhe ai i shoqërisë godasin në mënyrë të veçantë më të dobët e planetit: «Si përvoja e përbashkët e jetës së zakonshme ashtu edhe kërkimi shkencor tregojnë se efektet më të rënda të të gjitha sulmeve mjedisore i pësojnë njerëzit më të varfër».^[26] Për shembull, shterja e rezervave të peshkut penalizon veçanërisht ata që jetojnë nga peshkimi artizanal dhe nuk kanë se si ta zëvendësojnë, ndotja e ujit godet në veçanti më të varfrit që nuk kanë mundësinë ta blejnë ujin në shishe, dhe ngritja e nivelit të detit godet kryesisht popullsitë bregdetare të varfëruara që nuk kanë se ku të transferohen. Efekti

i çekuilibreve aktuale dëftohet edhe në vdekjen e parakohshme të shumë të varfërve, në konfliktet e shkaktuara prej mungesës së burimeve dhe në shumë probleme të tjera që nuk gjejnë hapësirë të mjaftueshme në agjendat e botës.^[27]

49. Do të doja të vija në dukje se shpesh nuk kemi një vetëdije të qartë për problemet që godasin veçanërisht të përjashtuarit e shoqërisë. Ata janë pjesa më e madhe e planetit, miliarda persona. Sot përmenden në debatet politike dhe ekonomike ndërkombëtare, por më së shumti duket se problemet e tyre shtrohen si një shtojcë, si një çështje që shtohet gati si për detyrim ose në mënyrë periferike, nëse nuk konsiderohen thjesht një dëm dytësor. Faktikisht, në momentin e aktualizimit konkret, shpesh mbeten në vendin e fundit. Kjo shkaktohet pjesërisht prej faktit se shumë profesionistë, opinionistë, mjete të komunikimit dhe qendra të pushtetit janë të vendosur

larg tyre, në zona urbane të izoluar, pa kontakt të drejtpërdrejtë me problemet e tyre. Jetojnë dhe reflektojnë duke nisur prej rehatisë së një zhvillimi dhe të një cilësie jete që nuk janë të mundshme për pjesën më të madhe të popullsisë botërore. Kjo mungesë kontakti fizik dhe takimi, nganjëherë e favorizuar nga fragmentizimi i qyteteve tona, ndihmon që të kauterizohet ndërgegjja dhe të shpërfillet një pjesë e realitetit në analiza të pjesshme. Kjo nganjëherë bashkëjeton me një argument “të gjelbër”. Por sot nuk mund të mos e pranojmë se *një kriter i vërtetë ekologjik bëhet gjithmonë një kriter shoqëror, që duhet të integrojë drejtësinë në diskutimet mbi mjedisin, për të dëgjuar si britmën e tokës ashtu edhe britmën e të varfërve.*

50. Në vend që të zgjidhin problemet e të varfërve dhe të mendojnë për një botë të ndryshme, disa kufizohen duke propozuar një ulje të lindshmërisë. Nuk mungojnë presione ndërkombëtare

mbi Vendet në rrugë zhvillimi që i kushtëzojnë ndihmat ekonomike me politika të caktuara të “shëndetit riprodhues”. Por, «nëse është e vërtetë se shpërndarja e pabarabartë e popullsisë dhe e burimeve të disponueshme krijon pengesa për zhvillimin dhe për një përdorim të arsyeshëm të mjedisit, duhet pranuar se rritja demografike është plotësisht e pajtueshme me një zhvillim integral dhe solidar».^[28] Të fajësohet rritja demografike dhe jo konsumizmi i skajshëm e përzgjedhës i disave, është një mënyrë për të mos përballuar problemet. Kështu pretendohet të ligjërohet modeli aktual distributiv, në të cilin një pakicë mendon se ka të drejtë të konsumojë në një përpjesëtim që do të ishte e pamundur të përgjithësohej, sepse planeti as që do të mund t’i mbante mbeturinat e një konsumi të tillë. Gjithashtu, dimë se çohet dëm përafërsisht një e treta e ushqimeve që prodhohen, dhe «ushqimi që hidhet është si t’i vidhej tryezës së të varfrit».

[29] Sidoqoftë, është e sigurt se duhet t'i kushtojmë vëmendje çekuilibrit në shpërndarjen e popullsisë në territor, si në nivel kombëtar ashtu edhe në nivel global, sepse shtimi i konsumit do të çonte në situata rajonale komplekse, për arsye të kombinimit të problemeve të lidhura me ndotjen mjedisore, me transportet, me shpërbërjen e mbeturinave, me humbjen e burimeve me cilësinë e jetës.

51. Padrejtësia nuk godet vetëm individët, por edhe Vende të tëra, dhe na detyron të mendojmë për një etikë të marrëdhënieve ndërkombëtare. Në të vërtetë, ekziston një "borxh ekologjik" i vërtetë, sidomos mes Veriut e Jugut, i lidhur me çekuilibret tregtare me pasoja në fushën ekologjike, ashtu si edhe me përdorimin e tepruar të burimeve natyrore të bërë historikisht nga disa Vende. Eksportimet e disa lëndëve të para për të kënaqur tregjet e Veriut të industrializuar kanë prodhuar dëme

lokale, sikurse ndotja nga merkuri në minierat e arit apo nga dioksidi i sulfurit në ato të bakrit. Në mënyrë të veçantë duhet llogaritur përdorimi i hapësirës mjedisore të të gjithë planetit për të depozituar mbeturina gazi që janë grumbulluar gjatë dy shekujve dhe kanë krijuar një situatë që tani po i godet të gjitha Vendet e botës. Ngrohja e shkaktuar nga konsumi i pamasë i disa Vendeve të pasura ka pasoja në vendet më të varfra të tokës, sidomos në Afrikë, ku shtimi i temperaturës i bashkuar me thatësinë ka efekte shkatërrimtare mbi rendimentin e kultivimeve. Kësaj i bashkohen dëmet e shkaktuara nga eksportimi drejt Vendeve në rrugë zhvillimi i mbeturinave solide dhe të lëngshme toksike dhe nga veprimtaria ndotëse e firmave që në Vendet më pak të zhvilluara bëjnë atë që nuk mund ta bëjnë në shtëpinë e tyre, në Vendet që e shtojnë kapitalin e tyre: «Vërejmë se shpesh firmat që veprojnë kështu janë multinacionale, që bëjnë

këtu atë që nuk u lejohej në Vendet e zhvilluara apo në të ashtuquajturën botë e parë. Përgjithësisht, kur i ndërpresin veprimtaritë e tyre dhe tërhiqen, lënë dëme të mëdha njerëzore e mjedisore, sikurse papunësia, fshatrat pa jetë, shterimi i disa burimeve natyrore, shpyllëzimi, varfërimi i bujqësisë dhe i blegtorisë lokale, krateret, kodrat e shkatërruara, lumenjtë e ndotur dhe ndonjë vepër shoqërore që nuk mund të mbështet më».^[30]

52. Borxhi i jashtëm i Vendeve të varfra është shndërruar në një mjet kontrolli, por nuk ndodh e njëjta gjë me borxhin ekologjik. Në mënyra të ndryshme, popujt në rrugë zhvillimi, ku gjenden rezervat më të rëndësishme të biosferës, vazhdojnë të ushqejnë zhvillimin e Vendeve më të pasura me koston e të tashmes së tyre dhe së ardhmes së tyre. Toka e të varfërve të Jugut është e pasur dhe jo shumë e ndotur, por qasja në pronësinë e të mirave dhe të

burimeve për të plotësuar nevojat e tyre jetësore u është e ndaluar nga një sistem marrëdhëniesh tregtare dhe pronësie strukturalisht i lig. Është e nevojshme që Vendet e zhvilluara të ndihmojnë për ta shlyer këtë borxh duke kufizuar në mënyrë të rëndësishme konsumin e energjisë jo të përtëritshme, dhe duke u çuar burime Vendeve më nevojtare për të nxitur politika dhe programe zhvillimi të mundshëm. Rajonet dhe Vendet më të varfra kanë më pak mundësi për të përdorur modele të reja të pakësimit të efektit mjedisor, sepse nuk kanë përgatitjen për të zhvilluar proceset e nevojshme dhe nuk mund t'i mbulojnë kostot e tyre. Prandaj, duhet ta ruajmë të qartë vetëdijen se në ndryshimin klimatik ekzistojnë *përgjegjësi të dalluara* dhe, siç kanë thënë Ileshkvinjtë e Shteteve të Bashkuara, është mirë të shqyrtohen «veçanërisht nevojat e të varfërve, të dobtëve dhe të të pambrojturve, në një debat shpesh të sunduar nga interesat më të fuqishme».

[31] Duhet të forcojmë vetëdijen se jemi një familje e vetme njerëzore. Nuk ka kufij dhe barriera politike apo shoqërore që na lejojnë të izolohehi, dhe prandaj nuk ka as hapësirë për globalizimin e indiferencës.

VI. DOBËSIA E REAGIMEVE

53. Këto situata shkaktojnë ofshamat e motrës tokë, që u bashkohen ofshamave të të braktisurve të botës, me një ankim që kërkon prej nesh një tjetër drejtim. Kurrë nuk e kemi keqtrajtuar dhe fyer shtëpinë tonë të përbashkët si në dy shekujt e fundit. Ndërsa jemi të thirrur të bëhemi mjetet e Hyjit Atë në mënyrë që planeti ynë të jetë ashtu sikurse Ai e ka ëndërruar duke e krijuar dhe t'i përgjigjet planit të tij të paqes, bukurisë dhe plotësisë. Problemi është se nuk e kemi ende kulturën e nevojshme për ta përballuar këtë krizë dhe është nevoja të ndërtohen *leadership-e* që të tregojnë rrugë, duke u përpjekur t'u përgjigjen

nevojave të brezave aktualë duke i përfshirë të gjithë, pa i dëmtuar brezat e ardhshëm. Bëhet e domosdoshme të krijohet një sistem normativ që përfshin kufij të pacenueshëm dhe siguron mbrojtjen e ekosistemeve, para se format e reja të pushtetit të buruara nga paradigma tekno-ekonomike të arrijnë ta shkatërrojnë jo vetëm politikën por edhe lirinë dhe drejtësinë.

54. E denjë për t'u theksuar është dobësia e reagimit politik ndërkombëtar. Nënshtrimi i politikës ndaj teknologjisë dhe ndaj financës shfaqet në dështimin e Takimeve botërore të nivelit të lartë në lidhje me mjedisin. Ekzistojnë tepër interesa të veçanta dhe shumë lehtë interesi ekonomik arrin të dalë mbi të mirën e përbashkët e të manipulojë informacionin për të mos lejuar që të goditen planet e tij. Në këtë linjë *Dokumenti i Aparecida-s* këron që «në ndërhyrjet mbi burimet natyrore të mos mbizotërojnë interesat e

grupeve ekonomike që shkatërrojnë në mënyrë të paarsyeshme burimet e jetës».^[32] Aleanca mes ekonomisë dhe teknologjisë arrin të lërë jashtë gjithçka që nuk bën pjesë në interesat e tyre të drejtpërdrejta. Kështu do të mund të priten vetëm disa shpallje sipërfaqësore, veprime filantropike të izoluara, si dhe përpjekje për të treguar ndjeshmëri ndaj mjedisit, ndërsa në të vërtetë çfarëdo përpjekjeje e organizatave shoqërore për t'i ndryshuar gjërat do të shihet si një shqetësim i shkaktuar nga ëndërrimtarë romantikë apo si një pengesë që duhet shmangur.

55. Pak nga pak disa Vende mund të dëftojnë përparime të rëndësishme, zhvillim të kontrolleve më të vlefshme dhe një luftë më të sinqertë kundër korrupsionit. Është rritur ndjeshmëria ekologjike e popullsisë, edhe pse nuk mjafton për të ndryshuar zakonet e dëmshme të konsumit, që nuk duket se po prapsen, por përkundrazi po

përhapen e zhvillohen. Për të sjellë vetëm një shembull të thjeshtë, është ajo që përdodh me shtimin në rritje të përdorimit dhe të intensitetit të kondicionerëve: tregjet, duke kërkuar një përfitim të menjëhershëm, e nxisin edhe më shumë kërkesën. Nëse dikush do ta vërente nga jashtë shoqërinë planetare, do të çuditej përballë një sjelljeje të tillë që nganjëherë duket vetëvrasëse.

56. Ndërkohë fuqitë ekonomike vazhdojnë ta justifikojnë sistemin aktual botëror, në të cilin mbizotërojnë një spekulim dhe një kërkim i fitimit financiar që priren të shpërfillin çdo kontekst dhe efektet mbi dinjitetin njerëzor e mbi mjedisin. Kështu vërehet se degradimi mjedisor dhe degradimi njerëzor e etik janë të lidhur ngushtë mes tyre. Shumë vetë do të thonë se nuk janë të vetëdijsëm se bëjnë veprime imorale, sepse shpërqendrimi i vazhdueshëm na e heq guximin për të vërejtur realitetin e një bote të kufizuar dhe me fund.

Prandaj sot «çfarëdo gjëje që është e brishtë, sikurse mjedisi, mbetet e pambrojtur para interesave të tregut të hyjnizuar, interesa të shndërruara në rregull absolut».^[33]

57. Është e parashikueshme që, përballë shterjes së disa burimeve, të fillojë të krijohet një skenar i volitshëm për luftëra të reja, të maskuara me kërkesa fisnike. Lufta i shkakton gjithmonë dëme të mëdha mjedisit dhe pasurisë kulturore të popujve, dhe rreziqet bëhen shumë të mëdha kur mendohet për armë bërthamore dhe për ato biologjike. Në të vërtetë «pavarësisht se marrëveshje tndërkombëtare e ndalojnë luftën kimike, bakteriologjike e biologjike, fakt është se në laboratorë vazhdon kërkimi për zhvillimin e armëve të reja sulmues, e të afta t'i prishin ekuilibret natyrore».^[34] Prej politikës kërkohet një vëmendje më e madhe për t'i parandaluar e zgjidhur shkaqet që mund t'u japin fillësë konflikteve të reja. Por pushteti i

lidhur me financën është ai që i reziston më shumë kësaj përpjekjeje, dhe planet politike shpesh nuk kanë vizion të gjerë. Pse dëshirohet të ruhet sot një pushtet që do të kujtohet për paaftësinë e tij për të ndërhyrë kur kjo ishte diçka e ngutshme dhe e nevojshme për t'u bërë?

58. Në disa Vende ka shembuj pozitivë rezultatesh në përmirësimin e mjedisit, sikurse bonifikimi i disa lumenjve që janë ndotur për shumë dhjetëvjeçarë, rekuperimi i pyjeve autoktone, ose zbukurimi i peizazheve me vepra të restaurimit mjedisor, ose projekte ndërtimore me vlerë të madhe estetike, përparime në prodhimin e energjisë jo ndotëse, në përmirësimin e transporteve publike. Këto veprime nuk i zgjidhin problemet globale, por vërtetojnë se qenia njerëzore është ende e aftë të ndërhyjë pozitivisht. Pasi është krijuar për të dashur, në mes të kufizimeve të tij lulëzojnë në mënyrë të pashmangshme gjeste bujarie, solidariteti dhe kujdesi.

59. Në të njëjtën kohë, po rritet një ekologji sipërfaqësore apo në dukje që përforcon njëfarë pandjeshmërie dhe një papërgjegjësi të pamend. Siç ndodh shpesh në epoka krizash të thella, që kërkojnë vendime të guximshme, jemi të tunduar të mendojmë se ajo që është duke ndodhur nuk është e sigurt. Po të shikojmë në mënyrë sipërfaqësore, përtej disa shenjash të dukshme të ndotjes dhe të degradimit, duket se gjërat nuk janë aq keq dhe se planeti mund të mbetet për shumë kohë në kushtet aktuale. Kjo sjellje shmangëse na shërben për të mbajtur stilet tona të jetës, të prodhimit e të konsumit. Është një mënyrë të cilën qenia njerëzore e përdor për të ushqyer të gjitha veset vetëshkatërrimtare: duke u përpjekur të mos i shohë, duke luftuar për të mos i pranuar, duke shtyrë vendimet e rëndësishme, duke bërë kinse nuk është asgjë.

VII. NDRYSHIMI I OPINIONEVE

60. Së fundi, pranojmë se janë zhvilluar vizione e linja të ndryshme mendimi në lidhje me situatën dhe me zgjidhjet e mundshme. Nga një skaj, disa mbështesin me çdo kusht mitin e përparimit dhe pohojnë se problemet ekologjike do të zgjidhen thjesht me zbatime të reja teknike, pa konsiderime etike dhe as ndryshime bazë. Nga skaji tjetër, të tjerë thonë se specia njerëzore, me çfarëdo ndërhyrjeje të saj, mund të jetë vetëm një kërcënim dhe ta dëmtojë ekosistemin botëror, prandaj është mirë të pakësohet prania e saj në planet dhe t'i ndalohej çdo lloj ndërhyrjeje. Mes këtyre skajeve, reflektimi duhet të identifikojë skenare të mundshme të ardhshme, sepse nuk ka vetëm një rrugëzgjidhje. Kjo do t'i linte hapësirë një larmie ndihmash që do të mund të hynin në dialog për të dhënë përgjigje të tërësishme.

61. Mbi shumë çështje konkrete Kisha nuk ka arsye të propozojë një fjalë përfundimtare dhe e kupton se duhet të dëgjojë e të nxisë debatin e ndershëm mes shkencëtarëve, duke respektuar larmitë e opinioneve. Por mjafton ta shikojmë realitetin me sinqeritet për të parë se ka një përkeqësim të shtëpisë sonë të përbashkët. Shpresa na fton të pranojmë se ka gjithmonë një rrugëdalje, se mundemi gjithmonë të ndryshojmë drejtim, se mundemi gjithmonë të bëjmë diçka për t'i zgjidhur problemet. Megjithatë, duket se po vërehen simptomat e një pike thyerjeje, për shkak të shpejtësisë së madhe të ndryshimeve dhe të degradimit, që shfaqen qoftë në katastrofa natyrore qoftë në kriza shoqërore apo edhe financiare, meqenëse problemet e botës nuk mund të analizohen e as të shpjegohen në mënyrë të izoluar. Ka rajone që tashmë janë veçanërisht në rrezik dhe, përtej çfarëdo parashikimi katastrofik, është e sigurt se sistemi

aktual botëror është i patolerueshëm nga këndvështrime të ndryshme, sepse kemi reshtur së menduari për qëllimet e veprimit njerëzor: «Nëse vështrimi përshkon rajonet e planetit tonë, vërejmë menjëherë se njerëzimi e ka zhgënjyer pritshmërinë hyjnore».^[35]

KAPITULLI I DYTË

UNGJILLI I KRIJIMIT

62. Pse të përfshihet në këtë dokument, të drejtuar të gjithë personave vullnetmirë, një kapitull referuar bindjeve të fesë? Jam i vetëdijshëm se, në fushën e politikës dhe të mendimit, disa e refuzojnë me forcë idenë e një Krijuesi, ose e konsiderojnë atë të parëndësishme, deri në atë pikë sa ta izolojnë në fushën e irracionales pasurinë që besimet mund të ofrojnë për një ekologji të tërësishme dhe për zhvillimin e plotë të gjinisë njerëzore. Herë të tjera supozhet se ato përbëjnë një nënkulturë që thjesht duhet të tolerohet. Megjithatë, shkenca dhe besimi, që i japin kritere të ndryshme realitetit, mund të hyjnë në dialog të fortë dhe produktiv për të dy.

I. DRITA QË FEJA JEP

63. Nëse mbajmë parasysh kompleksitetin e krizës ekologjike dhe shkaqet e saj të shumta, duhet të pranojmë se zgjidhjet nuk mund të vijnë nga një mënyrë e vetme e interpretimit dhe shndërrimit të realitetit. Është e nevojshme të përdoren edhe pasuritë e ndryshme kulturore të popujve, arti dhe poezia, jeta e brendshme dhe përshtirëria. Nëse duam me të vërtetë të ndërtojmë një ekologji që na lejon të ndreqim gjithçka që kemi shkatërruar, atëherë asnjë degë e shkencave dhe asnjë formë e urtisë nuk mund të lihet pas dore, as ajo fetare me gjuhën e vet përkatëse. Gjithashtu, Kisha Katolike është e hapur ndaj dialogut me mendimin filozofik, dhe kjo i lejon të prodhojë sinteza të ndryshme mes fesë e arsyes. Për sa u përket çështjeve shoqërore, kjo mund të konstatohet në zhvillimin e doktrinës shoqërore të Kishës, të thirrur për t'u pasuruar gjithnjë e më shumë duke

filluar prej sfidave të reja.

64. Nga ana tjetër, edhe pse kjo Enciklikë i hapet një dialogu me të gjithë për të kërkuar së bashku rrugëtime lirimi, dua të tregoj që prej fillimit se si bindjet e fesë u japin të krishterëve, dhe pjesërisht edhe besimtarëve të tjerë, motivime të larta që të kujdesen për natyrën dhe për vëllezërit e motrat më të dobët. Nëse vetëm fakti se jemi qenie njerëzore i nxit personat të kujdesen për mjedisin pjesë e të cilit janë, «të krishterët, në veçanti, ndiejnë se detyrat e tyre brenda botës së krijuar, detyrat e tyre ndaj natyrës dhe Krijuesit janë pjesë e fesë së tyre».^[36] Prandaj, është një e mirë për njerëzimin dhe për botën që ne besimtarët t'i njohim më mirë angazhimet ekologjike që burojnë prej bindjeve tona.

II. URTIA E TREGIMEVE BIBLIKE

65. Pa paraqitur përsëri këtu gjithë

teologjinë e Krijimit, pyesim veten se çfarë na thonë tregimet e mëdha biblike mbi marrëdhënien e qenies njerëzore me botën. Në tregimin e parë të veprës krijuese në librin e Zanafillës, plani i Hyjit përfshin krijimin e njerëzimit. Pas krijimit të burrit dhe të gruas, thuhet se «Hyji shikoi gjithçka kishte bërë dhe, ja, ishin *shumë të mira*» (Zan 1,31). Bibla mëson se çdo qenie njerëzore është krijuar për dashuri, është bërë në shëmbëlltyrë dhe përngjasim të Hyjit (krh. Zan 1,26). Ky pohim na tregon dinjitetin e pamasë të çdo personi njerëzor, që «nuk është vetëm ndonjë gjë, por dikush. Është i aftë ta njohë veten, ta zotërojë veten, të dhurohet lirisht dhe të hyjë në bashkim me persona të tjerë».^[37] Shën Gjon Pali II ka kujtuar se si dashuria krejt e veçantë që Krijuesi ka për çdo qenie njerëzore «i jep atij një dinjitet të pafund».^[38] Ata që angazhohen në mbrojtjen e dinjitetit të personave mund të gjejnë në fenë e krishterë arsyet më të thella për këtë angazhim. Sa siguri e mrekullueshme

është të dimë se jeta e çdo personi nuk humbet në një kaos dëshpërues, në një botë të drejtuar prej rastësisë së pastër apo prej cikleve që përsëriten pa kuptim! Krijuesi mund t'i thotë secilit prej nesh: «Para se të të trajtoja në kraharorin amënor, të njoha» (*Jer 1,5*). Jemi ngjizur në zemrën e Hyjit dhe prandaj «secili prej nesh është fryti i një mendimi të Hyjit. Secili prej nesh është i dëshiruar, secili është i dashur, secili është i nevojshëm».³⁹

66. Tregimet e krijimit në librin e Zanafillës përmbajnë, në gjuhën e tyre simbolike dhe tregimtare, mësimet mëdha mbi ekzistencën njerëzore dhe realitetin e saj historik. Këto tregime sugjerojnë se ekzistenca njerëzore bazohet në tri marrëdhënie themelore të lidhura ngushtë mes tyre: marrëdhënia me Hyjin, ajo me të afërmin dhe ajo me tokën. Sipas Biblës, këto tri marrëdhënie jetësore janë prishur, jo vetëm jashtë, por edhe brenda nesh.

Kjo prishje është mëkati. Harmonia mes Krijuesit, njerëzimit dhe gjithë botës së krijuar është shkatërruar sepse ne kemi pretenduar të zëmë vendin e Hyjit, duke mos pranuar ta njohim veten si krijesa të kufizuara. Ky fakt e ka shtrembëruar edhe natyrën e mandatit për ta sunduar tokën (krh. *Zan 1,28*) dhe për ta kultivuar e ruajtur atë (krh. *Zan 2,15*). Si rezultat, marrëdhënia fillimisht harmonike mes qenies njerëzore dhe natyrës është shndërruar në konflikt (krh. *Zan 3,17-19*). Prandaj është domethënëse që harmonia të cilën shën Françesku i Asizit e jetonte me të gjitha krijesat është interpretuar si një shërim i kësaj prishjeje. Shën Bonaventura ka thënë se nëpërmjet pajtimit universal me të gjitha krijesat në njëfarë mënyre Françesku ishte kthyer në gjendjen e pafajësisë zanafillore.^[40] Larg prej atij modeli, sot mëkati shfaqet me të gjithë forcën e vet të shkatërrimit në luftërat, në format e ndryshme të dhunës e keqtrajtimit, në braktisjen e më të dobtëve, në sulmet kundër natyrës.

67. Ne nuk jemi Hyji. Toka na paraprin dhe na është dhënë. Kjo na lejon t'i përgjigjemi një akuze të hedhur kundër mendimit hebraiko-të krishterë: është thënë se, duke nisur prej tregimit të Zanafillës që na fton ta sundojmë tokën (krh. *Zan* 1,28), favorizohet shfrytëzimi i egër i natyrës duke paraqitur një figurë të qenies njerëzore si sundues dhe shkatërrimtar. Ky nuk është një interpretim i saktë i Biblës siç e kupton Kisha. Edhe pse është e vërtetë se nganjëherë të krishterët i kanë interpretuar Shkrimet në mënyrë jo të saktë, sot duhet të refuzojmë me forcë se prej faktit që jemi krijuar në shëmbëlltysë të Hyjit dhe prej mandatit për ta sunduar tokën mund të nxirret një sundim absolut mbi krijesat e tjera. Është e rëndësishme t'i lexojmë tekstet biblike në kontekstin e tyre, me një hermeneutikë të drejtë, dhe të kujtojmë se ato na ftojnë «ta punojmë dhe ta ruajmë» kopshtin e botës (krh. *Zan* 2,15). Ndërsa «ta punojmë» do të thotë ta lërojmë

apo ta mihim një terren, «të ruajmë» do të thotë të mbrojmë, të kujdesemi, të shpëtojmë, të mbikëqyrim. Kjo kërkon një marrëdhënie ndërsjellshmërie të përgjegjshme mes qenies njerëzore dhe natyrës. Çdo bashkësi mund të marrë prej mirësisë së tokës atë për të cilën ka nevojë për mbijetesën e vet, por ka edhe detyrën ta mbrojë atë dhe të garantojë vazhdimësinë e pjellorisë së saj për brezat e ardhshëm. Si përfundim, «e Zotit është toka» (*Ps 24,1*), Atij i përket «toka dhe gjithçka është në të» (*Lp 10,14*). Prandaj Hyji mohon çdo pretendim për pronësi absolute: «Toka nuk mund të shitet për përgjithmonë, sepse është imja, kurse ju jeni tek unë vetëm të ardhur e pendarë» (*Lev 25,23*).

68. Kjo përgjegjësi përballë një toke që është e Hyjit, kërkon që qenia njerëzore, e pajisur me inteligjencë, t'i respektojë ligjet e natyrës dhe ekuilibret delikate mes qenieve të kësaj bote, sepse «ai urdhëroi e ato u bënë; i vendosi ato

për jetë të jetës sipas ligjit që nuk njih ndryshim» (Ps 148,5b-6). Prej kësaj rrjedh fakti se legjislacioni biblik ndalet për t'i paraqitur qenies njerëzore norma të ndryshme, jo vetëm në marrëdhënie me qeniet e tjera njerëzore, por edhe në marrëdhënie me qenie të tjera të gjalla: «Nëse sheh se është rrëzuar gomari ose kau i vëllait tënd në rrugë, mos u shmang [...]. Nëse, duke bërë rrugë, në një dru ose në tokë gjen një çerdhe të ndonjë shpendi dhe nënën duke ndenjuri mbi zogj ose mbi vezë, mos ua merr zogjve nënën» (Lp 22,4.6). Në këtë linjë, pushimi i ditës së shtatë nuk propozohet vetëm për qenien njerëzore, por edhe «që të pushojë kau e gomari yt» (Dal 23,12). Kështu kuptojmë se Bibla nuk i jep rast një antropocentrizmi despotik që nuk interesohet për krijesat e tjera.

69. Ndërsa mund të bëjmë një përdorim të përgjegjshëm të gjërave, jemi të thirrur të pranojmë se qeniet e tjera të gjalla kanë një vlerë të vetën përballë Hyjit

dhe «me ekzistencën e tyre të thjeshtë e bekojnë dhe i japin lavdi»,^[41] sepse Zoti gëzohet në veprat e veta (krh. *Ps* 104,31). Pikërisht për dinjitetin e vet unikal dhe sepse është e pajisur me inteligjencë, qenia njerëzore është e thirrur ta respektojë botën e krijuar me ligjet e veta të brendshme, sepse «me dije Zoti ia qiti tokës themelet» (*Fu* 3,19). Sot Kisha nuk thotë në mënyrë thjeshtësuese se krijesat e tjera janë krejtësisht të nënshtruara së mirës së qenies njerëzore, a thua se ato nuk kanë një vlerë në vetvete dhe ne mund t'i përdorim sipas qejfit. Kështu Ipeshkvinjtë e Gjermanisë kanë shpjeguar se për krijesat e tjera «mund të flitet për parësi të *të qenit* përballë *të qenit të dobishme*».^[42] Katekizmi vë në diskutim në mënyrë shumë të drejtpërdrejtë atë që do të ishte një antropocentrizëm i devijuar: «Çdo krijesë ka mirësinë e vet dhe përsosurinë e vet [...] Krijesat e ndryshme, të dëshiruara në qenien e tyre, reflektojnë, secila në mënyrën e vet, një rreze të urtisë dhe mirësisë së

pafundme të Hyjit. Prandaj njeriu duhet ta respektojë mirësinë përkatëse të çdo krijese, për të shmangur një përdorim të çrregullt të gjërave».^[43]

70. Në tregimin e Kainit dhe Abelit, shohim se xhelozia e ka shtyrë Kainin të kryejë padrejtësinë e skajshme kundër vëllait të vet. Kjo nga ana e vet ka shkaktuar një prishje të marrëdhënies mes Kainit e Hyjit dhe mes Kainit e tokës, prej së cilës mërgoi. Kjo pjesë është përmbledhur në bashkëbisedimin dramatik mes Hyjit dhe Kainit. Hyji pyet: «Ku është vëllai yt?». Kaini thotë se nuk e di dhe Hyji këmbëngul: «Po çka bëre?! Zëri i gjakut të vëllait tënd bërtet tek unë prej dheut. Prandaj qofsh mallkuar e dëbuar nga ara» (Zan 4,9-11). Shpërfillja e angazhimit për të punuar dhe për të ruajtur një marrëdhënie korrekte me të afërmin, për të cilin kam detyrën të kujdesem dhe ta ruaj, e shkatërron marrëdhënien time të brendshme me vetveten, me të tjerët, me

Hyjin dhe me tokën. Kur të gjitha këto marrëdhënie shpërfillen, kur drejtësia nuk banon më mbi tokë, Bibla na thotë se e gjithë jeta është në rrezik. Kjo është ajo që na mëson tregimi i Noehut, kur Hyji kërcënon se do ta shfarosë njerëzimin për arsye të paaftësisë së tij të vazhdueshme për të jetuar në lartësinë e kërkesave të drejtësisë dhe të paqes: «Për mua erdhi dita të shfaros çdo njeri. Toka është mbushur me ligësi për shkak të njerëzve» (*Zan 6,13*). Në këto tregime kaq të hershme, të pasura me një simbolizëm të thellë, përmbahej një bindje që sot ndihet shumë: se gjithçka është në marrëdhënie, dhe se kujdesi i njëmendtë për jetën tonë dhe për marrëdhëniet tona me natyrën është i pandashëm prej vëllazërisë, prej drejtësisë dhe prej besnikërisë ndaj të tjerëve.

71. Edhe pse «paudhësia e njerëzve përmbi tokë ishte e madhe» (*Zan 6,5*) dhe Hyjit «i erdhi keq pse e krijoi

njeriun përmbi tokë» (*Zan 6,6*), gjithsesi, nëpërmjet Noehut, që mbetej ende i ndershëm dhe i drejtë, Hyji ka vendosur të hapë një rrugë shpëtimi. Në këtë mënyrë i ka dhënë njerëzimit mundësinë për një fillim të ri. Mjafton një njeri i mirë që të ketë shpresë! Tradita biblike përcakton qartë se ky reabilitim sjell rizbulimin dhe respektimin e ritmeve të vendosura në natyrë prej dorës së Krijuesit. Kjo shihet, për shembull, në ligjin e *Shabbat*-it. Të shtatën ditë Hyji pushoi prej të gjitha veprave të veta. Hyji i urdhëroi Izraelit që çdo ditë e shtatë duhej të kremtohej si ditë e pushimit, një *Shabbat* (krh. *Zan 2,2-3; Dal 16,23; 20,10*). Nga ana tjetër, u caktua edhe një vit sabatik për Izraelin dhe tokën e tij, çdo shtatë vjet (krh. *Lev 25,1-4*), gjatë të cilit i lihej një pushim i plotë tokës, nuk mbillej dhe korrej vetëm e domosdoshmja për të mbijetuar dhe për të ofruar mikpritje (krh. *Lev 25,4-6*). Së fundi, kur kalonin shtatë shtatëshe vitesh, pra dyzet e nëntë vjet, kremtohej jubileu, vit i faljes universale

dhe i «çlirimit të të gjithë banorëve» (krh. *Lev 25,10*). Zhvillimi i këtij legjislacioni është përpjekur të sigurojë ekuilibrin dhe drejtësinë në marrëdhëniet e qenies njerëzore me të tjerët dhe me tokën ku jetonte e punonte. Por, në të njëjtën kohë, ishte një njohje e faktit se dhurata e tokës me frytet e veta i përket gjithë popullit. Ata që e punonin dhe e ruanin territorin duhej të bashkëndanin frytet e tij, në veçanti me të varfrit, vejushat, jetimët dhe të huajt: «Kur të korrësh prodhimet e tokës sate, mos e korr deri në skajin e arës sate dhe mos i mblidh kallinjtë që kanë rënë. Kështu as në vreshtin tënd mos i mblidh vilet dhe kokrrat e rëna, por lëri t'i mbledhin skamnorët dhe udhëtarët» (*Lev 19,9-10*).

72. Psalmet e ftojnë shpesh qenien njerëzore ta lëvdojë Hyjin krijues, Atë që «e forcoi tokën mbi ujëra, sepse e amshueshme është dashuria e tij» (*Ps 136,6*). Por i ftojnë edhe krijesat e tjera në lavd: «Lavdërojeni, diell e hënë,

lavdërojeni, të gjitha yjet ndriçuese!
Lavdërojeni, qiejt e qiejve, edhe ju, o
ujëra, që jeni mbi qiell! Le ta lavdërojnë
Emrin e Zotit, sepse ai urdhëroi e ato u
bënë» (Ps 148,3-5). Ekzistojmë jo vetëm
prej fuqisë së Hyjit, por para Tij dhe me
Të. Prandaj ne e adhurojmë.

73. Shkrimet e profetëve ftojnë të
rigjendet forca në momentet e vështira
duke soditur Hyjin e fuqishëm që ka
krijuar gjithësinë. Fuqia e pafund e
Hyjit nuk na bën t'i ikim dashurisë së tij
atërore, sepse në Të bashkohen dashuria
dhe forca. Në të vërtetë, çdo përshpirtëri
e shëndoshë do të thotë në të njëjtën
kohë ta pranojmë dashurinë hyjnore dhe
ta adhurojmë me besim Zotin për fuqinë
e tij të pafundme. Në Bibël, Hyji që liron
e shpëton është i njëjti që ka krijuar
gjithësinë, dhe këto dy mënyra hyjnore
të të vepruarit janë të lidhura ngushtë
dhe në mënyrë të pandashme: «Ah, o
Zot, Hyj, ti e përfitove qiellin e tokën
me fuqinë tënde të madhe e me krah

të shtrirë! Për ty asgjë s'është e vështirë [...]. Ti e nxore popullin tënd Izraelin nga toka e Egjiptit me shenja e me mrekulli të mëdha» (*Jer 32,17.21*). «Hyji është Zot i amshueshëm, Krijuesi i botës skaj më skaj. Ai nuk lodhet, ai s'moliset, e pashqyrtueshme është dija e tij. Ai të lodhurit i jep fuqi, të pamundshmit ia shton fuqitë» (*Is 40,28b-29*).

74. Përvoja e skllavërisë në Babiloni krijoi një krizë shpirtërore që çoi në një thellim të fesë në Hyjin, duke shprehur gjithëpushtetësinë e tij krijuese, për ta nxitur popullin që të rigjejë shpresën në mes të situatës së vet të mjerë. Shekuj më vonë, në një moment tjetër prove dhe përndjekjeje, kur Perandoria Romake u përpoq të impononte një sundim absolut, besimtarët gjetën përsëri ngushëllim e shpresë duke e shtuar besimin e tyre në Hyjin e gjithëpushtetshëm, dhe këndonin: «Të mëdha dhe të mrekullueshme janë veprat e tua, o Zot, Hyj, o i Gjithëpushtetshëm! Të drejta

dhe të vërteta janë udhët e tua!» (Zb 15,3). Nëse Hyji ka mundur ta krijojë gjithësinë prej asgjësë, mundet edhe të ndërhyjë në këtë botë dhe të mposhtë çdo formë të së keqes. Pra, padrejtësia nuk është e pathyeshme.

75. Nuk mund të mbështesim një përshpirtëri që e harron Hyjin e gjithëpushtetshëm dhe krijues. Në këtë mënyrë do të përfundonim të adhuronim fuqi të tjera të botës, ose do ta vendosnim veten në vendin e Zotit, aq sa të pretendonim ta shkëlnim realitetin e krijuar prej Tij pa njohur kufij. Mënyra më e mirë për ta vendosur qenien njerëzore në vendin e vet dhe për t'i dhënë fund pretendimit të saj se është sunduese absolute e tokës, është të paraqesim përsëri figurën e një Ati krijues dhe zotëruesi të vetëm të botës, sepse përndryshe qenia njerëzore do të priret gjithmonë të dëshirojë t'i imponojë realitetit ligjet e veta dhe interesat e veta.

III. MISTERI I GJITHËSISË

76. Për traditën judeo-të krishterë, të thuash “krijim” është më shumë se sa të thuash natyrë, sepse ka të bëjë me një plan të dashurisë së Hyjit, ku çdo krijesë ka një vlerë dhe një domethënie. Natyra shpesh kuptohet si një sistem që analizohet, kuptohet dhe administrohet, por krijimi mund të kuptohet vetëm si një dhuratë që del prej dorës së hapur të Atit të të gjithëve, si një realitet i ndriçuar prej dashurisë që na thërret në një bashkim të gjithëmbarshëm.

77. «Prej fjalës së Zotit u krijuan qiejt» (Ps 33,6). Kështu na tregohet se bota e ka prejardhjen nga një vendim, jo nga kaosi apo nga rastësia, dhe kjo e lartëson edhe më shumë. Në këtë ka një zgjedhje të lirë dhe të shprehur në fjalën krijuese. Gjithësia nuk ka lindur si rezultat i një gjithëpushtetësie arbitrare, i një demonstrimi force apo i një dëshire për vetafirmim. Krijimi i përket rendit

të dashurisë. Dashuria e Hyjit është arsyeja themelore e gjithë botës së krijuar: «Vërtet, ti do gjithçka është dhe s'urren asgjë që ke krijuar: sepse, po ta kishe urreyer ndonjë gjë, nuk e kishe krijuar» (*Urt* 11,24). Kështu, çdo krijesë është objekt i dashurisë së Atit, që i cakton një vend në botë. Madje edhe jeta kalimtare e qenies më të parëndësishme është objekt i dashurisë së tij, dhe në ato pak sekonda ekzistencë, Ai e rrethon me dashurinë e vet. Shën Bazili i Madh thoshte se Krijuesi është edhe «mirësia pa llogari»,^[44] dhe Dante Aligieri fliste për «dashurinë që lëviz diellin dhe yjet e tjerë».^[45] Prandaj, prej veprave të krijuara arrihet «deri në mëshirën e tij plot dashuri».^[46]

78. Në të njëjtën kohë, mendimi hebraiko-i krishterë e ka demitizuar natyrën. Pa reshtur së admiruari atë për shkëlqimin dhe pafundësinë e saj, nuk i ka dhënë më një karakter hyjnor. Në këtë mënyrë theksohet më tej angazhimi ynë

ndaj saj. Një kthim në natyrë nuk mund të jetë në dëm të lirisë dhe të përgjegjësisë së qenies njerëzore, që është pjesë e botës me detyrën që të kultivojë aftësitë e veta për ta mbrojtur dhe për të zhvilluar potencialitetet e saj. Nëse e njohim vlerën dhe brishtësinë e natyrës, e në të njëjtën kohë aftësitë që Krijuesi na ka dhënë, kjo na lejon sot t'i japim fund mitit modern të përparimit material të pakufizuar. Një botë e brishtë, me një qenie njerëzore së cilës Hyji ia beson kujdesin për të, i bën thirrje inteligjencës sonë për të njohur se si duhet ta orientojmë, kultivojmë dhe kufizojmë pushtetin tonë.

79. Në këtë gjithësi, të përbërë prej sistemesh të hapura që hyjnë në komunikim me njëri-tjetrin, mund të zbulojmë forma të panumërta marrëdhënieje dhe pjesëmarrjeje. Kjo na bën ta mendojmë tërësinë si të hapur ndaj transhëndencës së Hyjit, brenda së cilës zhvillohet. Feja na lejon të interpretojmë domethënien dhe bukurinë e mistershme

të asaj që ndodh. Liria njerëzore mund të japë ndihmesën e vet inteligjente për një evolucion pozitiv, por mundet edhe të shtojë të këqija të reja, shkaqe të reja vuajtjeje dhe momente prapakhthimi të vërtetë. Kjo i jep jetë historisë apasionuese e dramatike njerëzore, të aftë të shndërrohet në një lulëzim lirimi, rritjeje, shpëtimi e dashurie, ose në një rrugëtim dekadence e shkatërrimi të ndërsjellë. Prandaj, veprimi i Kishës jo vetëm përpiket të kujtojë detyrën që të kujdesemi për natyrë, por në të njëjtën kohë «duhet të mbrojë sidomos njeriun kundër shkatërrimit të vetvetes».^[47]

80. Pavarësisht prej kësaj, Hyji, që dëshiron të veprojë me ne dhe të ketë bashkëpunimin tonë, është në gjendje edhe të nxjerrë diçka të mirë prej të këqijave që ne bëjmë, sepse «Shpirti Shenjt ka një krijimtari të pafundme, karakteristike të mendjes hyjnore, që di të kujdeset për t'i zgjidhur nyjat e ngjarjeve njerëzore qofshin ato edhe

të ndërlikuara e të padepërtueshme». ^[48] Në ndonjë mënyrë, Ai ka dashur ta kufizojë vetveten duke krijuar një botë që ka nevojë për zhvillim, ku shumë gjëra që ne i konsiderojmë të këqija, rreziqe apo burime vuajtjeje, në të vërtetë bëjnë pjesë në dhimbjet e lindjes, që na nxisin të bashkëpunojmë me Krijuesin. ^[49] Ai është i pranishëm në thellësinë e çdo gjëje pa e kushtëzuar autonominë e krijesës së vet, dhe, edhe kjo i jep jetë autonomisë së ligjshme të realiteteve tokësore. ^[50] Kjo prani hyjnore, që siguron qëndrueshmërinë dhe zhvillimin e çdo qenieje, «është vazhdimi i veprimit krijues». ^[51] Shpirti i Hyjit e ka mbushur gjithësinë me potencialitetet të cilat lejojnë që prej vetë brendësisë së gjërave të mund të lulëzojë diçka e re: «Natyra nuk është gjë tjetër veçse arsyeja e njëfarë arti, veçanërisht e artit hyjnor, të vënë në gjërat, prej të cilit vetë gjërat lëvizin drejt një qëllimi të caktuar. Sikur mjeshtri ndërtoes anijesh të mund t'i jepte drurit aftësinë të lëvizte

vetë për të marrë formën e anijes».^[52]

81. Qenia njerëzore, megjithëse supozon edhe procese evolutive, sjell një risi jo plotësisht të shpjegueshme prej evolucionit të sistemeve të tjera të hapura. Secili prej nesh ka në vetvete një identitet personal në gjendje të hyjë në dialog me të tjerët dhe me vetë Hyjin. Aftësia për reflektim, arsyetimi, krijimtaria, interpretimi, përpunimi artistik dhe aftësi të tjera origjinale tregojnë një veçanti që e tejkalon fushën fizike dhe biologjike. Risia cilësore e përfshirë prej lindjes së një qenieje personale brenda gjithësisë materiale presupozon një veprim të drejtpërdrejtë të Hyjit, një thirrje të veçantë në jetë dhe në marrëdhënien e një Personi me një tjetër person. Duke nisur prej teksteve biblike, e konsiderojmë personin si subjekt, që nuk mund të kufizohet kurrë në kategorinë e objektit.

82. Por do të ishte e gabuar edhe të

mendonim se qeniet e tjera të gjalla duhet të konsiderohen thjesht si objekte të nënshtruara sundimit arbitrar të qenies njerëzore. Kur propozohet një vizion i natyrës vetëm si objekt i përfitimit dhe i interesit, kjo sjell edhe pasoja të rënda për shoqërinë. Vizioni që përforcon pushtetin e më të fortit ka favorizuar pabarazi të pamasa, padrejtësi dhe dhuna për pjesën më të madhe të njerëzimit, sepse burimet bëhen pronë e të parit që arrin ose të atij që ka më shumë pushtet: fitimtari merr gjithçka. Ideali i harmonisë, i drejtësisë, i vëllazërisë dhe i paqes që Jezusi propozon është diametralisht i kundërt me këtë model, dhe kështu e shprehte ai duke iu referuar fuqive të kohës së vet: «Ju e dini se sunduesit zotërojnë mbi popujt e vet e princat e tyre i mbajnë nën pushtet. Porse, ndërmjet jush nuk duhet të jetë ashtu! Përkundrazi, ai që prej jush do të bëhet i madh, le të bëhet shërbëtori juaj» (Mt 20,25-26).

83. Qëllimi i ecjes së gjithësisë është në plotësinë e Hyjit, që është arritur tashmë prej Krishtit të ringjallur, bosht i pjekurimit universal.^[53] Në këtë mënyrë shtojmë një argument të mëtejshëm për të refuzuar çfarëdo sundimi despotik dhe të papërgjegjshëm të qenies njerëzore mbi krijesat e tjera. Qëllimi përfundimtar i krijesave të tjera nuk jemi ne. Në të vërtetë, të gjitha përparojnë, së bashku me ne dhe nëpërmjet nesh, drejt cakut të përbashkët, që është Hyji, në një plotësi transhendente ku Krishti i ringjallur përqafton dhe ndriçon gjithçka. Në të vërtetë, qenia njerëzore, e pajisur me inteligjencë e dashuri, dhe e tërhequr prej plotësisë së Krishtit, është e thirrur t'i çojë të gjitha krijesat te Krijuesi i tyre.

IV. MESAZHI I ÇDO KRIJESE NË HARMONINË E GJITHË BOTËS SË KRIJUAR

84. Të këmbëngulim duke thënë se qenia njerëzore është shëmbëlltyrë e

Hyjit nuk duhet të na bëjë të harrojmë se çdo krijesë ka një funksion dhe asnjëra nuk është e tepërt. Krejt gjithësia materiale është një gjuhë e dashurisë së Hyjit, e dashurisë së tij të pamasë për ne. Dheu, uji, malet, gjithçka është përkëdhelje e Hyjit. Historia e miqësisë sonë me Hyjin zhvillohet gjithmonë në një hapësirë gjeografike që bëhet një shenjë shumë personale, dhe secili prej nesh ruan në kujtesë vende kujtimi i të cilave i bën shumë mirë. Ai që është rritur mes maleve, ose që kur ishte fëmijë ulej pranë një përroi për të pirë, ose ai që luante në një shesh të lagjes së vet, kur kthehet në ato vende ndihet i thirrur të rifitojë identitetin e vet.

85. Hyji ka shkruar një libër të mrekullueshëm, «shkronjat e të cilit janë shumësia e krijesave të pranishme në gjithësi».^[54] Ipeshkvinjtë e Kanadasë e kanë shprehur mirë se asnjë krijesë nuk mbetet jashtë këtij dëftimi të Hyjit: «Që prej panoramave më të gjera deri tek

format më të vogla të jetës, natyra është një burim i vazhdueshëm mrekullimi dhe nderimi. Gjithashtu, ajo është një zbulim i vazhdueshëm i hyjnores».^[55] Ipeshkvinjtë e Japonisë, nga ana e tyre, kanë thënë diçka shumë prekëse: «Ta perceptojmë çdo krijesë tek këndon himnin e ekzistencës së vet do të thotë të jetojmë me gëzim në dashurinë e Hyjit dhe në shpresë».^[56] Kjo soditje e botës së krijuar na lejon të zbulojmë nëpërmjet çdo gjëje ndonjë mësim që Hyji dëshiron të na e komunikojë, sepse «për besimtarin të sodisë botën e krijuar do të thotë edhe të dëgjojë një mesazh, të ndiejë një zë paradoksal dhe të heshtur».^[57] Mund të themi se «pranë zbulimit, në kuptimin përkatës, që përmbahet në Shkrimet e Shenjta, ka, pra, një dëftim hyjnor në shkëlqimin e diellit dhe në rënien e natës».^[58] Duke i kushtuar vëmendje këtij dëftimi, qenia njerëzore mëson ta njohë vetveten në marrëdhënie me krijesat e tjera: «Unë shprehem duke shprehur botën; unë eksploroj

sakralitetin tim duke deshifruar atë të botës».^[59]

86. Tërësia e gjithësisë, me marrëdhëniet e veta të shumëfishta, e tregon më së miri pasurinë e pashtershme të Hyjit. Shën Toma i Akuinit ka theksuar urtisht se shumësia dhe larmia vijnë «prej qëllimit të vepruesit të parë», i Cili ka dashur që «ajo që i mungon secilës gjë për të paraqitur mirësinë hyjnore të zëvendësohet prej gjërash të tjera»,^[60] sepse mirësia e tij «nuk mund të paraqitet siç duhet nga një krijesë e vetme». ^[61] Prandaj, kemi nevojë ta shohim larminë e gjërave në marrëdhëniet e tyre të shumëfishta.^[62] Pra, kuptohen më mirë rëndësia dhe domethënia e çfarëdo krijese, nëse ajo soditet në tërësinë e planit të Hyjit. Këtë mëson *Katekizmi*: «Ndërvarësia e krijesave është dëshiruar prej Hyjit. Dielli e hëna, cedri e lulja e vogël, shqiponja e trumcaku: larmitë dhe pabarazitë e panumërta tregojnë se asnjë krijesë nuk i mjafton vetvetes,

se ato ekzistojnë vetëm në varësi prej njëra-tjetrës, për t'u përplotësuar ndërsjellshmërisht, në shërbim të njëra-tjetrës». ^[63]

87. Kur arrijmë të shohim refleksin e Hyjit në gjithçka që ekziston, zemra përjeton dëshirën për ta adhuruar Zotin për të gjitha krijesat e tij dhe së bashku me to, siç duket në këngën shumë të bukur të shën Françeskut të Asizit:

«Qofsh i lëvduar, Zoti im, me të gjitha krijesat e Tua, veçanërisht për zotin tim vëlla Diellin, i cili është i shndritshëm, nëpërmjet tij tin a ndriçon.

Ai është i bukur dhe rrezëllues, me shkëlqim të madh:

Shembëllimi yt, është o i Tejetlartë.

Qofsh lëvduar Zoti im, për motrën Hënë dhe Yjet: në qiell i ke krijuar të qarta dhe të çmueshme dhe të bukura.

Qofsh Lëvduar, Zoti im, për motrën Erë dhe për motin e vrenjtur dhe të kthjellët e për çdo stinë, nëpërmjet të cilës përkrah krijesat e tua.

*Qofsh lëvduar Zoti im, për vëlla Ujin,
i cili është fort i dobishëm e i përvuajtur
dhe i çmueshëm e i dëlirë.*

*Qofsh lëvduar, Zoti im, për vëlla Zjarrin,
nëpërmjet të cilit ndriçon për ne natën: ai
është i bukur dhe i hareshëm, i fortë dhe i
fuqishëm».^[64]*

88. Ipeshkvinjtë e Brazilit kanë vënë në dukje se e gjithë natyra, përveçse dëfton Hyjin, është edhe vend i pranisë së tij. Në çdo krijesë banon Shpirti i tij gjallërues që na thërret në një marrëdhënie me Të.^[65] Zbulimi i kësaj pranie nxit në ne zhvillimin e «virtyteve ekologjike».^[66] Por kur themi këtë, nuk harrojmë se ekziston edhe një largësi e pafundme, se gjërat e kësaj bote nuk e kanë plotësinë e Hyjit. Përndryshe as nuk do t'i bënim një të mirë krijesave, sepse nuk do ta njihnim vendin e tyre përkatës dhe të njëmendtë, dhe do të arrinim të kërkonim pa të drejtë prej tyre atë që në vogëlsinë e tyre nuk mund të na e japin.

V. NJË BASHKIM UNIVERSAL

89. Krijesat e kësaj bote nuk mund të konsiderohen një pasuri pa pronar: «Janë të tuat, o Zot jetëdashës» (*Urt* 11,26). Kjo çon në bindjen se, meqenëse jemi krijuar prej të njëjtit Atë, ne të gjitha qeniet e gjithësisë jemi të bashkuar nga lidhje të padukshme dhe formojmë njëfarë familjeje universale, një bashkim sublim që na nxit në një respekt të shenjtë, plot dashuri dhe përvujturi. Dua të kujtoj se «Hyji na ka bashkuar aq ngushtë me botën që na rrethon, sa shkretimi i dheut është si një sëmundje për secilin, dhe mund të ankohemi për zhdukjen e një specieje sikur të ishte një gjymtim».^[67]

90. Kjo nuk do të thotë t'i barazojmë të gjitha qeniet e gjalla dhe t'ia heqim qenies njerëzore atë vlerë të posaçme që mban në vete në të njëjtën kohë një përgjegjësi të tmerrshme. Dhe as nuk do të thotë një hyjnizim i tokës, që do të na privonte prej thirrjes për të bashkëpunuar me

të dhe për ta mbrojtur brishtësinë e saj. Këto konceptime do të arrinin të krijonin çekuilibra të reja në përpjekjen për t'iu shmangur realitetit që na bën thirrje.^[68] Nganjëherë vërehet obsesioni për t'i mohuar personit njerëzor çfarëdo epërsie, dhe çohet përpara një luftë për speciet e tjera që nuk e vëmë në veprim për të mbrojtur dinjitetin e barabartë mes qenieve njerëzore. Sigurisht duhet të shqetësohemi që qeniet e tjera të gjalla të mos trajtohen në mënyrë të papërgjegjshme, por duhet të na indinjojnë sidomos pabarazitë tejet të mëdha që ekzistojnë mes tyre, sepse vazhdojmë të tolerojmë që disa të konsiderohen më të denjë se të tjerët. Nuk e vërejmë më se disa zvarriten në një mjerim degradues, pa mundësi reale për përmirësim, ndërsa të tjerë nuk dinë as se çfarë të bëjmë me atë që kanë, pretendojnë me mendjemadhësi një epërsi të tyre dhe lënë pas vetes një nivel shkapërderdhjeje të tillë që do të ishte e pamundur të përgjithësohej pa

e shkatërruar planetin. Vazhdojmë në faktet të pranojmë që disa të ndihen më njerëzorë se të tjerët, a thua se kanë lindur me të drejta më të mëdha.

91. Nuk mund të jetë e njëmendtë një ndjenjë bashkimi të ngushtë me qeniet e tjera të natyrës, nëse në të njëjtën kohë në zemër nuk ka ëmbëlsi, dhembshuri dhe shqetësim për qeniet njerëzore. Është e dukshme inkoherenca e atyre që luftojnë trafikun e kafshëve në rrezik për t'u zhdukur, por mbeten krejtësisht mospërfillës përballë trafikut të personave, nuk interesohen për të varfrit, ose janë të vendosur të shkatërrojnë një tjetër qenie njerëzore që nuk u pëlqen. Kjo vë në rrezik kuptimin e luftës për mjedisin. Nuk është e rastit që, në këngën në të cilën lëvdon Hyjin për krijesat, shën Françesku shton: «Lëvduar qofsh, o Zoti im, për ata që falin për hatrin tënd». Gjithçka është e lidhur. Prandaj kërkohet një shqetësim për mjedisin i bashkuar me dashurinë

e sinqertë për qeniet njerëzore dhe një angazhim i vazhdueshëm në lidhje me problemet e shoqërisë.

92. Nga ana tjetër, kur zemra është me të vërtetë e hapur ndaj një bashkimi universal, asgjë dhe askush nuk është i përjashtuar nga kjo vëllazëri. Si rrjedhojë, është e vërtetë edhe se mospërfillja apo mizoria ndaj krijesave të tjera të kësaj bote arrijnë gjithmonë të zhvendosen në ndonjë mënyrë në trajtimin që u rezervojmë qenieve të tjera njerëzore. Zemra është një e vetme dhe i njëjti mjerim që bën të keqtrajtohet një kafshë nuk vonon të shfaqet në marrëdhënien me personat e tjerë. Çdo keqtrajtim ndaj çfarëdo krijese «është kundër dinjitetit njerëzor». ^[69] Nuk mund ta konsiderojmë veten persona që duan me të vërtetë nëse përjashtojmë prej interesave tona një pjesë të realitetit: «Paqja, drejtësia dhe mbrojtja e botës së krijuar janë tri çështje krejtësisht të lidhura, që nuk do të mund të ndahen në mënyrë që të

trajtohen veçmas, përveçse duke rënë përsëri në reduktionizëm».^[70] Gjithçka është në marrëdhënie, dhe të gjithë ne qeniet njerëzore jemi të bashkuar si vëllezër e motra në një shtegtim të mrekullueshëm, të lidhur prej dashurisë që Hyji ka për secilën prej krijesave të veta dhe që na bashkon edhe mes nesh, me një dashuri të ëmbël, me vëllain diell, me motrën hënë, me vëllain lumë dhe me nënën tokë.

VI. DESTINACIONI I PËRBASHKËT I TË MIRAVE

93. Sot, besimtarët dhe jo besimtarët janë të një mendjeje në lidhje me faktin se toka është në thelb një trashëgimi e përbashkët, frytet e së cilës duhet të shkojnë në dobi të të gjithëve. Për besimtarët kjo bëhet një çështje besnikërie ndaj Krijuesit, sepse Hyji e ka krijuar botën për të gjithë. Si rrjedhojë, çdo propozim ekologjik duhet të integrojë një perspektivë shoqërore

që mban parasysh të drejtat themelore të atyre që janë më pak të favorizuar. Parimi i varësisë së pronës private ndaj destinacionit universal të të mirave dhe, prandaj, e drejta universale për përdorimin e tyre, është një “rregull i artë” i sjelljes shoqërore, dhe «parimi i parë i gjithë rendit etiko-shoqëror».^[71] Tradita e krishterë nuk e ka njohur kurrë si absolute apo të paprekshme të drejtën për pronë private, dhe ka vënë në pah funksionin shoqëror të çfarëdo forme të pronësisë private. Shën Gjon Pali II e ka kujtuar me shumë pasion këtë doktrinë, duke thënë se «Hyji ia ka dhënë tokën krejt gjinisë njerëzore, që ajo t’i mbajë të gjithë anëtarët e vet, *pa përjashtuar e pa privilegjuar askënd*».^[72] Janë fjalë plot me domethënie dhe të forta. Ka theksuar se «nuk do të ishte me të vërtetë i denjë për njeriun një lloj zhvillimi që nuk do t’i respektonte dhe nuk do t’i nxiste të drejtat njerëzore, personale e shoqërore, ekonomike e politike, përfshirë edhe të drejtat e Kombeve dhe të popujve».

[73] Me qartësi të madhe ka shpjeguar se «Kisha sigurisht që e mbron të drejtën e ligjshme për pronë private, por jo më me pak qartësi mëson edhe se mbi çdo pronë private rëndon gjithmonë një hipotekë shoqërore, në mënyrë që të mirat t'i shërbejnë destinacionit të përgjithshëm që Hyji u ka dhënë atyre».[74] Prandaj pohon se «nuk është sipas planit të Hyjit të administrohet kjo dhuratë në mënyrë të tillë që të mirat e saj të jenë në dobi vetëm të disa pak vetëve».[75] Kjo i vë seriozisht në diskutim praktikat e padrejta të një pjese të njerëzimit.[76]

94. I pasuri dhe i varfri kanë dinjitet të barabartë, sepse «të dy i ka krijuar Zoti» (*Fu* 22,2), «të voglin e të madhin ai i krijoi» (*Urt* 6,7), dhe «Ai bën të lindë dielli i tij mbi të këqijtë e mbi të mirët» (*Mt* 5,45). Kjo ka rrjedhoja praktike, si ato të radhitura nga Ileshkvinjtë e Paragujt: «Çdo fshatar ka të drejtë natyrore të zotërojë një copë të arsyeshme toke, ku të mund të vendosë shtëpinë e vet,

të punojë për të mbajtur familjen e vet dhe të ketë sigurinë për ekzistencën e vet. Kjo e drejtë duhet të jetë e garantuar në mënyrë që ushtrimi i saj të mos jetë i rremë por real. Gjë që do të thotë se, përveç titullit të pronësisë, fshatari duhet të ketë të mundura edhe mjetet e formimit teknik, borxhet, sigurimet dhe hyrjen në treg».^[77]

95. Mjedisi është një e mirë kolektive, pasuri e të gjithë njerëzimit dhe përgjegjësi e të gjithëve. Kush zotëron një pjesë të tij e ka vetëm për ta administruar në dobi të të gjithëve. Nëse nuk e bëjmë këtë, marrim mbi ndërgjegje peshën e mohimit të ekzistencës së të tjerëve. Prandaj Ipeshkvinjtë e Zelandës së Re kanë pyetur se çfarë do të thotë urdhërimi “mos vra” kur «njëzet përqind e popullsisë botërore konsumon burime në masë të tillë sa t’u vjedhë kombeve të varfra dhe brezave të ardhshëm atë për të cilën kanë nevojë që të mbijetojnë».^[78]

VII. VËSHTRIMI I JEZUSIT

96. Jezusi e bën të vetën fenë biblike në Hyjin krijues dhe nxjerr në pah një të dhënë themelore: Hyji është Atë (krh. *Mt 11,25*). Në dialogët me nxënësit e vet, Jezusi i ftonte ta njihnin marrëdhënien atërore që Hyji ka me të gjitha krijesat, dhe u kujtonte atyre me një ëmbëlsi prekëse se si secila prej tyre është e rëndësishme para syve të tij: «Po, a nuk shiten pesë trumcakë për dy qindarë? E pra, asnjërin prej tyre nuk e qet në harresë Hyji» (*Lk 12,6*). «Shikoni shpendët e qiellit! As nuk mbjellin, as nuk korrin, as nuk mbledhin në drithnikë, e Ati juaj qiellor i ushqen» (*Mt 6,26*).

97. Zotëria mund t'i ftonte të tjerët të ishin të vëmendshëm ndaj bukurisë që gjendet në botë, sepse Ai vetë ishte në kontakt të vazhdueshëm me natyrën dhe i kushtonte një vëmendje plot dashuri e mahnitje. Kur përshkonte çdo kënd të tokës së vet, ndalej për të soditur

bukurinë e mbjellur prej Atit të tij, dhe i ftonte nxënësit të shihnin në gjërat një mesazh hyjnor: «Çoni sytë tuaj dhe shikoni: arat u zbardhuan për korrje!» (Gjn 4,35). «Mbretëria e qiellit është e ngjashme me kokrrën e sinapit, të cilën njeriu e mori dhe e mbolli në arën e vet. Ajo është, pa dyshim, më e vogla ndër të gjitha farërat, por, kur rritet, bëhet më e madhe se të gjitha barishtet, zhvillohet në pemë» (Mt 13,31-32).

98. Jezusi jetonte një harmoni të plotë me krijimin, dhe të tjerët çuditëshin për këtë: «Kush është ky që po i nënshtrohen erërat dhe deti?» (Mt 8,27). Nuk dukej si një asket i ndarë prej botës apo armik i gjërave të këndshme të jetës. Duke iu referuar vetvetes pohonte: «Erdhi Biri i njeriut: ai ha e pi, e thonë: “Ja grykësi e pijaneci!”» (Mt 11,19). Ishte larg prej filozofive që përbuznin trupin, lëndën dhe realitetet e kësaj bote. Megjithatë, këta dualizma të dëmshëm kanë pasur një ndikim të ndjeshëm në disa

mendimtarë të krishterë gjatë historisë dhe e kanë deformuar Ungjillin. Jezusi punonte me duart e veta, duke pasur kontakt të përditshëm me lëndën e krijuar prej Hyjit për t'i dhënë formë me aftësinë e vet prej zejtari. Meriton të vihet në dukje fakti se pjesa më e madhe e jetës së tij i është kushtuar këtij angazhimi, në një ekzistencë të thjeshtë që nuk ngjallte asnjë admirim: «Po a nuk është ky zdrukthëtar, i biri i Marisë?» (Mk 6,3). Kështu e ka shenjtëruar punën dhe i ka dhënë asaj një vlerë të posaçme për pjekurimin tonë. Shën Gjon Pali II mësonte se «duke duruar mundimin e punës në bashkim me Krishtin e kryqëzuar për ne, njeriu bashkëpunon në ndonjë mënyrë me Birin e Hyjit në shëlbimin e njerëzimit».^[79]

99. Sipas kuptimit të krishterë të realitetit, fati i krejt krijimit kalon nëpërmjet misterit të Krishtit, që është i pranishëm që prej fillimit: «Gjithçka u krijua nëpër Të dhe për Të» (Kol 1,16).

[80] Prologu i Ungjillit të Gjonit (1,1-18) tregon veprimtarinë krijuese të Krishtit si Fjalë hyjnore (*Logos*). Por ky prolog na çudit për pohimin e vet se kjo Fjalë «u bë njeri» (*Gjn 1,14*). Një Vetë e Trinisë ka hyrë në kozmosin e krijuar, duke bashkëndarë fatin e tij deri në kryq. Që prej fillimit të botës, por në mënyrë të veçantë duke nisur prej mishërimit, misteri i Krishtit vepron në mënyrë të fshehur në tërësinë e realitetit natyror, por pa e cenuar autonominë e tij.

100. Besëlidhja e Re jo vetëm na flet për Jezusin tokësor dhe për marrëdhënien e tij aq konkrete dhe të dashur me botën. Por, e tregon këtë edhe i ringjallur dhe i lavdishëm, i pranishëm në të gjithë botën e krijuar me zotërimin e tij universal: «Sepse Hyjit i pëlqeu të banojë në Të e tërë Plotësia dhe, me anë të Tij, - duke vendosur paqen me anë të gjakut të kryqit [të Tij] - të pajtojë me vete gjithçka qoftë në tokë qoftë në qiell» (*Kol 1,19-20*). Kjo na projekton në fund të kohëve,

kur Biri do t'ia dorëzojë Atit të gjitha gjërat, kështu që «Hyji të jetë gjithçka në të gjithë» (1 Kor 15,28). Në këtë mënyrë, krijesat e kësaj bote nuk paraqiten më si një realitet thjesht natyror, sepse i Ringjalluri i mbështjell në mënyrë të mistershme dhe i orienton drejt një fati plotësie. Edhe lulet e fushës dhe zogjtë që Ai i soditi me admirim me sytë e vet njerëzorë, tani janë plot me praninë e tij të ndritshme.

KAPITULLI I TRETË

RRËNJA NJERËZORE E KRIZËS EKOLOGJIKE

101. Nuk do të na shërbejë për asgjë t'i përshkruajmë simptomat, nëse nuk pranojmë se kriza ekologjike ka rrënjë njerëzore. Ekziston një mënyrë e të kuptuarit të jetës dhe të veprimit njerëzor që është e devijuar dhe që i kundërshton realitetit deri në atë pikë sa ta shkatërrojë atë. Pse nuk mund të ndalemi për të reflektuar mbi këtë? Prandaj propozoj të përqendrohemi në paradigmen teknokratike mbizotëruese dhe në vendin që zënë qenia njerëzore e veprimi i tij në botë.

I. TEKNOLOGJIA: KRIJIMTARI DHE PUSHTET

102. Njerëzimi ka hyrë në një erë të re në të cilën pushteti i teknologjisë na vë përballë një udhëkryqi. Jemi

trashëgimtarët e dy shekujsh me valë të pamasa ndryshimi: makina me avull, hekurulla, telegrafi, elektriciteti, automobili, aeroplani, industritë kimike, mjekësia moderne, informatika dhe, më vonë, revolucioni dixhital, robotika, bioteknologjitë dhe nanoteknologjitë. Është e drejtë të gëzohemi për këto përparime dhe të entuziazmohemi përballë mundësive të mëdha që na japin këto risi të vazhdueshme, sepse «shkenca dhe teknologjia janë një prodhim i mrekullueshëm i krijimtarisë njerëzore që është dhuratë e Hyjit».

[81] Shndërrimi i natyrës për qëllime përfitimi është një karakteristikë e gjinisë njerëzore që prej fillimeve të veta, dhe në këtë mënyrë teknika «shpreh prirjen e shpirtit njerëzor drejt kapërcimit gradual të disa kushtëzimeve materiale».[82] Teknologjia u ka gjetur zgjidhje të këqijave të panumërta që e mundonin dhe e kufizonin qenien njerëzore. Nuk mund të mos i çmojmë dhe të falënderojmë për përparimet

e arritura, sidomos në mjekësi, në inxhenieri dhe në komunikime. E si të mos i njohim të gjitha përpjekjet e shumë shkencëtarëve dhe teknikëve që kanë përpunuar alternative për një zhvillim të pranueshëm?

103. Teknoshkenca, e orientuar mirë, është në gjendjejo vetëm të prodhojë gjëra realisht të çmueshme për ta përmirësuar cilësinë e jetës së qenies njerëzore, duke nisur nga objektet e përdorimit shtëpiak deri te mjetet e mëdha të transportit, te urat, te ndërtesat, te hapësirat publike. Është e aftë edhe të prodhojë të bukurën dhe të ta bëjë qenien njerëzore, të zhytur në botën materiale, të bëjë një hap përpara në fushën e bukurisë. A mund të mohohet bukuria e një aeroplani, apo e disa grataçelave? Ka vepra të çmueshme pikturë dhe muzike që janë arritur nëpërmjet përdorimit të mjeteve të reja teknike. Në këtë mënyrë, në dëshirën e autorit për bukurinë dhe në atë që e sodit atë bukuri kryhet hapi përpara drejt

njëfarë plotësie përkatësisht njerëzore.

104. Megjithatë, nuk mund ta shpërfillim faktin se energjia bërthamore, bioteknologjia, informatika, njohja e vetë ADN-së sonë dhe potencialitete të tjera që kemi fituar na japin një pushtet të tmerrshëm. Madje, atyre që kanë njohjen dhe sidomos pushtetin ekonomik për ta shfrytëzuar, u japin një sundim impresionues mbi tërësinë e qenies njerëzore dhe mbi krejt botën. Kurrë njerëzimi nuk ka pasur kaq pushtet mbi vetveten dhe asgjë nuk garanton se do ta përdorë këtë mirë, sidomos nëse konsiderohet mënyra me të cilën është duke e përdorur. Mjafton të kujtojmë bombat atomike të hedhura në mes të shekullit XX, sikurse edhe paraqitja e teknologjisë e bërë nga nazizmi, nga konsumizmi dhe nga regjime të tjera totalitare në shërbim të shfarosjes së miliona personave, pa harruar se sot lufta ka mjete gjithnjë e më vrastare. Në çfarë duarsh gjendet dhe në çfarë duarsh

mund të arrijë kaq shumë pushtet? Është tmerrësisht e rrezikshme që ai të gjendet në duart e një pjese të vogël të njerëzimit.

105. Ekziston prirja për të besuar se «çdo arritje fuqie është thjesht përparim, rritje e sigurisë, e dobisë, e mirëqenies, e forcës jetësore, e plotësisë së vlerave»,^[83] a thua se realiteti, e mira dhe e vërteta lulëzojnë vetvetiu prej vetë pushtetit të teknologjisë dhe të ekonomisë. Fakti është se «njeriu modern nuk është edukuar me përdorimin e drejtë të fuqisë»,^[84] sepse rritja e pamasë teknologjike nuk është shoqëruar nga një zhvillim i qenies njerëzore për sa i përket përgjegjësisë, vlerave dhe ndërgjegjes. Çdo epokë priret të zhvillojë një vetëdije të mangët për kufizimet e veta. Për këtë arsye është e mundur që sot njerëzimi të mos e ndiejë seriozitetin e sfidave që i paraqiten, dhe «mundësia e njeriut për ta përdorur të keqen e fuqisë së vet është në shtim të vazhdueshëm» kur «nuk ekzistojnë norma lirie, por vetëm

nevoja të pretenduara për përfitim dhe siguri».^[85] Qenia njerëzore nuk është plotësisht autonome. Liria e tij sëmuret kur u dorëzohet forcave të verbëra të pavetëdijes, të nevojave të menjëhershme, të egoizmit, të dhunës brutale. Në këtë kuptim, është lakuriq dhe i rrezikuar prej vetë pushtetit të vet që vazhdon të rritet, pa pasur mjetet për ta kontrolluar atë. Mund të ketë mekanizma sipërfaqësore, por mund të pohojmë se i mungon një etikë e qëndrueshme aq sa duhet, një kulturë dhe një përshpirtëri që realisht t'i japin një kufi dhe ta mbajnë brenda një zotërimi të kthjellët të vetvetes.

II. GLOBALIZIMI I PARADIGMËS TEKNOKRATIKE

106. Problemi themelor është një tjetër, edhe më i thellë: mënyra me të cilën faktikisht njerëzimi e ka marrë teknologjinë dhe zhvillimin e saj *së bashku me një paradigmë homogjene dhe*

njëdimensionale. Në këtë paradigmë del në pah një konceptim i subjektit që progresivisht, në procesin logjikoracional, përfshin dhe në këtë mënyrë e zotëron objektin që gjendet përjashta. Ky subjekt përcakton metodën shkencore me eksperimentimin e vet, që është qartazi një teknikë zotërimi, sundimi dhe shndërrimi. A thua se subjekti gjendet përballë realitetit të paformë krejtësisht të disponueshëm për manipulimin e tij. Ndërhyrja e qenies njerëzore mbi natyrën ka ndodhur gjithmonë, por për shumë kohë ka pasur karakteristikën e shoqërimit, të mbështetjes së mundësive të dhëna prej vetë gjërave. Bëhej fjalë për të marrë atë që realiteti natyror në vetvete lejon, si të ishte duke shtrirë dorën. Anasjelltas, tani ajo që intereson është të nxirret gjithçka është e mundur prej gjërave nëpërmjet shtrirjes së dorës njerëzore, që priret ta shpërfillë apo ta harrojë vetë realitetin e asaj që ka përpara. Prandaj qenia njerëzore dhe gjërat kanë reshtur së dhëni dorën

njëra-tjetrës miqësisht, duke u bërë kundërshtarë. Prej këtu kalohet lehtë në idenë e një rritjeje të pafundme apo të pakufishme, që i ka entuziazmuar aq shumë ekonomistët, teoricienët e financës dhe të teknologjisë. Kjo supozon gënjeshtrenë në lidhje me disponibilitetin e pafund të të mirave të planetit, që na bën ta "shtryllim" deri në skaj dhe përtej skajit. Bëhet fjalë për hipotezën e rremë se «ekziston një sasi e pakufizuar energjie dhe mjetesh të përdorshme, se rigjenerimi i tyre i menjëhershëm është i mundur dhe se efektet negative të manipulimeve të natyrës mund të kalohen lehtë».^[86]

107. Prandaj mund të pohojmë se në zanafillën e shumë vështirësive të botës aktuale gjendet para së gjithash prirja, jo gjithmonë e vetëdijshme, për t'i përcaktuar metodologjinë dhe objektivat e teknoshkencës sipas një paradigme kuptimi që kushtëzon jetën e personave dhe funksionimin e

shoqërisë. Efektet e aplikimit të këtij modeli në të gjithë realitetin, njerëzor dhe shoqëror, vërehen në degradimin e mjedisit, por kjo është vetëm një shenjë e reduksionizmit që godet jetën njerëzore dhe shoqërinë në të gjitha përmasat e tyre. Duhet të pranojmë se prodhimet e teknikës nuk janë neutrale, sepse krijojnë një rrjet që arrin të kushtëzojë stilet e jetës dhe i orientojnë mundësitë shoqërore në drejtimin e interesave të grupeve të caktuara të pushtetit. Disa zgjedhje që duken thjesht instrumentale, në të vërtetë janë zgjedhje që kanë lidhje me llojin e jetës shoqërore që synohet të zhvillohet.

108. Nuk mund të mendohet të mbështetet një tjetër paradigmë kulturore dhe të përdoret teknika thjesht si një mjet, sepse sot paradigma teknokratike është bërë aq mbizotëruese, sa është shumë e vështirë të lihen mënjanë burimet e saj, e, edhe më e vështirë është të përdoren burimet e saj pa qenë të

sunduar prej logjikës së saj. Është bërë kundër-kulturore të zgjidhet një stil jete me objektiva që të paktën pjesërisht mund të jenë të pavarur nga teknika, nga kostot e saj dhe nga pushteti i saj globalizues dhe masifikues. Faktikisht teknika ka një prirje për të bërë që asgjë të mos mbetet jashtë logjikës së saj të hekurt, dhe «njeriu që është protagonist i saj e di se, në fund të fundit, nuk bëhet fjalë as për përfitim, as për mirëqenie, por për sundim; sundim në kuptimin e skajshëm të fjalës».^[87] Prandaj «përpiqet të kapë elementet e natyrës dhe njëkohësisht ato të ekzistencës njerëzore».^[88] Kështu kufizohet aftësia për të vendosur, liria më e njëmendtë dhe hapësira për krijimtarinë alternative të individëve.

109. Paradigma teknokratike priret ta ushtrojë sundimin e vet edhe mbi ekonominë dhe mbi politikën. Ekonomia e merr çdo zhvillim teknologjik në funksion të përfitimit, pa u kushtuar

vëmendje pasojave të mundshme negative për qenien njerëzore. Financa ia merr frymën ekonomisë reale. Nuk është marrë mësimi i krizës financiare botërore dhe me shumë ngadalësi po merret mësimi i dëmtimit mjedisor. Në disa rrethe mbështetet ideja se ekonomia aktuale dhe teknologjia do t'i zgjidhin të gjitha problemet mjedisore, në të njëjtën mënyrë me të cilën pohohet, me një gjuhë jo akademike, se problemet e urisë dhe të mjerimit në botë do të zgjidhen thjesht me rritjen e tregut. Nuk është çështje teorish ekonomike, që ndoshta askush sot nuk guxon t'i mbrojë, por është çështje e vendosjes së tyre në zhvillimin faktik të ekonomisë. Ata që nuk e pohojnë me fjalë e mbështesin me fakte, kur nuk duket se shqetësohen për një nivel të drejtë të prodhimit, për një shpërndarje më të mirë të pasurisë, për një kujdes të përgjegjshëm ndaj mjedisit ose për të drejtat e brezave të ardhshëm. Me sjelljen e tyre pohojnë se objektivi i maksimizimit të përfitimeve

është i mjaftueshëm. Por tregu i vetëm nuk e garanton zhvillimin e tërësishëm njerëzor dhe përfshirjen shoqërore.^[89] Ndërkohë, kemi «njëfarë mbizhvillimi shkapërderdhës dhe konsumist që është në kundërshtim në një mënyrë të papranueshme me situata të vazhdueshme mjerimi çnjerëzues»,^[90] ndërsa nuk realizohen me shpejtësi të mjaftueshme institucione ekonomike dhe programe shoqërore që u lejojnë më të varfërve t'i përdorin në mënyrë të rregullt burimet bazë. Nuk kuptohet në mënyrë të mjaftueshme se cilat janë rrënjët më të thella të çekuilibrave aktualë, që kanë lidhje me orientimin, qëllimet, kuptimin dhe kontekstin shoqëror të rritjes teknologjike dhe ekonomike.

110. Specializimi përkatës i teknologjisë sjell një vështirësi të ndjeshme për të pasur një vështrim tërësie. Fragmentarizimi i dijes e kryen funksionin e vet në momentin e arritjes

së zbatimeve konkrete, por shpesh bën që të humbasë ndjenja e tërësisë, e marrëdhënieve që ekzistojnë mes gjërave, e horizontit të gjerë, kuptim që bëhet i parëndësishëm. Vetë ky fakt nuk lejon të gjenden rrugë të përshtatshme për të zgjidhur problemet më të ndërlikuara të botës aktuale, sidomos ato të mjedisit dhe të të varfërve, që nuk mund të përballohen duke nisur vetëm nga një këndvështrim apo nga një lloj i vetëm interesash. Një shkencë që pretendon t'u japë zgjidhje çështjeve të mëdha, duhet patjetër të mbajë parasysh gjithçka që njohja ka prodhuar në fushat e tjera të dijes, përfshirë edhe filozofinë dhe etikën sociale. Por kjo është një mënyrë të vepruari e vështirë për t'u kryer sot. Prandaj as nuk mund të njihen disa horizonte të vërteta etike referimi. Jeta bëhet një dorëzim para rrethanave të kushtëzuara prej teknikës, e kuptuar si burimi kryesor për ta interpretuar ekzistencën. Në realitetin konkret që na bën thirrje, shfaqen simptoma

të ndryshme që tregojnë gabimin, si degradimi mjedisor, ankthi, humbja e kuptimit të jetës dhe e të jetuarit së bashku. Kështu, edhe një herë tregohet se «realiteti qëndron më lart se ideja».^[91]

111. Kultura ekologjike nuk mund të kufizohet në një seri përgjigjesh urgjente dhe të pjesshme ndaj problemeve që paraqiten në lidhje me degradimin mjedisor, me shterimin e rezervave natyrore dhe me ndotjen. Duhet të ketë një vështrim të ndryshëm, një mendim, një politikë, një program edukativ, një stil jete dhe një përshpirtëri që i japin formë një rezistence përballë përparimit të paradigmës teknokratike. Përndryshe, edhe nismat më të mira ekologjiste mund të përfundojnë të robëruara në të njëjtën logjikë të globalizuar. Të kërkojmë vetëm një zgjidhje teknike për çdo problem mjedisor që paraqitet, do të thotë të izolojmë gjëra që në realitet janë të lidhura, dhe t'i fshehim problemet e vërteta dhe më të thella të sistemit

botëror.

112. Megjithatë, është e mundur ta zgjerojmë përsëri vështrimin, dhe liria njerëzore është e aftë ta kufizojë teknikën, ta orientojë dhe ta vëjë atë në shërbim të një lloji tjetër përparimi, më të shëndoshë, më njerëzor, më shoqëror dhe më të tërësishëm. Lirimi prej paradigmës teknokratike mbizotëruese ndodh faktikisht në disa raste. Për shembull, kur bashkësi prodhuesish të vegjël zgjedhin sisteme prodhimi më pak ndotëse, duke favorizuar një model jo konsumist jete, lumturie dhe bashkëjetese. Ose kur teknika orientohet kryesisht për të zgjidhur problemet konkrete të të tjerëve, me angazhimin për t'i ndihmuar që të jetojnë me më shumë dinjitet dhe me pak vuajtje. Dhe përsëri kur kërkimi krijues i së bukurës dhe soditja e saj arrijnë ta tejkalojnë pushtetin objektivues në njëfarë shpëtimi që realizohet në të bukurën dhe në personin që e sodit.

Njerëzimi i njëmendtë, që fton në një sintezë të re, duket se banon në mes të qytetërimit teknologjik, pothuajse në mënyrë të padukshme, sikurse mjegulla që depërton nën derën e mbyllur. A do të jetë një premtim i vazhdueshëm, pavarësisht nga gjithçka, që lind si një rezistencë këmbëngulëse ndaj asaj që është e njëmendtë?

113. Nga ana tjetër, njerëzit tashmë nuk duket se besojnë në një të ardhme të lumtur, nuk besojnë verbërisht në një të nesërme më të mirë duke nisur nga kushtet aktuale të botës dhe nga aftësitë teknike. Po ndërgjegjësohen për faktin se përparimi i shkencës dhe i teknikës nuk do të thotë përparim i njerëzimit dhe i historisë, dhe dallon se janë të tjera rrugët themelore për një të ardhme të lumtur. Pavarësisht nga kjo, as nuk e imagjinojnë të heqin dorë prej mundësive që jep teknologjia. Njerëzimi është modifikuar thellësisht dhe grumbullimi i risive të vazhdueshme ligjëson një

përkohshmëri që na zvarrit në sipërfaqe në një drejtim të vetëm. Bëhet e vështirë të ndalemi për të rifituar thellësinë e jetës. Nëse arkitektura pasqyron shpirtin e një epoke, megastrukturat dhe shtëpitë në seri shprehin shpirtin e teknikës së globalizuar, në të cilën risia e vazhdueshme e prodhimeve i bashkohet një mërzie të rëndë. Të mos dorëzohemi para kësaj dhe të mos heqim dorë nga pyetjet mbi qëllimet dhe mbi kuptimin e çdo gjëje. Përndryshe, do të ligjësojmë gjendjen faktike dhe do të kemi nevojë për më shumë kompensime që ta durojmë zbrazëtirën.

114. Ajo që po ndodh na vë përballë urgjencës për të kryer një revolucion të guximshëm kulturor. Shkenca dhe teknologjia nuk janë neutrale, por mund të përfshijnë që prej fillimit e deri në fund të një procesi qëllime dhe mundësi të ndryshme, dhe mund të paraqiten në mënyra të ndryshme. Askush nuk dëshiron të kthehet

në epokën e shpellave, por është e domosdoshme ta ngadalësojmë ecjen për ta shikuar realitetin në një mënyrë tjetër, të pranojmë zhvillimet pozitive e të pranueshme, dhe në të njëjtën kohë të rifitojmë vlerat dhe qëllimet e mëdha të shkatërruara nga një shfrenim megaloman.

III. KRIZA DHE PASOJAT E ANTROPOCENTRIZMIT MODERN

115. Antropocentrizmi modern, në mënyrë paradoksale, ka arritur ta vendosë arsyen teknike mbi realitetin, sepse kjo qenie njerëzore «nuk e ndien më natyrën as si normë të vlefshme, as si strehim të gjallë. E sheh pa hipoteza, objektivisht, si hapësirë dhe lëndë në të cilën të realizojë një vepër në të cilën të hidhet krejtësisht, dhe nuk ka rëndësi se çfarë do të dalë prej kësaj».^[92] Në këtë mënyrë, zvogëlon vlerën intime të botës. Por nëse qenia njerëzore nuk rizbulon vendin e vet të vërtetë, nuk e kupton në

mënyrën e duhur vetveten dhe arrin ta kundërshtojë realitetin e vet. «Jo vetëm që toka i është dhënë prej Hyjit njeriut, i cili duhet ta përdorë duke respektuar qëllimin zanafillor të mirë, sipas të cilit i është dhuruar, por edhe njeriu i është dhuruar vetvetes prej Hyjit dhe, prandaj, duhet ta respektojë strukturën natyrore e morale, me të cilën është pajisur».^[93]

116. Në kohën moderne është verifikuar një teprim i ndjeshëm antropocentrik që, nën një veshje tjetër, sot vazhdon të minojë çdo referim në diçka të përbashkët dhe çdo përpjekje për të forcuar lidhjet shoqërore. Prandaj ka ardhur momenti që t'i kushtohet përsëri vëmendje realitetit me kufizimet që ai imponon, të cilat, nga ana e tyre, përbëjnë mundësinë për një zhvillim njerëzor e shoqëror më të shëndetshëm e të frytshëm. Një paraqitje e papërshtatshme e antropologjisë së krishterë ka arritur të nxisë një konceptim të gabuar të marrëdhënies së qenies njerëzore me

botën. Shumë herë është përçarur një ëndërr prometeike sundimi mbi botën që ka dhënë përshtypjen se kujdesi për natyrën është diçka për të dobët. Ndërsa interpretimi i saktë i qenies njerëzore si zotëri i gjithësisë është ai që ta kuptojmë si administrator të përgjegjshëm.^[94]

117. Mungesa e shqetësimit për t'i matur dëmet ndaj natyrës dhe efekti mjedisor i vendimeve, është vetëm refleksi i dukshëm i një mosinteresimi për t'i njohur mesazhet që natyra mban në vetë strukturat e veta. Kur nuk shohim në vetë realitetin rëndësinë e një të varfri, të një embrioni njerëzor, të një personi me paaftësi – për të dhënë vetëm disa shembuj –, vështirë se do të dimë t'i dëgjojmë britmat e vetë natyrës. Gjithçka është e lidhur. Nëse qenia njerëzore e shpall veten autonome prej realitetit dhe e cakton veten si sunduese absolute, vetë baza e ekzistencës së saj copëtohet, sepse «Në vend që të kryejë rolin e vet si bashkëpunëtor i Hyjit në

veprën e krijimit, njeriut zë vendin e Hyjit dhe kështu arrin të shkaktojë kryengritjen e natyrës».^[95]

118. Kjo situatë na çon në një skizofreni të vazhdueshme, e cila shkon nga ekzaltimi teknokratik që nuk ua njeh qenieve të tjera një vlerë të vetën, deri në reagimin e mohimit të çdo vlere karakteristike të qenies njerëzore. Por nuk mund ta shpërfillim njerëzimin. Nuk do të ketë një marrëdhënie të re me natyrën pa një qenie njerëzore të re. Nuk ka ekologji pa një antropologji të përshtatshme. Kur personi njerëzor konsiderohet vetëm si një qenie më shumë mes të tjerave, që rrjedh nga një lojë e rastit apo nga një determinizëm fizik, «rrezikohet që në personat të dobësohet vetëdija e përgjegjësisë».^[96] Një antropocentrizëm i devijuar nuk duhet patjetër t'i hapë udhë një "biocentrizmi", sepse kjo do të kërkonte të hynte një çekuilibër i ri, që jo vetëm nuk do t'i zgjidhë problemet, por do

të shtojë edhe të tjera. Nuk mund të kërkohet nga ana e qenies njerëzore një angazhim ndaj botës, nëse nuk njihen e nuk vlerësohen në të njëjtën kohë aftësitë e tij karakteristike të njohjes, vullnetit, lirisë dhe përgjegjësisë.

119. Kritika ndaj antropocentrizmit të devijuar nuk duhet as të vendosë në plan të dytë vlerën e marrëdhënieve mes personave. Nëse kriza ekologjike është një dalje në pah apo një shfaqje përjashta e krizës etike, kulturore e shpirtërore të modernitetit, nuk mund ta gënjejmë veten se do ta shërojmë marrëdhënien tonë me natyrën dhe mjedisin pa shëruar të gjitha marrëdhëniet njerëzore themelore. Kur mendimi i krishterë pretendon për qenien njerëzore një vlerë karakteristike mbi krijesat e tjera, i jep hapësirë vlerësimit të çdo personi njerëzor, dhe kështu nxit njohjen e tjetrit. Hapja ndaj një "ti"-je në gjendje për të njohur, për të dashur e për të dialoguar vazhdon të jetë fisnikëria e madhe

e personit njerëzor. Prandaj, për një marrëdhënie të përshtatshme me botën e krijuar, nuk ka nevojë të zvogëlohet përmasa shoqërore e qenies njerëzore dhe as përmasa e tij transhendente, hapja e tij ndaj "Ti"-së hyjnore. Në të vërtetë, nuk mund të propozohet një marrëdhënie me mjedisin pavarësisht nga ajo me personat e tjerë dhe me Hyjin. Do të ishte një individualizëm romantik i maskuar nga bukuria ekologjike dhe një një mbyllje asfiksuese në konkretësinë.

120. Meqenëse gjithçka është në marrëdhënie, nuk mund të pajtohet as mbrojtja e natyrës me arsyetimin e abortit. Nuk duket e mundshme një ecje edukuese për pranimin e qenieve të dobëta që na rrethojnë, që nganjëherë janë të bezdisshëm apo të mërzitshëm, kur nuk i jepet mbrojtje një embrioni njerëzor megjithëse arritja e tij është shkak problemesh e vështirësish: «Nëse humbet ndjeshmëria personale e shoqërore ndaj pranimin të një jete të

re, edhe forma të tjera të pranimit të dobishme për jetën shoqërore shteren».⁹⁷

121. Pritet ende zhvillimi i një sinteze të re që t'i kapërcejë dialektikat e rreme të shekujve të fundit. Vetë krishterimi, duke i qëndruar besnik identitetit të vet dhe thesarit të së vërtetës që ka marrë prej Jezu Krishtit, gjithmonë rimendohet dhe rishprehet në dialogun me situatat e reja historike, duke lënë kështu të lulëzojë risia e vet e përhershme.^[98]

Relativizmi praktik

122. Një antropocentrizëm i devijuar i jep fill një stili jete të devijuar. Në Nxitjen apostolike *Evangelii gaudium* kam folur për relativizmin praktik që karakterizon epokën tonë, dhe që është «edhe më i rrezikshëm se ai doktrinor». ^[99] Kur qenia njerëzore e vë vetveten në qendër, arrin t'u japë parësi absolute interesave të veta të rastit, dhe gjithçka tjetër bëhet relative. Prandaj nuk duhet

të na çudisë fakti se, së bashku me gjithëpranishmërinë e paradigmës teknokratike dhe me adhurimin e pushtetit njerëzor pa kufij, po zhvillohet në subjektet ky relativizëm, në të cilin gjithçka bëhet e parëndësishme nëse nuk u shërben interesave personale të momentit. Në këtë ka një logjikë që lejon të kuptohet se si ushqejnë njëri-tjetrin qëndrime të ndryshme që shkaktojnë në të njëjtën kohë degradimin mjedisor dhe degradimin shoqëror.

123. Kultura e relativizmit është e njëjta patologji që e nxit një person të përfitojë nga një tjetër dhe ta trajtojë atë thjesht si objekt, duke e shtrënguar të bëjë punë të detyrueshme, ose duke e bërë skllav për shkak të një borxhi. Është e njëjta logjikë që bën të shfrytëzohen seksualisht fëmijët, ose të braktisen të moshuarit që nuk u shërbejnë interesave personale. Është edhe logjika e brendshme e atij që pohon: “le të lëmë që forcat e padukshme të tregut ta rregullojnë ekonominë, sepse

efektet e tyre mbi shoqërinë dhe mbi natyrën janë dëme të pashmangshme". Nëse nuk ka të vërteta objektive as parime të përcaktuara, përveç plotësimit të aspiratave personale dhe të nevojave të momentit, çfarë kufijsh mund të kenë trafiku i qenieve njerëzore, kriminaliteti i organizuar, narkotrafiku, tregtia e diamanteve të larë me gjak dhe e lëkurave të kafshëve në rrugë zhdukjeje? A nuk është e njëjta logjikë relativiste ajo që arsyeton blerjen e organeve të të varfërve me qëllim që të shiten apo të përdoren për eksperimentim, apo skartimi i fëmijëve sepse nuk i përgjigjen dëshirës së prindërve të tyre? Është e njëjta logjikë "përdor e hidh" që prodhon shumë mbeturina vetëm prej dëshirës së çrregullt për të konsumuar më shumë nga sa kemi realisht nevojë. E atëherë nuk mund të mendojmë se programet politike apo forca e ligjit do të mjaftojnë për të shmangur sjelljet që godasin mjedisin, sepse kur është kultura ajo që prishet dhe nuk njihet

më asnjë e vërtetë objektive apo parim universalisht i vlefshëm, ligjet do të kuptohen vetëm si imponime arbitrare dhe si pengesa që duhen shmangur.

Nevoja për të mbrojtur punën

124. Në çfarëdo planifikimi të ekologjisë integrale, që nuk e përjashton qenien njerëzore, është e domosdoshme të integrohet vlera e punës, e zhvilluar atëherë nga shën Gjon Pali II në Enciklikën e tij *Laborem exercens*. Le të kujtojmë se, sipas tregimit biblik të krijimit, Hyji e vuri qenien njerëzore në kopshtin e sapo krijuar (krh. *Zan 2,15*) jo vetëm për t'u kujdesur për atë që ekzistonte (për ta ruajtur), por edhe për ta punuar atë në mënyrë që të jepte fryte (për ta kultivuar). Kështu punëtorët dhe zejtarët «kujdesi i tyre qëndron në kryerjen e mjeshtresë» (*Sir 38,39*). Në të vërtetë, ndërhyrja njerëzore që favorizon zhvillimin e matur të botës së krijuar është mënyra më e përshtatshme

për t'u kujdesur për të, sepse do të thotë që njeriu të vendoset si mjet i Hyjit për të ndihmuar që të dalin në pah potencialitetet që Ai vetë ka vënë në gjërat: «I Tejetlarti nga toka i krijoi ilaçet e njeriu i mençur nuk i ka inat» (*Sir* 38,4).

125. Nëse përpiqemi të mendojmë se cilat janë marrëdhëniet e përshtatshme të qenies njerëzore me botën që e rrethon, del në pah nevoja për një konceptim të drejtë të punës, sepse, nëse flasim për marrëdhënien e qenies njerëzore me gjërat, shtrohet pyetja rreth kuptimit dhe qëllimit të veprimit njerëzor mbi realitetin. Nuk po flasim vetëm për punën e dorës apo për kultivimin e tokës, por për çfarëdo veprimtarie që kërkon ndonjë shndërrim të ekzistencës, nga përpunimi i një studimi shoqëror deri te projekti i një zhvillimi teknologjik. Çfarëdo forme pune presupozon një ide mbi marrëdhënien që qenia njerëzore mund ose duhet të përcaktojë me një tjetër nga vetja. Përshpirtëria e krishterë,

së bashku me mahnitjen soditëse për krijesat që gjejmë në shën Françeskun e Asizit, ka zhvilluar edhe një kuptim të pasur e të shëndoshë të punës, siç mund ta shohim, për shembull, në jetën e të lumit Sharl de Fuko dhe të nxënësve të tij.

126. Po marrim edhe diçka nga tradita e gjatë monastike. Në fillim ajo favorizoi në njëfarë mënyre ikjen nga bota, duke u përpjekur të largohej nga dekadencia urbane. Prandaj murgjërit kërkonin shkretëtirën, të bindur se ajo ishte vendi më i përshtatshëm për të njohur praninë e Hyjit. Më pas, shën Benedikti nga Norça deshi që murgjërit e tij të jetonin në bashkësi, duke bashkuar lutjen dhe studimin me punën e dorës (*Ora et labora*). Kjo përfshirje e punës së dorës e mbushur me ndjenjë shpirtërore u shfaq revolucionare. Mësuan ta kërkonin pjekurimin dhe shenjtërimin në gërshetimin mes përqendrimit dhe punës. Kjo mënyrë e të jetuarit të punës

na bën më të aftë të kujdesemi dhe të kemi respekt ndaj mjedisit, e mbush me përkorë të shëndoshë marrëdhënien tonë me botën.

127. Pohojmë se «njeriu është autori, qendra dhe qëllimi i gjithë jetës ekonomiko-shoqërore». ^[100] Pavarësisht nga kjo, kur në qenien njerëzore humbet aftësia për të soditur dhe për të respektuar, krijohen kushtet që kuptimi i punës të shtrembërohet.^[101] Është mirë të kujtojmë gjithmonë se qenia njerëzore është në të njëjtën kohë «e aftë të bëhet vetë aktore e përgjegjshme e përmirësimit të vet material, e përparimit të vet moral, e zhvillimit të plotë të fatit të vet shpirtëror». ^[102] Puna duhet të jetë mjedisi i këtij zhvillimi shumëformësh personal, ku hyjnë në lojë shumë përmasa të jetës: krijimtaria, projektimi në të ardhmen, zhvillimi i aftësive, ushtrimi i vlerave, komunikimi me të tjerët, një qëndrim adhurimi. Prandaj realiteti shoqëror i botës së sotme, përtej

interesave të kufizuara të ndërmarrjeve dhe të një racionaliteti të diskutueshëm ekonomik, kërkon që «të vazhdohet të ndiqet si *parësi objektivi i mundësisë për të punuar* [...] për të gjithë».^[103]

128. Jemi të thirrur në punë që prej krijimit tonë. Nuk duhet të përpiqemi ta zëvendësojmë gjithnjë e më shumë punën njerëzore me përparimin teknologjik: duke bërë kështu njerëzimi do të dëmtonte vetveten. Puna është një nevojë, është pjesë e kuptimit të jetës mbi këtë tokë, rrugë e pjekurimit, e zhvillimit njerëzor dhe e realizimit personal. Në këtë kuptim, ndihma e të varfërve me para duhet të jetë gjithmonë një zgjidhje e përkohshme për të përballuar disa emergjenca. Objektivi i vërtetë duhet të jetë gjithmonë ai që t' u lejohet atyre një jetë e denjë nëpërmjet punës. Megjithatë, orientimi i ekonomisë ka favorizuar një lloj përparimi teknologjik që ka qëllimin të pakësojë kostot e prodhimit duke pakësuar vendet e punës, që

zëvendësohen prej makinave. Është një mënyrë e mëtëjshme në të cilën veprimi i qenies njerëzore mund të drejtohet kundër vetvetes. Pakësimi i vendeve të punës «ka edhe një ndikim negativ në planin ekonomik, nëpërmjet erozionit progresiv të “kapitalit shoqëror”, pra të asaj tërësie marrëdhëniesh besimi, besueshmërie, respektimi të rregullave, të domosdoshme për çdo bashkëjetesë civile».^[104] Si përfundim «*kostot njerëzore janë gjithmonë edhe kosto ekonomike dhe anomalitë ekonomike sjellin gjithmonë edhe kosto njerëzore*».^[105] Heqja dorë nga investimi në personat për të arritur një përfitim më të madh të menjëhershëm është një gjë shumë e keqe për shoqërinë.

129. Që të vazhdojë të jetë e mundur të jepet punësim, është e domosdoshme të nxitet një ekonomi që favorizon larmizimin prodhues dhe krijimtarinë sipërmarrëse. Për shembull, ka një larmi të madhe sistemesh ushqimore bujqësore dhe të shkallës së vogël që vazhdon të ushqejë pjesën më të madhe

të popullsisë botërore, duke përdorur një pjesë të reduktuar të territorit e të ujit dhe duke prodhuar më pak mbeturina, qoftë në terrene të vogla bujqësore e kopshte, qoftë në gjueti dhe në mbledhjen e prodhimeve pyjore, qoftë në peshkimin artizanal. Ekonomitë e shkallës, sidomos në sektorin bujqësor, arrijnë deri aty sa t'i detyrojnë bujqit e vegjël për t'i shitur tokat e tyre dhe për t'i braktisur kultivimet e tyre tradicionale. Përprjekjet e disave prej tyre që të zhvillojnë forma të tjera prodhimi, më të larmizuara, del se janë të kota për shkak të vështirësisë për të hyrë në tregjet rajonale e globale apo sepse infrastruktura e shitjes dhe e transportit është në shërbim të ndërmarrjeve të mëdha. Autoritetet kanë të drejtën dhe përgjegjësinë për të marrë masa mbështetjeje të qarta e të vendosura ndaj prodhuesve të vegjël dhe ndaj larmizimit të prodhimit. Që të ketë një liri ekonomike prej së cilës të kenë efektivisht dobi të gjithë, nganjëherë mund të jetë e nevojshme t'u vihen

kufizime atyre që kanë në dorë burimet më të mëdha dhe pushtetin financiar. Thjesht shpallja e lirisë ekonomike, kur megjithatë kushtet reale nuk lejojnë që shumë njerëz të mund ta kenë atë realisht, dhe kur kufizohet mundësia për punë, bëhet një fjalim kontradiktor që e çnderon politikën. Veprimtaria sipërmarrëse, që është një thirrje fisnike e orientuar për të prodhuar pasuri dhe për ta përmirësuar botën për të gjithë, mund të jetë një mënyrë shumë e frytshme për ta nxitur rajonin në të cilin i vendos veprimtaritë e veta, sidomos nëse kupton se krijimi i vendeve të punës është pjesë e domosdoshme e shërbimit të vet ndaj së mirës së përbashkët.

Reforma biologjike duke nisur nga kërkimi

130. Në vizionin filozofik e teologjik të qenies njerëzore dhe të krijimit, që jam përpjekur të paraqes, del qartë se personi njerëzor, me karakteristikën e arsyes së vet dhe të dijes së vet, nuk

është një faktor i jashtëm që duhet të përjashtohet tërësisht. Megjithatë, edhe pse qenia njerëzore mund të ndërhyjë në botën vegjetale e shtazore dhe ta përdorë atë kur është e nevojshme për jetën e vet, *Katekizmi* mëson se eksperimentimet mbi kafshët janë të ligjshme vetëm nëse «ruhen kufijtë e arsyeshem dhe ndihmojnë për të kurrar apo për të shpëtuar jetë njerëzore».^[106] Kujton me vendosmëri se pushteti njerëzor ka disa kufij dhe se «është kundër dinjitetit njerëzor t'i bëjmë kafshët të vuajnë kot dhe ta përdorim pa dallim jetën e tyre».^[107] Çfarëdo përdorimi dhe eksperimentimi «kërkon një respekt të madh ndaj integritetit të krijimit».^[108]

131. Dëshiroj të përmend këtu pozicionin e ekuilibruar të shën Gjon Palit II, i cili vinte në dukje dobitë e përparimeve shkencore dhe teknologjike, që «tregojnë se sa fisnike është thirrja e njeriut për të marrë pjesë në mënyrë të përgjegjshme në veprimin

krijues të Hyjit», por që në të njëjtën kohë kujtonte «se çdo ndërhyrje në një zonë të ekosistemit nuk mund të mos i konsiderojë rrjedhojat e veta në zonat e tjera».^[109] Pohonte se Kisha e çmon ndihmesën «e studimit dhe të aplikimeve të biologjisë molekulare, të plotësuar nga disiplina të tjera si gjenetika dhe aplikimi i saj teknologjik në bujqësi dhe në industri».^[110] Megjithëse thoshte edhe se kjo nuk duhet t'i japë jetë një «manipulimi gjenetik pa dallim»^[111] që i shpërfill efektet negative të këtyre ndërhyrjeve. Nuk është e mundur të frenohet krijimtaria njerëzore. Nëse nuk mund t'i ndalohet një artisti që ta shprehë aftësinë e vet krijuese, nuk mund të ndalen as ata që kanë dhanti të veçanta për zhvillimin shkencor e teknologjik, aftësitë e të cilëve janë dhuruar prej Hyjit për shërbimin e të tjerëve. Në të njëjtën kohë, nuk mund të mos rikonsiderohen objektivat, efektet, konteksti dhe kufizimet etike të kësaj veprimtarie njerëzore që është një formë

pushteti me rreziqe të mëdha.

132. Në këtë kuadër duhet të vendoset çfarëdo reflektimi në lidhje me ndërhyrjen njerëzore në botën vegjetale e shtazore, që përfshin sot ndryshime gjenetike të prodhuara nga bioteknologjia, me qëllim që të shfrytëzohen mundësitë e pranishme në realitetin material. Respekti i fesë ndaj arsyes kërkon që t'i kushtohet vëmendje asaj që vetë shkenca biologjike, e zhvilluar në mënyrë të pavarur nga interesat ekonomike, mund të mësojë në lidhje me strukturat biologjike dhe me mundësitë e ndryshimet e tyre. Sidoqoftë, është e ligjshme ndërhyrja që vepron mbi natyrën «për ta ndihmuar që të zhvillohet sipas thelbit të saj, atij të krijimit, atij të dëshiruar prej Hyjit». ^[112]

133. Është e vështirë të jepet një gjykim i përgjithshëm në lidhje me zhvillimin e organizmave gjenetikisht të modifikuar (OGJM), vegjetalë apo

shtazorë, për qëllime mjekësore apo bujqësore, meqenëse mund të jenë shumë të ndryshëm mes tyre dhe të kërkojnë konsiderime të ndara. Nga ana tjetër, rreziqet nuk duhet t'i lihen gjithmonë vetë teknikës, por zbatimit të saj të papërshtatshëm apo të tepërt. Në të vërtetë, modifikimet gjenetike janë prodhuar dhe prodhohen shumë herë prej vetë natyrës. As ato të shkaktuara nga qenia njerëzore nuk janë një dukuri moderne. Zbutja e kafshëve, kryqëzimi i specieve dhe praktika të tjera të hershme e universalisht të pranuar mund të hyjnë në këto konsiderime. Është mirë të kujtojmë se fillimi i zhvillimeve shkencore mbi drithërat transgjenike ka qenë vërejtja e baktereve që në mënyrë të natyrshme e të vetvetishme prodhonin një modifikim të gjenomës së një vegjetali. Megjithatë, në natyrë këto procese kanë një ritëm të ngadaltë, që nuk mund të krahasohet me shpejtësinë e imponuar nga përparimet teknologjike aktuale, edhe kur këto përparime

mbështeten në një zhvillim shkencor shekullor.

134. Megjithëse nuk kemi prova përfundimtare në lidhje me dëmin që mund t'u shkaktojnë drithërat transgjenike qenieve njerëzore, dhe në disa rajone përdorimi i tyre ka prodhuar një rritje ekonomike që ka ndihmuar të zgjidhen disa probleme, ndeshen vështirësi të mëdha që nuk duhet të minimizohen. Në shumë zona, pas hyrjes së këtyre kultivimeve, vërehet një përqendrim i tokave prodhuese në duart e pak vetëve, gjë që i detyrohet «zhdukjes progresive të prodhuesve të vegjël, që, si rrjedhojë e humbjes së tokave të kultivuara, kanë qenë të detyruar të largohen prej prodhimit të drejtpërdrejtë».^[113] Më të dobëtit ndër këta bëhen punëtorë të përkohshëm dhe shumë punëtorë bujqësorë përfundojnë të migrojnë në ngulime të mjerushme urbane. Shtrirja e këtyre kultivimeve shkatërron rrjetin kompleks të

ekosistemeve, pakëson larminë në prodhim dhe godet të tashmen apo të ardhmen e ekonomive rajonale. Në Vende të ndryshme ndeshet një prirje për zhvillim të oligopoleve në prodhimin e farërave dhe të prodhimeve të tjera të nevojshme për kultivimin, dhe varësia rëndohet nëse marrim parasysh prodhimin e farërave sterile, që do të arrinte t'i detyronte fshatarët t'i blejnë ato prej ndërmarrjeve prodhuese.

135. Pa dyshim ka nevojë për një vëmendje të vazhdueshme, e cila bën të konsiderohen të gjitha aspektet etike të implikuara. Për këtë qëllim duhet të sigurohet një debat shkencor e shoqëror që të jetë i përgjegjshëm dhe i gjerë, në gjendje të konsiderojë gjithë informacionin e disponueshëm dhe t'i thërrasë gjërat me emrin e tyre. Nganjëherë nuk vendoset në tryezë informacioni i plotë, por ai përzgjidhet sipas interesave përkatëse, qofshin ato politike, ekonomike apo ideologjike. Kjo

e bën të vështirë përpunimin e një gjykimi të ekuilibruar dhe të matur mbi çështjet e ndryshme, duke mbajtur parasysh të gjitha të ndryshueshmet që janë në lojë. Është e nevojshme të ketë vende debati në të cilat të gjithë ata që në ndonjë mënyrë mund të jenë drejtpërdrejt apo tërthorazi të përfshirë (bujqër, konsumatorë, autoritete, shkencëtarë, prodhues të farërave, popullsi afër fushave të trajtuara dhe të tjerë) të mund të paraqesin problematikat e tyre apo të kenë një informacion të gjerë dhe të besueshëm për të marrë vendime të orientuara nga e mira e përbashkët e tashme dhe e ardhshme. Ajo e OGJM-së është një çështje me karakter kompleks, që ka nevojë të përballohet me një vështrim që përfshin të gjitha aspektet e veta, dhe kjo do të kërkonte të paktën një përpjekje më të madhe për të financuar linja të ndryshme të kërkimit autonom dhe ndërdisiplinor që mund të sjellin një dritë të re.

136. Nga ana tjetër, është shqetësues fakti se disa lëvizje ekologjiste mbrojnë integritetin e mjedisit, dhe me të drejtë kërkojnë disa kufij për kërkimin shkencor, ndërsa nganjëherë nuk i zbatojnë po këto parime për jetën njerëzore. Shpesh justifikohet fakti se tejkalohen të gjithë kufijtë kur bëhen eksperimente me embrione njerëzore të gjalla. Harrohet se vlera e pacenueshme e një qenieje njerëzore shkon shumë përtej shkallës së zhvillimit të tij. Po ashtu, kur teknika nuk i njeh parimet e mëdha etike, arrin ta konsiderojë të ligjshme çfarëdo praktike. Siç kemi parë në këtë kapitull, teknika e ndarë prej etikës vështirë se do të jetë e aftë ta vetëkufizojë pushtetin e vet.

KAPITULLI I KATËRT

NJË EKOLOGJI INTEGRALE

137. Meqenëse gjithçka është e lidhur ngushtë dhe se problemet aktuale kërkojnë një vështrim që mban parasysh të gjitha aspektet e krizës botërore, propozoj të ndalemi tani për të reflektuar mbi elementet e ndryshme të një *ekologjie integrale*, që i kupton qartazi përmasat njerëzore dhe shoqërore.

I. EKOLOGJIA MJEDISORE, EKONOMIKE DHE SHOQËRORE

138. Ekologjia studion marrëdhëniet mes organizmave të gjallë dhe mjedisit në të cilin zhvillohen. Ajo kërkon edhe të ndalet për të menduar e diskutuar mbi kushtet e jetës dhe të mbijetesës së një shoqërie, me ndershmërinë që të vihen në dyshim modele zhvillimi, prodhimi e konsumi. Nuk është e kotë të këmbëngulet më tej mbi faktin

se gjithçka është e lidhur. Koha dhe hapësira nuk janë mes tyre të pavarura, e as atomet apo pjesëzat subatomike nuk mund të konsiderohen ndarazi. Ashtu sikurse përbërësit e ndryshëm të planetit – fizikë, kimikë e biologjikë – janë në marrëdhënie mes tyre, po ashtu edhe speciet e gjalla formojnë një rrjet që nuk reshtim kurrë së njohuri dhe kuptuari. Një pjesë e mirë e informacionit tonë gjenetik është e bashkëndarë me shumë qenie të gjalla. Për këtë arsye, njohjet fragmentare dhe të izoluara mund të bëhen një formë padijeje nëse bëjnë rezistencë për t'u integruar në një vizion më të gjerë të realitetit.

139. Kur flasim për “mjedis” i referohemi edhe një marrëdhënieje të veçantë: asaj mes natyrës dhe shoqërisë që banon në të. Kjo nuk na lejon ta konsiderojmë natyrën si diçka të ndarë prej nesh apo si një kornizë e thjeshtë e jetës sonë. Jemi të përfshirë në të, jemi pjesë e saj dhe jemi të bashkëdepërtuar

prej saj. Arsyet për të cilat një vend ndotet kërkojnë një analizë të funksionimit të shoqërisë, të ekonomisë së saj, të sjelljes së saj, të mënyrave të saj për ta kuptuar realitetin. Duke pasur parasysh gjerësinë e ndryshimeve, nuk është më e mundur të gjendet një përgjigje specifike dhe e pavarur për çdo pjesë të veçantë të problemit. Është themelore të kërkojnë zgjidhje integrale, që konsiderojnë ndërveprimet e sistemeve natyrore mes tyre dhe me sistemet shoqërore. Nuk ekzistojnë dy kriza të ndara, një mjedisore dhe një tjetër shoqërore, por ekziston një krizë e vetme dhe komplekse socio-mjedisore. Linjat për zgjidhjen e problemit kërkojnë një metodë integrale për të luftuar varfërinë, për t'u kthyer dinjitetin të përjashtuarve dhe në të njëjtën kohë për t'u kujdesur për natyrën.

140. Për shkak të sasisë dhe larmisë së elementeve që duhen mbajtur parasysh, në momentin e përcaktimit të efektit

mjedisor të një veprimtarie konkrete ndërmarrjeje, bëhet e domosdoshme t'u jepet kërkuesve një rol kryesor dhe të lehtësohet ndërveprimi i tyre, me liri të gjerë akademike. Ky kërkim i vazhdueshëm do të duhej të lejonte që të njihet edhe se si krijesat e ndryshme vihen në marrëdhënie mes tyre, duke formuar ato njësi më të mëdha që sot i quajmë "ekosisteme". Nuk i marrim në shqyrtim vetëm për të përcaktuar se cili është përdorimi i tyre i arsyeshëm, por sepse kanë një vlerë përkatëse të pavarur prej këtij përdorimi. Sikurse çdo organizëm është i mirë dhe i admirueshëm në vetvete për faktin se është krijesë e Hyjit, e njëjta gjë ndodh me tërësinë harmonike të organizmave në një hapësirë të caktuar, që funksionon si sistem. Edhe pse nuk jemi të vetëdijshëm, varemi nga kjo tërësi për vetë ekzistencën tonë. Duhet të kujtojmë se ekosistemet ndërhyjnë në heqjen e anhidritit karbonik, në pastrimin e ajrit, në luftën kundër sëmundjeve dhe

infektiveve, në përbërjen e dheut, në dekompozimin e mbeturinave dhe në shumë shërbime të tjera që i harrojmë apo i shpërfillim. Kur e kuptojnë këtë, shumë persona ndërgjegjësohen përsëri për faktin se jetojmë dhe veprojmë duke nisur nga një realitet që na është dhuruar paraprakisht, që është para aftësive tona dhe ekzistencës sonë. Prandaj, kur flitet për “përdorim të pranueshëm” duhet gjithmonë të nisim një shqyrtim mbi aftësinë për regjenerim të çdo ekosistemi në sektorët dhe aspektet e veta të ndryshme.

141. Nga ana tjetër, rritja ekonomike priret të prodhojë automatizma dhe të homogjenizojë, me qëllim që të thjeshtësojë proceset dhe të pakësojë kostot. Për këtë arsye është e nevojshme një ekologi ekonomike, e aftë të na bëjë ta konsiderojmë realitetin në mënyrë më të gjerë. Në të vërtetë, «mbrojtja e mjedisit duhet të përbëjë një pjesë të domosdoshme të procesit të zhvillimit

dhe nuk mund të konsiderohet në mënyrë të izoluar».^[114] Por në të njëjtën kohë bëhet aktuale nevoja urgjente e humanizmit, që u bën thirrje dijeve të ndryshme, edhe asaj ekonomike, për një vizion më integral dhe integrues. Sot analiza e problemeve mjedisore është e pandashme nga një analizë e konteksteve njerëzore, familjare, punëtore, urbane, dhe nga marrëdhënia e secilit person me vetveten, që krijon një mënyrë të caktuar të vënies në marrëdhënie me të tjerët dhe me mjedisin. Ka një ndërveprim mes ekosistemeve dhe mes botëve të ndryshme të referimit shoqëror, e kështu tregohet edhe një herë se «gjithçkaja është më lart se e pjesshmja».^[115]

142. Nëse gjithçka është në marrëdhënie, edhe gjendja shëndetësore e institucioneve të një shoqërie sjell pasoja për mjedisin dhe për cilësinë e jetës njerëzore: «Çdo cenim i solidaritetit dhe i miqësisë shoqërore shkakton dëme mjedisore».^[116] Në këtë kuptim, ekologjia

shoqërore është domosdoshmërisht institucionale dhe arrin progresivisht përmasat e ndryshme që shkojnë nga grupi shoqëror parësor, familja, deri te jeta ndërkombëtare, duke kaluar nëpër bashkësinë lokale dhe Kombin. Brenda secilit nivel shoqëror dhe mes tyre, zhvillohen institucionet që rregullojnë marrëdhëniet njerëzore. Gjithçka që i dëmton sjell efekte të dëmshme, sikurse humbja e lirisë, padrejtësia dhe dhuna. Vende të ndryshme janë të drejtuara nga një sistem institucional i paqëndrueshëm, në dëm të popullsisë dhe në dobi të atyre që përfitojnë nga kjo gjendje e gjërave. Si brenda administratës së Shtetit, ashtu edhe në shprehjet e ndryshme të shoqërisë civile, ose në marrëdhëniet e banorëve mes tyre, vërehen me shpeshtësi të tepruar sjellje të paligjshme. Ligjet mund të hartohen në formë të saktë, por shpesh mbeten si letër e vdekur. Pra, a mund të shpresohet që legjislacioni dhe normativat në lidhje me mjedisin të jenë

realisht efikase? E dimë, për shembull, se Vendet e pajisura me një legjislacion të qartë për mbrojtjen e pyjeve, vazhdojnë të mbeten dëshmitarë të heshtur të shkeljes së tij. Gjithashtu, ajo që ndodh në një rajon, në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë, ushtron ndikime edhe mbi rajonet e tjera. Kështu për shembull, konsumi i drogave në shoqëritë e pasura shkakton një kërkesë të vazhdueshme apo në rritje për prodhime që vijnë nga rajonet e varfëruara, ku prishen sjelljet, shkatërrohen jetë dhe arrihet të degradohet mjedisi.

II. EKOLOGJIA KULTURORE

143. Së bashku me pasurinë natyrore, ekziston edhe një pasuri historike, artistike e kulturore, poashtu e kërcënuar. Është pjesë e identitetit të përbashkët të një vendi dhe bazë për të ndërtuar një qytet të banueshëm. Nuk bëhet fjalë për të shkatërruar e për të krijuar qytete të reja hipotetikusht më ekologjike, ku

jo gjithmonë është e dëshirueshme të jetohet. Duhet të integrohen historia, kultura dhe arkitektura e një vendi të caktuar, duke e ruajtur identitetin e tij zanafillor. Prandaj ekologjia kërkon edhe një kujdes për pasuritë kulturore të njerëzimit në domethënien e tyre më të gjerë. Në mënyrë më të drejtpërdrejtë, kërkon që t'u kushtohet vëmendje kulturave lokale në momentin në të cilin analizohen çështje të lidhura me mjedisin, duke bërë të dialogojnë gjuha tekniko-shkencore me gjuhën popullore. Është kultura e kuptuar jo vetëm si monumente të së kaluarës, por veçanërisht në kuptimin e vet të gjallë, dinamik e pjesëmarrës, që nuk mund të përjashtohet në momentin në të cilin rimendohet marrëdhënia e qenies njerëzore me mjedisin.

144. Vizioni konsumistik i qenies njerëzore, i favorizuar nga ingranazhet e ekonomisë aktuale të globalizuar, priret t'i bëjë homogjene kulturat dhe

ta dobësojë larminë e madhe kulturore, që është një thesar i njerëzimit. Për këtë arsye, pretendon t'i zgjidhë të gjitha vështirësitë nëpërmjet normativave njëformëshe ose me ndërhyrje teknike, bën që të shpërfilllet kompleksiteti i problematikave lokale, që kërkojnë pjesëmarrjen aktive të banorëve. Proceset e reja në përgatitje nuk mund të integrohen gjithmonë brenda modeleve të caktuarangjashtë por duhet të burojnë nga vetë kultura lokale. Ashtu sikurse jeta dhe bota janë dinamike, kujdesi për botën duhet të jetë elastik dhe dinamik. Zgjidhjet thjesht teknike rrezikojnë të marrin në shqyrtim simptoma që nuk u përgjigjen problematikave më të thella. Është e nevojshme të merret parasysh perspektiva e të drejtave të popujve dhe të kulturave, e në këtë mënyrë të kuptohet se zhvillimi i një grupi shoqëror supozon një proces historik brenda një konteksti kulturor dhe kërkon protagonizmin e vazhdueshëm të aktorëve shoqërorë lokalë *duke nisur*

nga kultura e tyre përkatëse. As nocioni i cilësisë së jetës nuk mund të imponohet, por duhet të kuptohet brenda botës së simboleve dhe dokeve përkatëse të secilit grup njerëzor.

145. Shumë forma të shfrytëzimit të thellë dhe degradimit të mjedisit mund të shterin jo vetëm mjetet lokale të jetesës, por edhe burimet shoqërore të cilat kanë lejuar një mënyrë të jetuari që për një kohë të gjatë ka mbështetur një identitet kulturor dhe një kuptim të ekzistencës e të të jetuarit së bashku. Zhdukja e një kulture mund të jetë e rëndë si ose edhe më shumë se zhdukja e një specieje shtazore apo vegjetale. Imponimi i një stili hegjemonik jete i lidhur me një mënyrë prodhimi mund të jetë aq i dëmshëm sa edhe tjetërsimi i ekosistemeve.

146. Në këtë kuptim, është e domosdoshme t'u kushtohet vëmendje e veçantë bashkësive autoktone me

traditat e tyre kulturore. Nuk janë një pakicë e thjeshtë mes të tjerave, por duhet të bëhen bashkëbiseduesit kryesorë, sidomos në momentin në të cilin bëhen projekte të mëdha që kanë lidhje me hapësirat e tyre. Në të vërtetë, për ta toka nuk është një e mirë ekonomike, por një dhuratë e Hyjit dhe e të parëve që në të pushojnë, një hapësirë e shenjtë me të cilën kanë nevojë të ndërveprojnë për të ushqyer identitetin e tyre dhe vlerat e tyre. Kur mbeten në territoret e tyre, janë ata që kujdesen më mirë për ta. Megjithatë, në anë të ndryshme të botës, janë objekt i presioneve që u bëhen në mënyrë që t'i braktisin tokat e tyre dhe t'i lënë ato të lira për projekte nxjerrëse, bujqësore apo blegtorale që nuk i kushtojnë vëmendje degradimit të natyrës dhe të kulturës.

III. EKOLOGJIA E JETËS SË PËRDITSHME

147. Që të mund të flasim për zhvillim të njëmendtë, do të duhet të verifikojmë se prodhohet një përmirësim integral në cilësinë e jetës njerëzore, dhe kjo kërkon të analizohet hapësira në të cilën zhvillohet ekzistenca e personave. Mjediset në të cilat jetojmë ndikojnë në mënyrën tonë të jetuarit të jetës, të ndierit dhe të vepruarit. Në të njëjtën kohë, në dhomën tonë, në shtëpinë tonë, në vendin tonë të punës dhe në lagjen tonë e përdorim mjedisin për të shprehur identitetin tonë. Përpiqemi t'i përshtatemi mjedisit, dhe kur ai është i çrregullt, i rrëmujshëm apo i mbushur me ndotje pamore e dëgjimore, tepria e nxitjeve i vë në provë përpjekjet tona për të zhvilluar një identitet të integruar dhe të lumtur.

148. Është e admirueshme krijimtaria dhe zemërgjerësia e personave dhe

grupeve që janë të aftë t'i përmbysin kufizimet e mjedisit, duke modifikuar efektet kundërshtuese të kushtëzimeve, dhe duke mësuar ta orientojnë ekzistencën e tyre në mes të çrregullimit dhe përkohësisë. Për shembull, në disa vende, ku fasadat e ndërtesave janë shumë të dëmtuara, ka persona që kujdesen me shumë dinjitet për brendësinë e banesave të tyre, ose ndihen rehat për arsye të përzemërsisë dhe miqësisë së njerëzve. Jeta shoqërore pozitive dhe e shëndoshë e banorëve përhap dritë në një mjedis që në pamje të parë është i padukshëm. Nganjëherë është e lavdërueshme ekologjia njerëzore që arrijnë ta zhvillojnë të varfrit në mes të shumë kufizimeve. Përshtypja e marrjes së frymës e prodhuar nga grumbullimet e banesave dhe nga hapësirat me dendësi të madhe banorësh, luftohet nëse zhvillohen marrëdhënie njerëzore afërsie dhe ngrohtësie, nëse krijohen bashkësi, nëse kufijtë mjedisorë kompensohen në brendësinë e secilit

person, që ndihet i përfshirë në një rrjet bashkimi dhe përkatësie. Në këtë mënyrë, çfarëdo vendi resht së qeni një ferr dhe bëhet konteksti i një jete të denjë.

149. Gjithashtu, është provuar se mjerimi i skajshëm që jetohet në disa mjedise pa harmoni, gjerësi dhe mundësi integrimi, lehtëson lindjen e sjelljeve çnjerëzore dhe manipulimin e personave nga ana e organizatave kriminale. Për banorët e lagjeve periferike shumë të pasigurta, përvoja e përditshme e kalimit nga tubimi i madh në anonimatën shoqërore që jetohet në qytetet e mëdha, mund të shkaktojë një përshtypje çrrënjësore që favorizon sjellje antishoqërore dhe dhunë. Megjithatë, dëshiroj të theksoj se dashuria është më e fortë. Shumë persona, në këto kushte, janë të aftë të endin lidhje përkatësie dhe bashkëjetese që e shndërrojnë tubimin e madh në një përvojë bashkësore në të cilën shemben

muret e unit dhe kapërcehen barrierat e egoizmit. Kjo përvojë e shpëtimit bashkësior është ajo që shpesh ngjall reagime krijuese për të përmirësuar një ndërtesë apo një lagje.^[117]

150. Duke pasur parasysh ndërlidhjen mes hapësirave urbane dhe sjelljes njerëzore, ata që projektojnë ndërtesa, lagje, hapësira publike dhe qytete, kanë nevojë për ndihmesën e disiplinave të ndryshme që lejojnë të kuptohen proceset, simbolizmi dhe sjelljet e personave. Nuk mjafton kërkimi i bukurisë në projekt, sepse ka edhe më shumë vlerë t'i shërbehet një tjetër lloji bukurie: cilësisë së jetës së personave, harmonisë së tyre me mjedisin, takimit dhe ndihmës së ndërsjellë. Edhe për këtë është shumë e rëndësishme që pikëpamja e banorëve të vendit të ndihmojë gjithmonë në analizën e planifikimit urbanistik.

151. Është e nevojshme të mirëmbahen

hapësirat publike, kuadrot e perspektivës dhe pikat e referimit urban që e shtojnë ndjenjën tonë të përkatësisë, përshtypjen tonë të rrënjës, ndjenjën tonë të “të ndierit në shtëpi” brenda qytetit që na përmban dhe na bashkon. Është e rëndësishme që pjesët e ndryshme të një qyteti të jenë të integruara mirë dhe që banorët të mund të kenë një vizion tërësie në vend që të mbyllen në një lagje, duke hequr dorë nga të jetuarit e krejt qytetit si një hapësirë e tyre e bashkëndarë me të tjerët. Çdo ndërhyrje në peizazhin urban apo rural duhet të marrë parasysh se elementet e ndryshme të një vendi formojnë një tërësi që perceptohet prej banorëve si një kuadër koherent me pasurinë e tij në domethënie. Në këtë mënyrë të tjerët reshtin së qeni të huaj dhe mund të perceptohen si pjesë e një “ne”-je që ndërtojmë së bashku. Po për këtë arsye, si në mjedisin urban ashtu edhe në atë rural, është mirë të ruhen disa hapësira në të cilat të evitohen ndërhyrje njerëzore që i modifikojnë ato

vazhdimisht.

152. Mungesa e banesave është e rëndë në shumë anë të botës, si në zonat rurale ashtu edhe në qytetet e mëdha, edhe për arsye se bilancet shtetërore zakonisht mbulojnë vetëm një pjesë të vogël të kërkesës. Jo vetëm të varfrit, por një pjesë e madhe e shoqërisë ndesh vështirësi serioze për të pasur një shtëpi të vetën. Pronësia e shtëpisë ka shumë rëndësi për dinjitetin e personave dhe për zhvillimin e familjeve. Bëhet fjalë për një çështje qendrore të ekologjisë njerëzore. Nëse në një vend të caktuar janë zhvilluar tashmë grumbullime të rrëmujshme shtëpish të paqëndrueshme, bëhet fjalë para së gjithash për t'i urbanizuar këto lagje, jo për t'i çrrënjësuar dhe për t'i dëbuar banorët e tyre. Kur të varfrit jetojnë në qendra të ndotura apo në grumbullime të rrezikshme, «nëse duhet të bëhet transferimi i tyre dhe për të mos i shtuar vuajtje vuajtjes, është e nevojshme të jepet një informacion i

përshtatshëm dhe paraprak, të jepen alternativa banesash dinjitoze dhe të përfshihen drejtpërdrejt të interesuarit». ^[118] Në të njëjtën kohë, krijimtaria do të duhej të bënte që të integroheshin lagjet problematike brenda një qyteti mikpritës. «Sa të bukura janë qytetet që e tejkalojnë mosbesimin e dëmshëm dhe i integrojnë të ndryshmit dhe që e bëjnë këtë integrim një faktor të ri zhvillimi! Sa të bukura janë qytetet që, edhe në planin e tyre arkitektonik, janë plot me hapësira që lidhin, vënë në marrëdhënie, favorizojnë njohjen e tjetrit!». ^[119]

153. Cilësia e jetës në qytete në një pjesë të madhe është e lidhur me transportet, që shpesh janë shkak i vuajtjeve të mëdha për banorët. Në qytete qarkullojnë shumë makina të përdorura nga një apo dy persona, prandaj trafiku bëhet i rënduar, çohet niveli i ndotjes, konsumohen sasi shumë të mëdha energjie jo të përtëritshme dhe bëhet i nevojshëm ndërtimi i më

shumë rrugëve dhe parkingjeve, që e dëmtojnë strukturën urbane. Shumë specialistë bien dakord në lidhje me nevojën për t'i dhënë parësi transportit publik. Megjithatë, disa masa të nevojshme vështirë se do të pranohen në mënyrë paqësore prej shoqërisë pa një përmirësim thelbësor të këtij transporti, që në shumë qytete sjell një trajtim të padenjë të personave për shkak të përqendrimit të popullsisë, të parehatisë apo të rrallësisë së shërbimeve dhe të pasigurisë.

154. Njohja e dinjitetit të veçantë të qenies njerëzore shumë herë bie ndesh me jetën e rrëmujshme që duhet të bëjnë personat në qytetet tona. Por kjo nuk duhet të na bëjë të harrojmë gjendjen e braktisjes dhe të shpërfilljes që vuajnë edhe disa banorë të zonave rurale, ku nuk arrijnë shërbimet thelbësore dhe ka punëtorë që punojnë në gjendje skllavërie, pa të drejta as pritshmëri për një jetë më dinjitoze.

155. Ekologjia njerëzore përfshin edhe diçka shumë të thellë: marrëdhënien e nevojshme të jetës së qenies njerëzore me ligjin moral që gjendet në natyrën e vet, marrëdhënie e domosdoshme që të mund të krijohet një mjedis më dinjitoz. Benedikti XVI pohonte se ekziston një «ekologji e njeriut» sepse «edhe njeriu ka një natyrë që duhet ta respektojë dhe që nuk mund ta manipulojë sipas qejfit».

^[120] Në këtë linjë, duhet të pranojmë se trupi ynë na vë në një marrëdhënie të drejtpërdrejtë me mjedisin dhe me qeniet e tjera të gjalla. Pranimi i trupit tonë si dhuratë e Hyjit është i nevojshëm për ta marrë e pranuar krejt botën si dhuratë të Atit dhe shtëpi të përbashkët; ndërsa një logjikë e sundimit mbi trupin tonë shndërrohet në një logjikë nganjëherë të hollë sundimi mbi botën e krijuar. Të mësojmë ta pranojmë trupin tonë, të kemi kujdes për të dhe të respektojmë domethëniet e tij është thelbësore për një ekologji të vërtetë njerëzore. Edhe ta çmojmë trupin tonë

në të qenit e tij femëror apo mashkullor është e nevojshme që të mund ta njohim vetveten në takimin me tjetrin që është i ndryshëm prej nesh. Në këtë mënyrë është e mundur të pranohet me gëzim dhurata specifike e tjetrit apo e tjetrës, vepër e Hyjit krijues, dhe të pasurohemi në mënyrë të ndërsjellë. Prandaj, nuk është i shëndoshë një qëndrim që pretendon «ta zhdukë ndryshimin seksual sepse nuk di më të ballafaqohet me të».^[121]

IV. PARIMI I SË MIRËS SË PËRBASHKËT

156. Ekologjia njerëzore është e pandashme prej nocionit të së mirës së përbashkët, një parim që kryen një rol qendror dhe njësuës në etikën shoqërore. Është «tërësia e atyre kushteve të jetës shoqërore ajo që u lejon si grupeve ashtu edhe secilit anëtar ta arrijë përsosshmërinë e vet më plotësisht dhe më shpejt».^[122]

157. E mira e përbashkët presupozon respektimin e personit njerëzor si themel, me të drejta themelore dhe të pacenueshme të caktuara për zhvillimin e tij të tërësishëm. Kërkon edhe mekanizmat e sigurisë shoqërore dhe zhvillimin e grupeve të ndryshme të ndërmjetme, duke zbatuar parimin e subsidiaritetit. Mes këtyre del në pah veçanërisht familja, si qeliza parësore e shoqërisë. Në të vërtetë, e mira e përbashkët ka nevojë për paqen shoqërore, domethënë për qëndrueshmërinë dhe sigurinë e një rendi të caktuar, që nuk realizohet pa një vëmendje të veçantë ndaj drejtësisë distributive, cenimi i së cilës shkakton gjithmonë dhunë. E gjithë shoqëria - dhe në të veçanërisht Shteti - ka detyrën të mbrojë dhe të nxisë të mirën e përbashkët.

158. Në kushtet aktuale të shoqërisë botërore, ku ndeshen shumë padrejtësi dhe janë gjithnjë e më shumë personat që skartohen, privohen prej të drejtave

njerëzore themelore, parimi i së mirës së përbashkët shndërrohet menjëherë, si rrjedhojë logjike dhe e pashmangshme, në një thirrje për solidaritet dhe në një zgjedhje parapëlqyese për më të varfrit. Kjo zgjedhje kërkon që të nxirren rrjedhojat e destinacionit të përbashkët të të mirave të tokës, por, siç jam përpjekur të tregoj në Nxitjen apostolike Evangelii gaudium,^[123] kërkon të merret para sysh kryesisht dinjiteti i pamasë i të varfrit në dritën e bindjeve më të thella të fesë. Mjafton të vërejmë realitetin për të kuptuar se sot kjo zgjedhje është një kërkesë etike themelore për realizimin efektiv të së mirës së përbashkët.

V. DREJTËSIA MES BREZAVE

159. Nocioni i së mirës së përbashkët përfshin edhe brezat e ardhshëm. Krizat ekonomikendërkombëtare i kanë treguar troç efektet e dëmshme që sjell me vete mosnjohja e një fati të përbashkët, prej të cilit nuk mund të përjashtohen ata që do

të vijnë pas nesh. Tashmë nuk mund të flitet më për zhvillim të arsyeshëm pa një solidaritet mes brezave. Kur mendojmë për situatën në të cilën u lihet planeti brezave të ardhshëm, hyjmë në një tjetër logjikë, atë të dhuratës falas që marrim dhe komunikojmë. Nëse toka na është dhuruar, nuk mund të mendojmë më vetëm duke nisur nga një kriter efience dhe prodhimit për përfitimin individual. Nuk jemi duke folur për një qëndrim fakoltativ, por për një çështje thelbësore drejtësie, meqenëse toka që kemi marrë u përket edhe atyre që do të vijnë. Ipeshkvinjtë e Portugalisë kanë nxitur që të merret përsipër kjo detyrë drejtësie: «Mjedisi vendoset në logjikën e marrjes. Është një hua që çdo brez e merr dhe duhet t'ia përçojë brezit të ardhshëm».^[124] Një ekologji integrale ka këtë vizion të gjerë.

160. Çfarë lloj bote dëshirojmë t'u përçojmë atyre që do të vijnë pas nesh, fëmijëve që janë duke u rritur? Kjo

pyetje nuk ka lidhje vetëm me mjedisin në mënyrë të izoluar, sepse çështja nuk mund të shtrohet në mënyrë të pjesshme. Kur pyesim veten në lidhje me botën që duam të lëmë, i referohemi sidomos orientimit të saj të përgjithshëm, kuptimit të saj, vlerave të saj. Nëse nuk tingëllon në to kjo pyetje bazë, nuk besoj se shqetësimet tona ekologjike mund të arrijnë efekte të rëndësishme. Por nëse kjo pyetje shtrohet me guxim, në mënyrë të pashmangshme na çon në pikëpyetje të tjera të drejtpërdrejta: Për çfarë qëllimi kalojmë nga kjo botë? Për çfarë qëllimi kemi ardhur në këtë botë? Për çfarë qëllimi punojmë dhe luftojmë? Pse kjo tokë ka nevojë për ne? Prandaj, nuk mjafton më të themi se duhet të shqetësohemi për brezat e ardhshëm. Duhet të kuptojmë se ai që është në lojë është dinjiteti ynë. Jemi ne të parët e interesuar për të përçuar një planet të banueshëm për njerëzimin që do të vijë pas nesh. Është një dramë për veten tonë, sepse kjo ka të bëjë me domethënien e

kalimit tonë në këtë tokë.

161. Parashikimet katastrofike tashmë nuk mund të shikohen me përçmim dhe ironi. Mund t' u lëmë brezave të ardhshëm tepër rrënoja, shkretëtira dhe ndyrësi. Ritmi i konsumit, i shkapërderdhjes dhe i tjetërsimit të mjedisit i ka kapërcyer mundësitë e planetit, në mënyrë të tillë që stili i jetës aktuale, duke qenë i papërballueshëm, mund të çojë vetëm në katastrofa, sikurse faktikisht është duke ndodhur tashmë periodikisht në rajone të ndryshme. Zbutja e efekteve të çekuilibrit aktual varet nga ajo që bëjmë tani, sidomos nëse mendojmë për përgjegjësinë që do të na lënë ata që do t' u duhet të durojnë pasojat më të këqija.

162. Vështirësia për ta marrë seriozisht këtë sfidë është e lidhur me një shkatërrim etik e kulturor, që shoqëron atë ekologjike. Burri dhe gruaja e botës pasmoderne rrezikojnë vazhdimisht të bëhen thellësisht individualistë, dhe

shumë probleme shoqërore aktuale duhen vënë në marrëdhënie me kërkimin egoist të kënaqësisë së menjëhershme, me krizat e lidhjeve familjare e shoqërore, me vështirësitë për ta njohur tjetrin. Shumë herë gjendemi përballë një konsumi të tepruar dhe miop të prindërve që i dëmton bijtë, të cilët ndeshin gjithnjë e më shumë vështirësi për të blerë një shtëpi të vetën dhe për të formuar një familje. Gjithashtu, kjo paaftësi për të menduar seriozisht për brezat e ardhshëm është e lidhur me paaftësinë tonë për ta zgjeruar horizontin e shqetësimeve tona dhe për të menduar për ata që mbeten të përjashtuar prej zhvillimit. S'kemi pse të humbim kohë për të imagjinuar të varfrit e së ardhmes, është e mjaftueshme të kujtojmë të varfrit e sotëm, që kanë pak vite për të jetuar në këtë tokë dhe nuk mund të vazhdojnë të presin. Prandaj, «përveç solidaritetit të çiltër ndërbreznor, duhet të ripropozojmë nevojën morale për një solidaritet të përtërirë ndërbreznor».^[125]

KAPITULLI I PESTË

DISA LINJA ORIENTIMI DHE VEPRIMI

163. Jam munduar të marr në shqyrtim situatën aktuale të njerëzimit, si në të çarat e planetit ku banojmë, ashtu edhe në shkaqet më thellësisht njerëzore të degradimit mjedisor. Megjithëse edhe vetëm kjo soditje e realitetit në vetvete na tregon nevojën për një ndryshim drejtimi dhe na sugjeron disa veprime, tani le të provojmë të përvijojmë disa itinerare të mëdha dialogu që na ndihmojnë të dalim prej spirales së vetëshkatërrimit në të cilën jemi duke u mbytur.

I. DIALOGU MBI MJEDISIN NË POLITIKËN DËRKOMBËTARE

164. Prej gjysmës së shekullit të kaluar, duke kapërcyer shumë vështirësi, ka shkuar duke u afirmuar prirja për ta konceptuar planetin si atdhe dhe njerëzimin si popull që banon në një shtëpi të përbashkët. Një botë e ndërvarur nuk do të thotë vetëm të kuptojmë se pasojat e dëmshme të stileve të jetës, të prodhimit dhe të konsumit i godasin të gjithë, por, kryesisht, të bëjmë që zgjidhjet të propozohen duke nisur nga një perspektivë globale dhe jo vetëm në mbrojtje të interesave të disa Vendeve. Ndërvarësia na detyron të mendojmë *vetëm për një botë, për një projekt të përbashkët*. Por e njëjta inteligjencë që përdoret për një zhvillim tejet të madh teknologjik, nuk arrin të gjejë forma efikase të organizimit ndërkombëtar për të zgjidhur vështirësitë e mëdha mjedisore dhe shoqërore. Për të përballuar problemet

bazë, që nuk mund të zgjidhen nga veprimet e Vendeve veçmas, bëhet i domosdoshëm një konsensus botëror i cili bën, për shembull, të programohet një bujqësi e arsyeshme dhe e larmizuar, të zhvillohen forma të përtëritshme dhe jo shumë ndotëse energjie, të nxitet një efikasitet më i madhe energjetike, të nxitet një administrim më i përshtatshëm i burimeve pyjore e detare, t'u sigurohet të gjithëve mundësia e përdorimit të ujit të pijshëm.

165. E dimë se teknologjia e bazuar në lëndët djegëse fosile, shumë ndotëse - sidomos karboni, por edhe nafta e, në masë më të vogël, gazi -, duhet zëvendësuar progresivisht dhe pa ngurrim. Në pritje të një zhvillimi të gjerë të energjive të përtëritshme, që tashmë duhet të ketë filluar, është e ligjshme të zgjidhet e keqja më e vogël apo të gjenden zgjidhje kalimtare. Megjithatë, në bashkësinë ndërkombëtare nuk arrihen marrëveshje të përshtatshme

në lidhje me përgjegjësinë e atyre që duhet të durojnë kostot më të mëdha të tranzicionin energjetik. Në dhjetëvjeçarët e fundit çështjet mjedisore i kanë dhënë fill një debati të gjerë publik, që ka bërë të rriten në shoqërinë civile hapësira angazhimi të ndjeshëm dhe përkushtimi bujar. Politika dhe industria përgjigjen me ngadalësi, nuk janë në lartësinë e sfidave botërore. Në këtë kuptim mund të thuhet se, ndërsa njerëzimi i periudhës pas-industriale ndoshta do të kujtohet si një prej më të papërgjegjshmit e historisë, duhet të urojmë që njerëzimi i fillimeve të shekullit XXI të mund të kujtohet për faktin se ka marrë përsipër me bujari përgjegjësitë e veta të rënda.

166. Lëvizja ekologjike botërore ka bërë tashmë një rrugëtim të gjatë, të pasuruar prej përpjekjes së shumë organizatave të shoqërisë civile. Nuk është e mundur t'i përmendim të gjitha këtu, as të ripërshkojmë historinë e ndihmesave të tyre. Por falë një angazhimi kaq të madh,

çështjet mjedisore kanë qenë gjithnjë e më të pranishme në axhendën publike dhe janë bërë një ftesë e vazhdueshme për të menduar në mënyrë afatgjatë. Pavarësisht prej kësaj, Takimet botërore të nivelit të lartë mbi mjedisin e viteve të fundit nuk u janë përgjigjur pritshmërive sepse, për mungesë vendimi politik, nuk kanë arritur marrëveshje mjedisore globale realisht domethënëse dhe efikase.

167. Duhet kujtuar Takimi i Tokës i kremtuar në vitin 1992 në Rio de Zhaneiro. Në atë rast është deklaruar se «qeniet njerëzore janë në qendrën e shqetësimeve në lidhje me zhvillimin e arsyeshëm».^[126] Duke marrë disa përmbajtje të Deklaratës së Stokholmit (1972), ka vendosur, ndër të tjera, bashkëpunimin ndërkombëtar për mbrojtjen e ekosistemit të të gjithë tokës, detyrimin nga ana e atyre që ndotin që të përgjigjen ekonomikisht, detyrën për të vlerësuar efektin mjedisor të çdo vepre

apo projekti. Ka propozuar objektivin që të stabilizohen përqendrimet e gazit serrë në atmosferë për ta ndryshuar prirjen drejt ngrohjes globale. Ka përpunuar edhe një axhendë me një program veprimi dhe një konventë mbi larminë biologjike, ka deklaruar parime në fushën pyjore. Megjithëse ai takim ka qenë me të vërtetë novativ dhe profetik për epokën e vet, marrëveshjet kanë pasur një nivel të ulët zbatues sepse nuk janë caktuar mekanizma të përshtatshëm kontrolli, verifikimi periodik dhe sanksionimi të shkeljeve. Parimet e paraqitura vazhdojnë të kërkojnë rrugë efikase dhe të shpejta realizimi praktik.

168. Ndër përvojat pozitive mund të përmendet, për shembull, Konventa e Bazilesë në lidhje me mbeturinat e rrezikshme, me një sistem komunikimi, nevelesh të caktuara dhe kontrollesh; ashtu si edhe Konventa detyruese në lidhje me tregtinë ndërkombëtare të specieve të faunës dhe florës së egër të

kërcënuara nga zhdukja, që parasheh misione verifikimi dhe aktualizimi efektiv. Falë Konventës së Vjenës për mbrojtjen e shtresës së ozonit e zbatimit të saj nëpërmjet Protokollit të Montrealit dhe emendamenteve të tij, problemi i hollimit të kësaj shtrese duket se ka hyrë në një fazë zgjidhjeje.

169. Për sa i përket mbrojtjes së larmisë biologjike dhe shkretizimit, përparimet kanë qenë shumë më pak domethënëse. Për sa u përket ndryshimeve klimatike, përparimet janë mjerisht shumë më të pakta. Pakësimi i gazrave serrë kërkon ndershmëri, guxim dhe përgjegjësi, veçanërisht nga ana e Vendeve më të fuqishme dhe më ndotëse. Konferenca e Kombeve të Bashkuara mbi Zhvillimin e Arsyeshëm e emërtuar Rio+20 (Rio de Zhaneiro 2012), ka bërë një Deklaratë përfundimtare të gjerë por jo efikase. Negociatat ndërkombëtare nuk mund të përparojnë në mënyrë domethënëse për shkak të pozicioneve të Vendeve që

privilegjojnë interesat e tyre kombëtare në vend të së mirës së përbashkët globale. Ata që do të pësojnë rrjedhojat që ne përpiqemi të fshehim, do ta kujtojnë këtë mungesë ndërgjegjeje dhe përgjegjësie. Ndërsa po përpunohej kjo Enciklikë, debati ka marrë një forcë të veçantë. Ne besimtarët nuk mund të mos i lutemi Hyjit për zhvillimet pozitive të diskutimeve aktuale, në mënyrë që brezat e ardhshëm të mos vuajnë pasojat e ngurrimeve të pamatura.

170. Disa prej strategjive për nxjerrjen e ulët të gazrave ndotës synojnë ndërkombëtarizimin e kostove mjedisore, me rrezikun që t'u imponojnë Vendeve me burime më të pakta angazhime të rënda mbi pakësimet e nxjerrjeve, të ngjashme me ato të Vendeve më të industrializuara. Imponimi i këtyre masave i penalizon Vendet më nevojtare për zhvillim. Në këtë mënyrë shtohet një padrejtësi e re nën maskën e kujdesit për mjedisin.

Edhe në këtë rast, shtohet një e keqe tjetër. Meqenëse efektet e ndryshimeve klimatike do të ndihen për shumë kohë, edhe nëse tani merren masa rigoroze, disa Vende me burime të pakta do të kenë nevojë për ndihmë që t'u përshtaten efekteve që tashmë janë duke u prodhuar dhe që i godasin ekonomitë e tyre. Mbetet e sigurt se ka përgjegjësi të përbashkëta por të diferencuara, thjesht sepse, siç kanë pohuar Ipeshkvinjtë e Bolivisë, «Vendet që kanë përfituar prej një niveli të lartë indistrualizimi, me kosto të një nxjerrjeje të pamasë gazrash serrë, kanë përgjegjësi më të mëdha për të dhënë ndihmesën e tyre në zgjidhjen e problemeve që kanë shkaktuar».^[127]

171. Strategjia e shitblerjes së “krediteve të nxjerrjes” mund t'i japë fill një forme të re spekulimi dhe nuk do të shërbente për të pakësuar nxjerrjen globale të gazrave ndotës. Ky sistem duket se është një zgjidhje e shpejtë dhe e lehtë, me dukjen e njëfarë angazhimi për

mjedisin, që megjithatë nuk përmban aspak një ndryshim rrënjësor në lartësinë e rrethanave. Madje, mund të bëhet një strategjemë që lejon të përkrahet superkonsumi i disa Vendeve dhe sektorëve.

172. Për Vendet e varfra përparësitë duhet të jenë çrrënjësja e mjerimit dhe zhvillimi shoqëror i banorëve të tyre; në të njëjtën kohë duhet të marrin në shqyrtim nivelin skandaloz të konsumit të disa sektorëve të privilegjuar të popullsisë së tyre dhe ta luftojnë më mirë korrupsionin. Sigurisht, duhet të zhvillojnë edhe forma më pak ndotëse të prodhimit të energjisë, por për këtë kanë nevojë të mbështeten në ndihmën e Vendeve që janë rritur shumë në dëm të ndotjes aktuale të planetit. Shfrytëzimi i drejtpërdrejtë i energjisë së begatshme diellore kërkon që të përcaktohen mekanizma dhe mbështetje ekonomike në mënyrë që Vendet në rrugë zhvillimi të mund të kenë të mundur transferimin e teknologjive, asistencën teknike dhe

burimet financiare, por gjithmonë duke pasur kujdes për kushtet konkrete, meqenëse «jo gjithmonë vlerësohet siç duhet pajtueshmëria e impianteve me kontekstin për të cilin janë projektuar». ^[128] Kostot do të ishin të ulta nëse do të krahasoheshin me rrezikun e ndryshimeve klimatike. Sidoqoftë, është para së gjithash një vendim etik, i bazuar në solidaritetin e të gjithë popujve.

173. Ka nevojë për marrëveshje ndërkombëtare që të realizohen, duke pasur parasysh aftësinë e mangët të instancave lokale për të ndërhyrë në mënyrë efikase. Marrëdhëniet mes Shteteve duhet të mbrojnë sovranitetin e secilit, por edhe të caktojnë itinerare të vendosura së bashku për të shmangur katastrofa lokale që do të arrinin t'i dëmtonin të gjithë. Duhet kuadro rregulluese globale që imponojnë detyrime dhe që pengojnë veprime të papranueshme, sikurse fakti që Vende të fuqishme të shkarkojnë mbi Vende

të tjera mbeturina dhe industri shumë ndotëse.

174. Po përmendim edhe sistemin e *governance* të oqeanëve. Në të vërtetë, megjithëse ka pasur konventa të ndryshme ndërkombëtare dhe rajonale, fragmentizimi dhe mungesa e mekanizmave të rreptë të planifikimit, kontrollit dhe sanksionimit arrijnë t'i minojnë të gjitha përpjekjet. Problemi në rritje i mbeturinave detare dhe i mbrojtjes së zonave detare përtej kufijve kombëtarë vazhdon të përfaqësojë një sfidë të veçantë. Si përfundim, kemi nevojë për një marrëveshje mbi regjimet e *governance* për gjithë gamën e të ashtuquajturave të mira të përbashkëta globale.

175. E njëjta logjikë që e bën të vështirë marrjen e vendimeve drastike për ta përmbysur prirjen drejt ngrohjes globale është ajo që nuk lejon të realizohet objektivi i çrrënjësjes së

varfërisë. Kemi nevojë për një reagim global më të përgjegjshëm, që do të thotë të përballohet njëkohësisht pakësimi i ndotjes dhe zhvillimi i Vendeve e i rajoneve të varfra. Shekulli XXI, ndërsa mban një *governance* përkatëse të epokave të kaluara, asiston në një humbje pushteti të Shteteve kombëtare, sidomos sepse përmasa ekonomiko-financiare, me karakteristika transkombëtare, priret të sundojë mbi politikën. Në këtë kontekst, bëhet i domosdoshëm zhvillimi i institucioneve ndërkombëtare më të forta dhe të organizuara në mënyrë efikase, me autoritete të caktuara në mënyrë të paanshme nëpërmjet marrëveshjeve mes qeverive kombëtare dhe të pajisura me pushtetin për të sanksionuar. Sikurse ka pohuar Benedikti XVI në linjën e zhvilluar më parë prej doktrinës shoqërore të Kishës, «për administrimin e ekonomisë botërore, për të shëruar ekonomitë e goditura prej krizës, për të parandaluar përkeqësime të së njëjtës dhe çekuilibre më të

mëdha rrjedhuese; për të realizuar një çarmatosje të dobishme e të tërësishme, sigurinë ushqimore dhe paqen; për të garantuar mbrojtjen e mjedisit dhe për të disiplinuar flukset migruese, nevojitet prania e një *Autoriteti politik botëror të vërtetë*, siç është përshkruar prej Paraardhësit tim, [shën] Gjoni XXIII». ^[129] Në këtë perspektivë, diplomacia merr një rëndësi të padëgjuar, për të nxitur strategji ndërkombëtare për të parandaluar problemet më të rënda që përfundojnë t'i godasin të gjithë.

II. DIALOGU DREJT POLITIKAVE TË REJA KOMBËTARE DHE LOKALE

176. Nuk ka të fituar e të mundur vetëm mes Vendeve, por edhe brenda Vendeve të varfra, në të cilat duhet të identifikohen përgjegjësi të ndryshme. Prandaj, çështjet në lidhje me mjedisin dhe me zhvillimin ekonomik nuk mund të shtrohen më vetëm duke nisur nga

ndryshimet mes Vendeve, por kërkojnë që të përqendrohet vëmendja në politikat kombëtare dhe lokale.

177. Para përgjegjesisë së një përdorimi të papërgjegjshëm të aftësive njerëzore, janë funksione të pashmangshme të çdo Shteti ato të planifikimit, koordinimit, mbikëqyrjes dhe sanksionimit brenda territorit të tij. Shoqëria, në çfarë mënyre e organizon dhe e ruan formimin e vet në një kontekst novacionesh të vazhdueshme teknologjike? Një faktor që vepron si moderator efektiv është e drejta, që përcakton rregullat për sjelljet e lejuara në dritën e së mirës së përbashkët. Kufijtë që duhet të vendosë një shoqëri e shëndoshë, e pjekur dhe sovrane kanë të bëjnë me parashikimin dhe masat parandaluese, rregulloret e përshtatshme, mbikëqyrjen e zbatimit të normave, luftën ndaj korrupsionit, veprimet e kontrollit operativ mbi daljen në pah të efekteve jo të dëshiruara të proceseve prodhuese, dhe ndërhyrjen

e përshtatshme përballë rreziqeve të papërcaktuara apo potenciale. Ekziston një jurisprudencë në rritje, e orientuar për të pakësuar efektet ndotëse të veprimtarive të ndërmarrjeve. Por struktura politike e institucionale nuk ekziston vetëm për të shmangur praktikën e këqija, por edhe për të nxitur praktikën e mira, për të nxitur krijimtarinë që kërkon rrugë të reja, për të lehtësuar nisma personale dhe kolektive.

178. Drama e një politike të fokalizuar në rezultatet e menjëhershme, e pësuar edhe nga populli konsumiste, e bën të nevojshëm prodhimin e rritjes afatshkurtër. Duke iu përgjigjur kërkesave zgjedhore, qeveritë nuk guxojnë lehtë ta acarojnë popullsinë me masa që mund të dëmtojnë nivelin e konsumit apo të vënë në rrezik investimet e jashtme. Ndërtimi miop i pushtetit frenon hyrjen e axhendës mjedisore largpamëse brenda axhendës

publike të qeverive. Kështu harrohet se «koha është më lart se hapësira» ^[130], se jemi gjithmonë më të frytshëm kur shqetësohemi të krijojmë procese, në vend që të zotërojmë hapësira pushteti. Madhështia politike dëftohet kur, në momentet e vështira, veprohet në bazë të parimeve të mëdha dhe duke menduar për të mirën e përbashkët afatgjatë. Pushteti politik e ka shumë të vështirë ta pranojë këtë detyrë në një projekt Kombi.

179. Në disa vende janë duke u zhvilluar kooperativa për shfrytëzimin e energjive të përtëritshme që lejojnë vetëmjaftueshmërinë lokale dhe madje edhe shitjen e prodhimit të tepërt. Ky shembull i thjeshtë tregon se, ndërsa rendi botëror ekzistues dëftohet i pafuqishëm për të marrë përsipër përgjegjësi, instanca lokale mund të bëjë ndryshimin. Në të vërtetë, pikërisht aty mund të lindin një përgjegjësi më e madhe, një ndjenjë e fortë bashkësore,

një aftësi e veçantë kujdesi dhe një krijimtari më bujare, një dashuri e thellë për tokën tonë, ashtu si edhe të menduarit për atë që u lëmë bijve dhe nipërve tanë. Këto vlera kanë rrënjë shumë të thella në popullsitë vendase. Meqenëse e drejta, nganjëherë, dëftohet e pamjaftueshme për shkak të korrupsionit, kërkohet një vendim politik nën shtytjen e popullsisë. Shoqëria, nëpërmjet organizmash jo qeveritare dhe shoqatash ndërmjetëse, duhet t'i detyrojë qeveritë të zhvillojnë normativa, procedura dhe kontrolle më të rrepta. Nëse shtetasit nuk e kontrollojnë pushtetin politik – kombëtar, rajonal dhe bashkiak – nuk është e mundur as një luftë kundër dëmeve mjedisore. Nga ana tjetër, legjislacionet bashkiake mund të jenë më efikase nëse ka marrëveshje mes popullsisive fqinje për të mbështetur të njëjtat politika mjedisore.

180. Nuk mund të mendohet për receta identike, sepse ka probleme dhe kufizime specifike të çdo Vendi e rajoni. Është e

vërtetë edhe se realizmi politik mund të kërkojë masa e teknologji tranzicioni, gjithmonë të shoqëruara nga plani dhe nga pranimi i angazhimeve graduale detyruese. Por, në të njëjtën kohë, në nivelin kombëtar e lokal ka gjithmonë shumë për t'u bërë, për shembull, të nxiten format e kursimit të energjisë. Kjo do të thotë të favorizohen modalitete prodhimi industrial me efikasitet maksimale energjetike dhe përdorim më të paktë të lëndëve të para, duke hequr nga tregu prodhimet jo shumë efikase nga këndvështrimi energjetik apo më ndotëse. Mund të përmendim edhe një administrim të mirë të transporteve apo teknikave të ndërtimit e ristrukturimit të ndërtesave që pakësojnë konsumin energjetik të tyre dhe nivelin e tyre të ndotjes. Nga ana tjetër, veprimi politik lokal mund të orientohet nga modifikimi i dokeve, nga zhvillimi i një ekonomie të mbeturinave dhe të riciklimit, nga mbrojtja e specieve të caktuara dhe nga programimi i një bujqësie të larmizuar

me rotacionin e të mbjellave. Është e mundur të favorizohet përmirësimi bujqësor i rajoneve të varfra nëpërmjet investimeve në infrastrukturën rurale, në organizimin e tregut lokal apo kombëtar, në sistemet e vaditjes, në zhvillimin e teknikave bujqësore të arsyeshme. Mund të lehtësohen forma bashkëpunimi apo organizimi bashkësior që të mbrojnë interesat e prodhuesve të vegjël dhe t'i ruajnë ekosistemet lokale prej grabitjes. Është shumë ajo që mund të bëhet!

181. Është e domosdoshme vazhdimësia, meqenëse nuk mund të modifikohen politikat në lidhje me ndryshimet klimatike dhe me mbrojtjen e mjedisit sa herë që ndryshon një qeveri. Rezultatet kërkojnë shumë kohë dhe kosto të drejtpërdrejta me efekte që nuk do të mund të dëftohen në periudhën e jetës së një qeverie. Prandaj, pa shtytjen e popullsisë dhe të institucioneve, do të ketë gjithmonë rezistenca për të ndërhyrë, aq më shumë kur ka urgjencë

për të zgjidhur. Që një politikan të marrë përsipër këto përgjegjësi me kostot që ato kërkojnë, nuk i përgjigjet logjikës eficientiste dhe “të menjëhershme” të ekonomisë dhe të politikës aktuale, por nëse do të ketë guximin ta bëjë, do të mundet përsëri ta njohë dinjitetin që Hyji i ka dhënë si person dhe, pas kalimit të tij në këtë histori, do të lërë dëshminë e një përgjegjësie bujare. Duhet t’i jepet më shumë hapësirë një politike të shëndoshë, të aftë për të reformuar institucionet, për t’i koordinuar dhe pajisur ato me praktika të mira, që lejojnë të kapërcehen shtytjet dhe inercitë e mbrapshta. Megjithatë, duhet të shtojmë se mekanizmat më të mirë arrijnë të vdesin kur mungojnë pikësynimet e mëdha, vlerat, një kuptim humanistik dhe i pasur me domethënie, të afta t’i japin çdo shoqërie një orientim fisnik dhe bujar.

III. DIALOGU DHE TRANSPARENCA NË PROCESET VENDIMMARRËSE

182. Parashikimi i ndikimit mjedisor të nismave sipërmarrëse dhe të projekteve kërkon procese politike transparente dhe të nënshtruar dialogut, ndërsa korrupsioni që fsheh efektin e vërtetë mjedisor të një projekti në këmbim të ndereve shpesh çon në marrëveshje të dyshimta që i shmangen detyrës për të informuar dhe një debati të thelluar.

183. Një studim i ndikimit mjedisor nuk duhet të bëhet pas përpunimit të një projekti prodhues apo të çfarëdo politike, plani apo programi. Duhet të përfshihet që në fillim dhe duhet të përpunohet në mënyrë ndërdisiplinore, transparente dhe të pavarur nga çdo presion ekonomik apo politik. Duhet të jetë i lidhur me analizën e kushteve të punës dhe të efekteve të mundshme mbi shëndetin fizik e mendor të personave, mbi ekonominë lokale,

mbi sigurinë. Rezultatet ekonomike do të mund të parashikohen kështu në mënyrë më realiste, duke mbajtur parasysh skenaret e mundshme dhe duke hershuar eventualisht nevojën për një intestim më të madh për të zgjidhur efekte të padëshirueshme që mund të ndreqen. Është gjithmonë e nevojshme të arrihet konsensusi mes aktorëve të ndryshëm shoqërorë, që mund të sjellin perspektiva, zgjidhje dhe alternativa të ndryshme. Por në debat duhet të kenë një vend të privilegjuar banorët e vendit, të cilët pyeten mbi atë që duan për vete dhe për bijtë e tyre, dhe mund të mbajnë parasysh qëllimet që tejkalojnë interesin ekonomik të menjëhershëm. Duhet të braktiset ideja e “ndërhyrjeve” mbi mjedisin, për t’u hapur udhë politikave të menduara dhe të diskutuara nga të gjitha palët e interesuara. Pjesëmarrja kërkon që të gjithë të jenë të informuar siç duhet mbi aspektet e ndryshme dhe mbi rreziqet e mundësitë e ndryshme, dhe nuk kufizohet në vendimin fillestar

mbi një projekt, por nënkupton edhe veprime kontrolli apo monitorimi të vazhdueshëm. Ka nevojë për sinqeritet dhe të vërtetë në diskutimet shkencore e politike, pa u kufizuar vetëm duke konsideruar se çfarë është e lejuar apo jo prej legjislacionit.

184. Kur shfaqen rreziqe të mundshme për mjedisin që kanë të bëjnë me të mirën e përbashkët të tashme dhe të ardhme, kjo situatë kërkon «që vendimet të bazohen në një ballafaqim mes rreziqeve dhe të mirave të hamendësuarra për çdo zgjedhje të mundshme alternative»^[131]. Kjo vlen sidomos nëse një projekt mund të shkaktojë një rritje në shfrytëzimin e burimeve natyrore, në lëshimin e gazrave dhe në skorie, në prodhimin e mbeturinave, ose një ndryshim domethënës në peizazh, në habitatin e specieve të mbrojtura apo në një hapësirë publike. Disa projekte, jo të mbështetura nga një analizë e kujdesshme, mund ta dëmtojnë shumë cilësinë e jetës së një

vendi për arsye shumë të ndryshme mes tyre sikurse, për shembull, një ndotje akustike jo e parashikuar, zvogëlimi i gjerësisë pamore, humbja e vlerave kulturore, efektet e përdorimit të energjisë bërthamore. Kultura konsumiste, që i jep parësi afatit të shkurtër dhe interesit privat, mund të favorizojë praktika shumë të shpejta apo të lejojë fshehjen e informacionit.

185. Në çdo diskutim që i përket një nisme sipërmarrëse do të duhej të shtroheshin një seri pyetjesh, që të mund të të dallohet nëse do të çojë në një zhvillim të vërtetë të plotë: Për cilin qëllim? Për cilën arsye? Ku? Kur? Në çfare menyre? Kujt i drejtohet? Cilat janë rreziqet? Me çfarë kostojë? Kush i paguanë shpenzimet dhe si do ta bëjë? Në këtë provim ka çeshtje që tëkenë përparësi.

Për shembull, e dimë që uji është një burim i pamjaftueshëm dhe i domodoshëm, veç tjerash është ujë një e

drejtë themelore që kushtëzon ushtrimin e të drejtave të tjera njerëzore.

Kjo është e padyshimtë dhe tejkalon çdo lloj analize impakt mjedisore të një rajoni.

186. Në Deklaratën e Rios të vitit 1992, thuhet se «aty ku ka kërcënime me dëme të rënda apo të pakthyeshme, mungesa e sigurive të plota shkencore nuk do të mund të përbëjë një arsye për ta vonuar marrjen e masave efikase»^[132] që pengojnë degradimin e mjedisit. Ky parim i parandalimit lejon mbrojtjen e më të dobtëve, që kanë pak mjete për t'u mbrojtur dhe për të siguruar prova të pamohueshme. Nëse informacioni objektiv bën që të parashikohet një dëm i rëndë dhe i pakthyesëm, edhe po të mos ketë një demonstrim të padiskutueshëm, cilido projekt do të duhej të ndalohej apo të modifikohet. Në këtë mënyrë përmbyset detyrimi i provës, meqenëse në këto raste duhet të sigurohet një demonstrim objektiv dhe

vendimtar që veprimtaria e propozuar të mos i shkaktojë dëme të rënda mjedisit apo atyre që banojnë në të.

187. Kjo nuk do të thotë t'i kundërvihemi çfarëdo risie teknologjike që lejon të përmirësohet cilësia e jetës së një popullsie. Por në çdo rast duhet të mbetet pikë e ngultë se fitimi nuk mund të jetë kriteri i vetëm që duhet mbajtur parasysh dhe se, në momentin në të cilin mund të shfaqen elemente të reja gjykimi duke nisur nga zhvillimet e informacionit, duhet të ketë një vlerësim të ri me pjesëmarrjen e të gjitha palëve të interesuara. Rezultati i diskutimit do të mund të jetë vendimi për të mos e vazhduar një projekt, por mund të jetë edhe modifikimi i tij apo përpunimi i propozimeve alternative.

188. Ka diskutime, mbi çështje që i përkasin mjedisit, në të cilat është e vështirë të arrihet një konsensus. Edhe një herë po e përsëris se Kisha

nuk pretendon të përkufizojë çështjet shkencore, as të zërë vendin e politikës, por ftoj në një debat të ndershëm e transparent, në mënyrë që nevojat e veçanta apo ideologjitë të mos e cenojnë të mirën e përbashkët.

IV. POLITIKA DHE EKONOMIA NË DIALOG PËR PLOTËSINË NJERËZORE

189. Politika nuk duhet t'i nënshtrohet ekonomisë dhe kjo nuk duhet t'u nënshtrohet diktateve dhe paradigmës eficientiste të teknokracisë. Sot, duke menduar për të mirën e përbashkët, kemi nevojë në mënyrë të pashmangshme që politika dhe ekonomia, në dialog, të vihen vendosmërisht në shërbim të jetës, veçanërisht të jetës njerëzore. Shpëtimi me çdo kusht i bankave, duke e bërë popullsinë që ta paguajë çmimin, pa vendimin e ngultë për të rishikuar dhe reformuar krejt sistemin, ripohon një sundim absolut të financës që nuk

ka të ardhme dhe që do të mundet vetëm të shkaktojë kriza të reja pas një kujdesi të gjatë, të kushtueshëm dhe të rremë. Kriza financiare e viteve 2007-2008 ishte rasti për të zhvilluar një ekonomi të re më të kujdesshme ndaj parimeve etike, dhe për një planifikim të ri të veprimtarisë financiare spekulative dhe të pasurisë virtuale. Por nuk pati një reagim që do të bënte të rimendoheshin kriteret e vjetra që vazhdojnë të drejtojnë botën. Prodhimi nuk është gjithmonë i arsyeshëm, dhe shpesh është i lidhur me faktorë të ndryshueshëm ekonomikë që u japin produkteve një vlerë që nuk i përgjigjet vlerës së tyre reale. Kjo përcakton shumë herë një mbiprodhim të disa mallrave, me një ndikim mjedisor jo të nevojshëm, që në të njëjtën kohë dëmton shumë ekonomi rajonale.^[133] Bula financiare zakonisht është edhe një bulë prodhuese. Si përfundim, ai që nuk përballohet me vendosmëri është problemi i ekonomisë reale, e cila bën të mundur që të larmizohet dhe të

përmirësohet prodhimi, që ndërmarrjet të funksionojnë siç duhet, që ndërmarrjet e vogla dhe të mesme të zhvillohen e të krijojnë vende pune, e kështu me radhë.

190. Në këtë kontekst duhet të kujtojmë gjithmonë se «mbrojtja mjedisore nuk mund të sigurohet vetëm në bazë të llogaritjes financiare të kostove dhe dobive. Mjedisi është një prej atyre të mirave që mekanizmat e tregut nuk janë në gjendje t'i mbrojnë apo t'i nxisin siç duhet».^[134] Edhe një herë, është mirë të shmanget një konceptim magjik i tregut, që priret të mendojë se problemet zgjidhen vetëm me rritjen e përfitimeve të ndërmarrjeve apo të individëve. A është realiste të presim që ai i cili është i fiksuar pas maksimalizimit të përfitimeve të ndalet e të mendojë për efektet mjedisore që do t'u lërë brezave të ardhshëm? Brenda skemës së fitimit nuk ka vend të mendohet për ritmet e natyrës, për kohët e saj të degradimit dhe të përtëritjes, si dhe për

kompleksitetin e ekosistemeve që mund të tjetërsohen rëndë prej ndërhyrjes njerëzore. Gjithashtu, kur flitet për biodiversitet, maksimumi ai mendohet si një rezervë burimesh ekonomike që mund të shfrytëzohet, por nuk konsiderohen seriozisht vlera reale e gjërave, domethënia e tyre për personat e kulturat, interesat dhe nevojat e të varfërve.

191. Kur shtrohen këto çështje, disa reagojnë duke akuzuar të tjerët se pretendojnë ta ndalojnë në mënyrë të paarsyeshme përparimin dhe zhvillimin njerëzor. Por duhet të bindemi se ngadalësimi i një ritmi të caktuar prodhimi e konsumi mund t'i hapë udhë një modaliteti tjetër përparimi e zhvillimi. Përpyekjet për një përdorim të arsyeshëm të burimeve natyrore nuk janë një shpenzim i kotë, por një investim që do të mund të japë përfitime të tjera ekonomike afatmesme. Nëse nuk kemi botëkuptime të ngushta mund të

zbulojmë se larmizimi i një prodhimi më novativ dhe me më pak ndikim mjedisor, mund të jetë shumë dobisjellës. Bëhet fjalë t'u hapet rruga shanseve të ndryshme, që nuk kërkojnë të ndalet krijimtaria njerëzore dhe ëndrra e saj për përparim, por që të drejtohet kjo energji në mënyrë të re.

192. Për shembull, një itinerar zhvillimi prodhues më krijues dhe më mirë i orientuar mund ta ndreqë pabarazinë mes investimit të tepruar teknologjik për konsumin dhe atij të mangët për të zgjidhur problemet e ngutshme të njerëzimit; mund të krijojë forma inteligjente dhe dobisjellëse të ripërdorimit, të rekuperimit funksional dhe të riciklimit; mund të përmirësojë eficiencën energjetike të qyteteve; e kështu me radhë. Larmizimi prodhues i jep mundësi shumë të gjera inteligjencës njerëzore për të krijuar dhe modernizuar, ndërsa mbron mjedisin dhe krijon mundësi pune. Kjo do të

ishte një krijimtari e aftë për të bërë që të lulëzojë përsëri fisnikëria e qenies njerëzore, sepse është më dinjitoze të përdoret intelijenca, me guxim e përgjegjësi, për të gjetur forma zhvillimi të arsyeshëm dhe të drejtë, në kuadrin e një konceptimi më të gjerë të cilësisë së jetës. Anasjelltas, është më pak dinjitoze e krijuese dhe më sipërfaqësore të këmbëngulet në krijimin e formave të grabitjes së natyrës vetëm për të dhënë mundësi të reja konsumi dhe fitimi të menjëhershëm.

193. Sidoqoftë, nëse në disa raste zhvillimi i arsyeshëm do të sjellë modalitete të reja për t'u rritur, në raste të tjera, përballë rritjes lakmuese dhe të papërgjegjshme që është prodhuar për shumë dhjetëvjeçarë, duhet të mendohet edhe për ta ngadalësuar pak hapin, për të vënë disa kufij të arsyeshëm si dhe për t'u kthyer prapa para se të jetë vonë. E dimë se është e palogjikshme sjellja e atyre që konsumojnë dhe shkatërrojnë

gjithnjë e më shumë, ndërsa të tjerë ende nuk arrijnë të jetojnë si i ka hije dinjitetit të tyre njerëzor. Prandaj ka ardhur koha të pranohet njëfarë rënieje në disa anë të botës duke siguruar burime në mënyrë që të ketë rritje të shëndoshë në anë të tjera. Benedikti XVI thoshte se «është e nevojshme që shoqëritë teknologjike të përparuara të jenë të gatshme të favorizojnë sjellje të karakterizuara nga përkora, duke e pakësuar konsumin e tyre të energjisë dhe duke përmirësuar kushtet e përdorimit të saj».^[135]

194. Me qëllim që të lindin modele të reja përparimi kemi nevojë «të ndryshojë modeli i zhvillimit global»,^[136] gjë që kërkon të reflektohet në mënyrë të përgjegjshme «mbi kuptimin e ekonomisë dhe mbi qëllimin e saj, për t'i ndrequr anomalitë dhe deformimet e saj».^[137] Nuk mjafton të pajtohet, në një rrugë të ndërmjetme, kujdesi për natyrën me përfitimin financiar, apo ruajtja e mjedisit me përparimin. Mbi këtë temë

rrugët e mesme janë vetëm një vonesë e vogël e shkatërrimit. Thjesht bëhet fjalë për ta ripërkufizuar përparimin. Një zhvillim teknologjik dhe ekonomik që nuk lë një botë më të mirë dhe një cilësi jete integralisht më të lartë, nuk mund të konsiderohet përparim. Nga ana tjetër, shumë herë cilësia reale e jetës së personave pakësohet – prej dëmtimit të mjedisit, cilësisë së ulët të prodhimeve ushqimore apo shterjes së disa burimeve – në kontekstin e një rritjeje të ekonomisë. Në këtë kuadër, argumenti i rritjes së arsyeshme bëhet shpesh një diversiv dhe një mjet justifikimi që merr vlera të argumentit ekologjist brenda logjikës së financës e teknokracisë, dhe përgjegjësia shoqërore e mjedisore e ndërmarrjeve kufizohet në më të shumtën në një seri veprimesh të marketingut dhe të imazhit.

195. Parimi i maksimalizimit të përfitimit, që priret të izolohehet nga çfarëdo konsiderate tjetër, është një

shtrembërim konceptual i ekonomisë: nëse shtohet prodhimi, pak rëndësi ka nëse prodhohet në dëm të burimeve të ardhshme apo të shëndetit të mjedisit; nëse prerja e një pylli shton prodhimin, askush nuk e mat në këtë llogari humbjen që sjell shkretizimi i një territori, shkatërrimi i biodiversitetit apo shtimi i ndotjes. Do të thotë se ndër marrjet arrijnë përfitime duke llogaritur dhe duke paguar një pjesë të vogël të kostove. Mund të konsiderohet etike vetëm një sjellje në të cilën «kostot ekonomike dhe shoqërore që rrjedhin nga përdorimi i burimeve mjedisore të përbashkët njihen në mënyrë transparente dhe mbështeten plotësisht prej atyre që i përdorin dhe jo prej popullsive të tjera apo prej brezave të ardhshëm».^[138] Racionaliteti i mjeteve, që sjell vetëm një analizë statike të realitetit në funksion të nevojave të momentit, është i pranishëm si atëherë kur burimet i cakton tregu, si atëherë kur këtë e bën një Shtet planifikues.

196. Cili është vendi i politikës? Po kujtojmë parimin e subsidiaritetit, që jep liri për zhvillimin e aftësive të pranishme në të gjitha nivelet, por në të njëjtën kohë kërkon më shumë përgjegjësi ndaj së mirës së përbashkët nga ana e atyre që kanë në dorë pushtetin. Është e vërtetë se sot disa sektorë ekonomikë ushtrojnë më shumë pushtet se sa vetë Shtetet. Por nuk mund të justifikohet një ekonomi pa politikë, që do të ishte e paaftë të përvetësojë një tjetër logjikë në gjendje të drejtë aspektet e ndryshme të krizës aktuale. Logjika që nuk i lë hapësirë një shqetësimi të sinqertë për mjedisin është e njëjta në të cilën nuk gjen hapësirë shqetësimi për të integruar më të dobtit, sepse «në modelin “i suksesit” dhe “privatistik” që është në fuqi, nuk duket se ka kuptim të investohet që ata të cilët mbeten prapa, të dobtit apo më pak të aftët, të mund të bëjnë rrugë në jetë».^[139]

197. Kemi nevojë për një politikë që mendon me një vizion të gjerë, dhe që

çon përpara një kriter të ri integral, duke përfshirë në një dialog ndërdisiplinor aspektet e ndryshme të krizës. Shumë herë vetë politika është përgjegjëse për diskreditimin e vet, për shkak të korrupsionit dhe të mungesës së politikave të mira publike. Nëse Shteti nuk e kryen rolin e vet në një rajon, disa grupe ekonomike mund të duken si bamirës dhe të mbajnë në dorë pushtetin real, duke u ndier të autorizuar të mos i zbatojnë disa norma, deri në atë pikë sa t'u hapin udhë formave të ndryshme të kriminalitetit të organizuar, trafikimit të personave, narkotrafikut dhe dhunës shumë të vështira për t'u çrrënjosur. Nëse politika nuk është e aftë ta ndërpresë një logjikë të mbrapshtë, dhe përveç kësaj mbetet e bllokuar në argumente të dobëta, do të vazhdojmë të mos i përballojmë problemet e mëdha të njerëzimit. Një strategji e ndryshimit real kërkon që të rimendohet tërësia e proceseve, meqenëse nuk mjafton të përfshihen konsiderata ekologjike

sipërfaqësore ndërsa nuk vihet në diskutim logjika që varet prej kulturës aktuale. Një politikë e shëndoshë duhet të jetë e aftë ta marrë përsipër këtë sfidë.

198. Politika dhe ekonomia priren t'ia lënë fajin njëra-tjetrës për sa i përket varfërisë dhe degradimit mjedisor. Por ajo që pritet është që t'i pranojnë gabimet e veta dhe të gjejnë forma ndërveprimi të orientuara nga e mira e përbashkët. Ndërsa njëra palë shqetësohet vetëm për fitimin ekonomik dhe pala tjetër është e obsesionuar vetëm për të ruajtur dhe rritur pushtetin, ajo që na mbetet janë luftërat apo marrëveshjet e dyshimta ku ajo që u intereson më pak dy palëve është mbrojtja e mjedisit dhe kujdesi për më të dobtit. Edhe këtu vlen parimi se «njësia qëndron më lart se konflikti».^[140]

V. BESIMET NË DIALOGUN ME SHKENCAT

199. Nuk mund të mendohet që

shkencat empirike të shpjegojnë krejtësisht jetën, thelbin intim të të gjitha krijesave dhe tërësinë e realitetit. Kjo do të thotë t'i tejkalojnë padrejtësisht caqet e tyre të kufizuara metodologjike. Nëse reflektohet me këtë kuadër të ngushtë, zhduken ndjeshmëria estetike, poezia, dhe madje edhe aftësia e arsyes për të zbuluar kuptimin dhe qëllimin e gjërave.^[141] Dëshiroj të kujtoj se «tekstet fetare klasike mund të japin një domethënie të destinuar për të gjitha epokat, kanë një forcë motivuese që hap gjithmonë horizonte të reja [...]. A është e arsyeshme dhe inteligjente që ato të lihen në errësirë vetëm sepse kanë lindur në kontekstin e një besimi fetar?». ^[142] Në realitet, është thjeshtësuese të mendojmë se parimet etike mund të paraqiten në mënyrë thjesht abstrakte, të shkëputura nga çdo kontekst, dhe fakti se shfaqen me një gjuhë fetare nuk u heq atyre asnjë vlerë në debatin politik. Parimet etike që arsyeja është e aftë të perceptojë mund të rishfaqen gjithmonë nën dukje të

ndryshme dhe të shprehen me gjuhë të ndryshme, edhe fetare.

200. Nga ana tjetër, çfarëdo zgjidhjeje teknike që shkencat të pretendojnë të sjellin do të jetë e pafuqishme për të zgjidhur problemet e rënda të botës nëse njerëzimi e humb drejtimin e vet, nëse harrohen motivimet e mëdha që e bëjnë të mundur të jetuarit së bashku, sakrificën, mirësinë. Në çdo rast, do të duhet t'u bëhet thirrje besimtarëve që të jenë koherentë me fenë e tyre dhe të mos i kundërshtojnë asaj me veprimet e tyre, do të duhet të këmbëngulet që t'i hapen përsëri hirit të Hyjit dhe të marrin në thellësi prej bindjeve të veta mbi dashurinë, mbi drejtësinë dhe mbi paqen. Nëse një kuptim i keq i parimeve tona na ka bërë nganjëherë të shfajësojmë keqpërdorimin e natyrës apo sundimin despotik të qenies njerëzore mbi botën e krijuar, apo luftërat, padrejtësinë dhe dhunën, si besimtarë mund të pranojmë se në këtë mënyrë kemi qenë jo besnikë

ndaj thesarit të urtisë që duhej ta ruanim. Shumë herë kufizimet kulturore të epokave të ndryshme e kanë kushtëzuar këtë vetëdije të pasurisë përkatëse etike dhe shpirtërore, por është pikërisht kthimi në burimet e tyre respektive ai që u lejon besimeve t'u përgjigjen më mirë nevojave aktuale.

201. Pjesa më e madhe e banorëve të planetit deklaron se është besimtare, dhe kjo duhet t'i nxisë besimet të hyjnë në një dialog mes tyre të orientuar nga kujdesi për natyrën, nga mbrojtja e të varfërve, nga ndërtimi i një rrjeti respekti dhe vëllazërie. Është i domosdoshëm edhe një dialog mes vetë shkencave, meqenëse secila e ka zakon të mbyllet në kufizimet e gjuhës së vet, dhe specializimi priret të bëhet izolim e absolutizim i dijes përkatëse. Kjo nuk lejon që të përballohen siç duhet problemet e mjedisit. Po ashtu është i nevojshëm një dialog i hapur dhe respektues mes lëvizjeve të ndryshme ekologjiste, mes të cilave nuk

mungojnë luftërat ideologjike. Pesha e rëndë e krizës ekologjike kërkon prej të gjithëve ne që të mendojmë për të mirën e përbashkët dhe të ecim përpara në rrugën e dialogut që kërkon durim, askezë dhe zemërgjerësi, duke kujtuar gjithmonë se «realiteti qëndron më lart se ideja».^[143]

KAPITULLI I GJASHTË

EDUKIMI DHE PËRSHPIRTËRIA EKOLOGJIKE

202. Shumë gjëra duhet ta riorientojnë drejtimin e tyre, por para së gjithash është njerëzimi ai që ka nevojë të ndryshojë. Mungon vetëdija për një origjinë të përbashkët, për një përkatësi të ndërsjellë dhe për një të ardhme të bashkëndarë nga të gjithë. Kjo vetëdije bazë do të lejonte zhvillimin e bindjeve të reja, qëndrime dhe stile jete të reja. Kështu del në pah një sfidë e madhe kulturore, shpirtërore dhe edukative që do të kërkojë procese të gjata ripërtëritjeje.

I. TË SYNOJMË NJË TJETËR STIL JETE

203. Meqenëse tregu priret të krijojë një mekanizëm konsumist kompulsiv për të shitur prodhimet e veta, personat

përfundojnë të përpihen prej vorbullës së blerjeve dhe të shpenzimeve të kota. Konsumizmi obsesiv është refleksi subjektiv i paradigmës tekno-ekonomike. Ndodh ajo që thoshte Romano Guardini: qenia njerëzore «i pranon objektet e zakonshme dhe format e zakonshme të jetës ashtu siç i imponohen prej planeve racionale dhe prej makinave të normalizuara e, në kompleks, e bën këtë me përshtypjen se e gjithë kjo është e arsyeshme dhe e drejtë».^[144] Kjo paradigmë i bën të gjithë të mendojnë se janë të lirë deri sa ruajnë një liri të pretenduar për të konsumuar, kur në realitet ata që kanë lirinë janë ata që bëjnë pjesë në pakicën që mban në dorë pushtetin ekonomik e financiar. Në këtë përshtjellim, njerëzimi postmodern nuk e ka gjetur një kuptim të ri të vetvetes që mund ta orientojë, dhe kjo mungesë identiteti jetohet me ankth. Kemi mjete të tepërta për qëllime të pakta dhe të dobta.

204. Situata aktuale e botës «nxit një ndjenjë paqëndrueshmërie dhe pasigurie, që nga ana e vet favorizon forma të egoizmit kolektiv».^[145] Kur personat bëhen vetëreferencialë dhe izoloohen në ndërgjegjen e tyre, e shtojnë grykësinë e tyre. Sa më shumë që zemra e personave është e zbrazët, aq më shumë ka nevojë për të blerë, pasur dhe konsumuar objekte. Në këtë kontekst nuk duket e mundur që dikush të pranojë që realiteti t'i vërë një kufi. Në këtë horizont nuk ekziston as një e mirë e përbashkët e vërtetë. Nëse i tillë është tipi i subjektit që priret të mbizotërojë në një shoqëri, normat do të respektohen vetëm në atë masë në të cilën të mos u kundërvihen nevojave vetjake. Prandaj të mos mendojmë vetëm për mundësinë e dukurive të tmerrshme klimatike apo për fatkeqësitë e mëdha natyrore, por edhe për katastrofat që rrjedhin nga kriza shoqërore, sepse obsesioni për një stil konsumist jete, sidomos kur vetëm pak vetë mund ta kenë atë, do të mund

të nxisë vetëm dhunë dhe shkatërrim të ndërsjellë.

205. Megjithatë, jo gjithçka ka humbur, sepse qeniet njerëzore, të afta të degradohen deri në skaj, mund edhe ta kapërcejnë vetveten, të zgjedhin përsëri të mirën dhe të përtërihen, përtej çfarëdo kushtëzimi psikologjik dhe shoqëror që i imponohet. Janë të afta ta shikojnë vetveten me ndershmëri, të tregojnë neverinë e tyre dhe të ndërmarrin rrugë të reja drejt lirisë së vërtetë. Nuk ekzistojnë sisteme që e asgjësojnë krejtësisht hapjen ndaj së mirës, ndaj së vërtetës dhe ndaj bukurisë, as aftësinë për të reaguuar, që Hyji vazhdon ta nxisë prej thellësisë së zemrave tona. Çdo personi të kësaj bote i kërkoj të mos e harrojë këtë dinjitet të vetin që askush nuk ka të drejtën t'ia heqë.

206. Një ndryshim në stilet e jetës do të mund të arrinte të ushtronte një presion të shëndoshë mbi ata që kanë në dorë pushtetin politik, ekonomik dhe

shoqëror. Është ajo që ndodh kur lëvizjet e konsumatorëve arrijnë të bëjnë që të ndërpritet blerja e disa prodhimeve dhe kështu bëhen efikase për të modifikuar sjelljen e ndërmarrjeve, duke i detyruar ato të marrin parasysh ndikimin mjedisor dhe modelet e prodhimit. Është një fakt se, kur praktikat shoqërore i godasin përfitimet e ndërmarrjeve, këto janë të nxitura të prodhojnë në një mënyrë tjetër. Kjo na kujton përgjegjësinë shoqërore të konsumatorëve. «Blerja është gjithmonë një akt moral, përveçse ekonomik».^[146] Prandaj sot «tema e degradimit mjedisor thërret në çështje sjelljet e secilit prej nesh».^[147]

207. Karta e Tokës na thërriste të gjithëve ta linim pas shpine një fazë vetëshkatërrimi dhe të fillonim një fazë të re, por ende nuk e kemi zhvilluar një vetëdije universale që ta bëjë këtë të mundur. Prandaj guxoj ta propozoj përsëri atë sfidë të çmueshme: «Ashtu si kurrë më parë në histori, fati i përbashkët

na detyron të kërkojmë një fillim të ri [...]. Të urojmë që epoka jonë të mund të kujtohet për zgjimin e një respekti të ri për jetën, për vendosmërinë në arritjen e arsyeshmërisë, për përshpejtimin e luftës për drejtësi dhe paqe, si dhe për krenimin e gëzueshëm të jetës».^[148]

208. Është gjithmonë e mundur të zhvillohet një aftësi e re për të dalë nga vetvetja drejt tjetrit. Pa të nuk i njohim krijesat e tjera në vlerën e tyre të veçantë, nuk na intereson të kujdesemi për diçka në dobi të të tjerëve, na mungon aftësia për t'i vënë vetes disa kufij që ta shmangë vuajtjen apo degradimin e asaj që na rrethon. Qëndrimi themelor i vetë-tejkalimit, duke e kapërcyer ndërgegjen e izoluar dhe vetëreferencialitetin, është rrënja që bën të mundur çdo kujdes për të tjerët e për mjedisin, dhe bën të lindë reagimi moral për të konsideruar efektin e shkaktuar nga çdo veprim dhe nga çdo vendim personal përjashta vetvetes. Kur jemi të aftë ta kapërcejmë

individualizmin, mund të prodhohet efektivisht një stil jete alternative dhe bëhet i mundur një ndryshim i ndjeshëm në shoqëri.

II. TË EDUKOJMË NË ALEANCËN MES NJERËZIMIT DHE MJEDISIT

209. Vetëdija për peshën e krizës kulturore dhe ekologjike duhet të kthehet në tradita të reja. Shumë vetë e dinë se përparimi aktual dhe grumbullimi i thjeshtë i objekteve apo kënaqësive nuk mjaftojnë për t'i dhënë kuptim e gëzim zemrës njerëzore, por nuk ndihen të aftë të heqin dorë nga ato që tregu u ofron atyre. Në Vendet që do të duhej të prodhonin ndryshimet më të mëdha të zakoneve të konsumit, të rinjtë kanë një ndjeshmëri të re ekologjike dhe një shpirt bujar, e disa prej tyre luftojnë në mënyrë të admirueshme për mbrojtjen e mjedisit, por janë rritur në një kontekst konsumi dhe mirëqenieje shumë të lartë

që e bën të vështirë pjekjen e praktikave të tjera. Prandaj gjendemi përpara një sfide edukative.

210. Edukimi mjedisor ka shkuar duke i zgjeruar objektivat e veta. Nëse në fillim ishte shumë i përqendruar në informacionin shkencor dhe në ndërgjegjësimin e parandalimin e rreziqeve mjedisore, tani priret të përfshijë një kritikë të “miteve” të kohës moderne të bazuar në arsyen instrumentale (individualizmi, përparimi i papërcaktuar, konkurrenca, konsumizmi, tregu pa rregulla) si dhe të rekuperojë nivelet e ndryshme të ekuilibrit ekologjik: atë të brendshëm me vetveten, atë solidar me të tjerët, atë natyror me të gjitha qeniet e gjalla, atë shpirtëror me Hyjin. Edukimi mjedisor duhet të na përgatisë të bëjmë atë hap drejt Misterit, prej të cilit një etikë ekologjike nxjerr kuptimin e vet më të thellë. Nga ana tjetër ka edukatorë të aftë të ripërcaktojnë itineraret pedagogjike

të një etike ekologjike, në mënyrë që të ndihmojnë efektivisht për t'u rritur në solidaritet, në përgjegjësi dhe në kujdesin e bazuar në dhembshurinë.

211. Megjithatë, ky edukim, i thirrur të krijojë një "qytetari ekologjike", nganjëherë kufizohet vetëm duke informuar dhe nuk arrin të bëjë që të piqen disa zakone. Ekzistenca e ligjeve dhe normave nuk është e mjaftueshme në mënyrë afatgjatë për të kufizuar sjelljet e këqija, edhe kur ekziston një kontroll i vlefshëm. Me qëllim që norma juridike të prodhojë efekte të rëndësishme e të qëndrueshme është e nevojshme që pjesa më e madhe e anëtarëve të shoqërisë ta ketë pranuar duke nisur nga motivime të përshtatshme, dhe të reagojë sipas një shndërrimi personal. Vetëm duke nisur nga kultivimi i virtyteve të qëndrueshme është i mundur dhurimi i vetvetes në një angazhim ekologjik. Nëse një person, edhe pse kushtet e tij ekonomike i lejojnë të konsumojë dhe të

shpenzojë më shumë, zakonisht vishet pak më trashë në vend që të ndezë ngrohjen, kjo supozon se ka fituar bindje dhe mënyra të të ndierit të dobishme për kujdesin ndaj mjedisit. Është shumë fisnike të marrim përsipër detyrën që të kujdesemi për botën e krijuar me veprime të vogla të përditshme, dhe është diçka e mrekullueshme që edukimi të jetë i aftë t'i motivojë ato deri sa t'i japë formë një stili jete. Edukimi në përgjegjësinë mjedisore mund të nxisë sjellje të ndryshme që kanë një ndikim të drejtpërdrejtë dhe të rëndësishëm në kujdesin për mjedisin, sikurse shmangia e përdorimit të materialit plastik apo të letrës, pakësimi i konsumit të ujit, diferencimi i mbeturinave, gatimi vetëm i asaj që në mënyrë të arsyeshme do të mund të hahet, trajtimi me kujdes i qenieve të tjera të gjalla, përdorimi i transportit publik apo bashkëndarja e të njëjtit mjet nga persona të ndryshëm, mbjellja e pemëve, fikja e dritave të kota, e kështu me radhë. E gjithë kjo bën pjesë

në një krijimtari bujare dhe dinjitoze, që dëfton më të mirën e qenies njerëzore. Ta përdorim përsëri diçka në vend që ta heqim qafe me të shpejtë, duke nisur nga motivime të thella, mund të jetë një akt dashurie që shpreh dinjitetin tonë.

212. Nuk duhet të mendojmë se këto përpjekje nuk do ta ndryshojnë botën. Këto veprime përhapin një të mirë në shoqëri që gjithmonë prodhon fryte përtej asaj që mund të vërehet, sepse nxisin në gjirin e kësaj toke një të mirë që priret gjithmonë të përhapet, nganjëherë në mënyrë të padukshme. Gjithashtu, ushtrimi i këtyre sjelljeve na kthen kuptimin e dinjitetit tonë, na çon në një thellësi më të madhe ekzistenciale, na lejon të përjetojmë se ia vlen të kalojmë nëpër këtë botë.

213. Fushat edukative janë të ndryshme: shkolla, familja, mjetet e komunikimit, katekeza, dhe të tjera. Një edukim i mirë shkollor në fëmijëri dhe në adoleshencë hedh fara që mund të

prodhojnë efekte gjatë gjithë jetës. Por dëshiroj të theksoj rëndësinë qendrore të familjes, sepse ajo «është vendi në të cilin jeta, dhuratë e Hyjit, mund të pranohet dhe të mbrohet siç duhet kundër sulmeve të shumta prej të cilave rrezikohet, dhe mund të zhvillohet sipas kërkesave të një rritjeje të njëmendtë njerëzore. Kundër të ashtuquajturës kulturë e vdekjes, familja përbën selinë e kulturës së jetës».

[149] Në familje kultivohen traditat e para të dashurisë dhe të kujdesit për jetën, si për shembull përdorimi korrekt i gjërave, rregulli dhe pastërtia, respekti për ekosistemin lokal dhe mbrojtja e të gjitha krijesave. Familja është vendi i formimit të tërësishëm, ku shpalosen aspektet e ndryshme, të lidhura ngushtë mes tyre, të pjekurimit personal. Në familje ne mësojmë të kërkojmë leje pa mujshari, të themi “faleminderit” si shprehje e vlerësimit të sinqertë apo e vlerësimit për gjërat që marrim, të sundojmë agresivitetin apo grykësinë, dhe të kërkojmë falje kur bëjmë diçka të

keqe. Këto gjeste të vogla mirësjelljeje të sinqertë na ndihmojnë të ndërtojmë një kulturë të jetës së bashkëndarë dhe të respektit ndaj gjithçkaje që na rrethon.

214. Politikës dhe shoqatave të ndryshme u takon një përpjekje formimi të ndërgjegjeve. I takon edhe Kishës. Të gjitha bashkësitë e krishtera kanë një rol të rëndësishëm për të kryer në këtë edukim. Shpresoj po ashtu se në seminarët tona dhe në shtëpitë rregulltare të formimit të kryhet një edukim në përkorën e përgjegjshme, në soditjen mirënjohëse të botës, në kujdesin për brishtësinë e të varfërve dhe të mjedisit. Meqenëse është e madhe ajo që është në lojë, ashtu siç nevojiten institucione të pajisura me pushtet për të sanksionuar sulmet ndaj mjedisit, po ashtu kemi nevojë ta kontrollojmë dhe ta edukojmë njëri-tjetrin.

215. Në këtë kontekst, «nuk duhet lënë pas dore [...] marrëdhënia që gjendet

mes një edukimi të përshtatshëm estetik dhe ruajtjes së një mjedisi të shëndoshë». [150] T'i kushtojmë vëmendje bukurisë dhe ta duam atë na ndihmon të dalim nga pragmatizmi utilitaristik. Kur nuk mësojmë të ndalemi për të admiruar dhe çmuar të bukurën, nuk është e çuditshme që çdo gjë të shndërrohet në objekt përdorimi dhe keqpërdorimi të paskrupullt. Në të njëjtën kohë, nëse duam të arrijmë disa ndryshime të thella, duhet të mbajmë parasysh se modelet e mendimit ndikojnë realisht mbi sjelljet. Edukimi do të jetë jo efikas dhe përpjekjet e tij do të jenë të shterpëta nëse nuk shqetësohemi edhe për të përhapur një model të ri në lidhje me qenien njerëzore, me jetën, me shoqërinë dhe me marrëdhënien me natyrën. Përndryshe do të vazhdojë modeli konsumist i përçarur prej mjeteve të komunikimit dhe mekanizmave efikase të tregut.

III. KTHIMI EKOLOGJIK

216. Pasuria e madhe e përshtetërisë së krishterë, e krijuar prej njëzet shekujsh përvojash personale e bashkësore, përbën një ndihmesë të shkëlqyer për t'ia ofruar përpjekjes për të përtërirë njerëzimin. Dëshiroj t'u propozoj të krishterëve disa linja përshpirtërie ekologjike që lindin prej bindjeve të fesë sonë, sepse ajo që Ungjilli na mëson ka rrjedhoja në mënyrën tonë të menduarit, të ndierit dhe të jetuarit. Nuk bëhet fjalë edhe aq që të flasim për ide, se sa sidomos për motivimet që vijnë nga përshtetëria me qëllim që të ushqehet një pasion për kujdesin ndaj botës. Në të vërtetë, nuk do të jetë e mundur të angazhohemi në gjëra të mëdha vetëm me disa doktrina, pa një mistrikë që na frymëzon, pa «ndonjë shkak të brendshëm që na jep shtytje, na motivon, na inkurajon dhe i jep kuptim veprimtimit personal dhe bashkësor».^[151] Duhet ta pranojmë se jo gjithmonë ne të

krishterët i kemi pranuar dhe i kemi bërë të japin fryt pasuritë që Hyji i ka dhënë Kishës, ku përsheptëria nuk ndahet nga trupi, as nga natyra apo nga realitetet e kësaj bote, por jeton me to dhe në to, në bashkim me gjithçka që na rrethon.

217. Nëse «shkretëtirat e jashtme shumohen në botë, është sepse shkretëtirat e brendshme janë bërë kaq të gjera»,^[152] kriza ekologjike është një thirrje në një kthim të thellë të brendshëm. Megjithatë, duhet edhe ta pranojmë se disa të krishterë të angazhuar dhe të kushtuar lutjes, me pretekstin e realizmit dhe të pragmaticitetit, shpesh tallen me shqetësimet për mjedisin. Të tjerë janë pasivë, nuk vendosin t'i ndryshojnë zakonet e tyre dhe bëhen jo koherentë. Pra, u mungon një *kthim ekologjik*, që do të thotë të lënë të dalin në pah të gjitha pasojat e takimit me Jezusin në marrëdhëniet me botën që i rrethon. Ta jetojmë thirrjen për të qenë rojtarë të veprës së Hyjit është pjesë thelbësore e

një ekzistence të virtytshme, nuk përbën diçka opcionale dhe as një aspekt dytësor të përvojës së krishterë.

218. Të kujtojmë modelin e shën Françeskut të Asizit, për të propozuar një marrëdhënie të shëndoshë me botën e krijuar si një përmasë e kthimit të tërësishëm të personit. Kjo kërkon edhe që t'i pranojmë gabimet, mëkatet, veset apo shkujdesjet tona, dhe të pendo kemi me zemër, të ndryshojmë nga brenda. Ipeshkvinjtë e Australisë kanë ditur ta shprehin kthimin në termat e pajtimit me botën e krijuar: «Për ta realizuar këtë pajtim duhet t'i shqyrtojmë jetët tona dhe të njohim se në çfarë mënyre e fyejmë krijimin e Hyjit me veprimet tona dhe me paaftësinë tonë për të vepruar. Duhet të bëjmë përvojën e një kthimi, të një shndërrimi të zemrës».^[153]

219. Megjithatë, nuk mjafton që secili të jetë më i mirë për të zgjidhur një situatë aq të ndërlikuar si ajo që po përballon bota aktuale. Individët

mund ta humbasin aftësinë dhe lirinë për ta mposhtur logjikën e arsyes instrumentale dhe arrijnë të bëhen pre e një konsumizmi pa etikë dhe pa ndjenjë shoqërore e mjedisore. Problemeve shoqërore mund t'u përgjigjemi me rrjete bashkësiore, jo thjesht me shumën e të mirave individuale: «Kërkesat e kësaj vepre do të jenë kaq të mëdha sa mundësitë e nismave individuale dhe bashkëpunimi i individëve, të formuar në mënyrë individualiste, nuk do të jenë në gjendje t'u përgjigjen. Do të jetë i nevojshëm një bashkim forcash dhe një njësi ndihmesash».^[154] Kthimi ekologjik që kërkohet për të krijuar një dinamizëm ndryshimi kohëgjatë është edhe një kthim bashkësior.

220. Ky kthim kërkon qëndrime të ndryshme që të bashkohen për të aktivizuar një përkujdesje bujare dhe plot dashuri. Në radhë të parë kërkon mirënjohje e dhurim falas, domethënë një njohje të botës si dhuratë të marrë

prej dashurisë së Atit, që sjell si rrjedhojë gatishmëri falas për të hequr dorë dhe gjeste bujare edhe nëse askush nuk i sheh apo nuk i njeh: «Të mos dijë e majta çfarë bën e djathta [...] e Ati yt që sheh në fshehtësi, do ta shpërblejë» (Mt 6,3-4). Kërkon edhe vetëdijen plot dashuri se nuk jemi të ndarë prej krijesave të tjera, por se formojmë me qeniet e tjera të gjithësisë një bashkim të mrekullueshëm universal. Për besimtarin, bota nuk soditet nga jashtë por nga brenda, duke njohur lidhjet me të cilat Ati na ka bashkuar me të gjitha qeniet. Gjithashtu, duke i bërë të rriten aftësitë e posaçme që Hyji i ka dhënë secilit besimtar, kthimi ekologjik e bën atë të zhvillojë krijimtarinë e vet dhe entuziazmin e vet, me qëllim që të zgjidhë dramën e botës, duke iu kushtuar Hyjit «si fli e gjallë, e shenjtë dhe e pëlqyeshme» (Rom 12,1). Nuk e interpreton epërsinë e vet si arsye lavdërimi personal apo sundimi të papërgjegjshëm, por si një aftësi të ndryshme që nga ana e vet i jep një

përgjegjësi të madhe që rrjedh prej fesë së tij.

221. Disa bindje të fesë sonë, të zhvilluara në fillim të kësaj Enciklike, ndihmojnë që të pasurohet kuptimi i këtij kthimi, si vetëdija se çdo krijesë reflekton diçka të Hyjit dhe ka një mesazh për të na e përçaruar, apo siguria se Krishti e ka marrë në vetvete këtë botë materiale dhe tani, i ringjallur, banon në brendësinë e çdo qenieje, duke e rrethuar me dashurinë e vet dhe duke depërtuar në të me dritën e vet. Ashtu si edhe pranimi se Hyji e ka krijuar botën duke vënë në të një rend dhe një dinamizëm që qenia njerëzore nuk ka të drejtë ta shpërfillë. Kur lexojmë në Ungjill se Jezusi flet për zogjtë dhe thotë se «asnjërin prej tyre nuk e qet në harresë Hyji» (Lk 12,6), a do të jemi të aftë t'i keqtrajtojmë apo t'u bëjmë keq? I ftoj të gjithë të krishterët ta shprehin këtë përmasë të kthimit të tyre, duke lejuar që forca dhe drita e hirit që kanë marrë të përhapen edhe

në marrëdhënien me krijesat e tjera e me botën që i rrethon, dhe të nxisë atë vëllazëri sublime me gjithë botën e krijuar të cilën shën Françesku i Asizit e jetoi në mënyrë aq të ndritshme.

IV. GËZIMI DHE PAQJA

222. Përshpirtëria e krishterë propozon një mënyrë alternative të kuptimit të cilësisë së jetës, dhe nxit një stil jete profetike e soditëse, të aftë të gëzohet thellësisht pa qenë të obsesionuar nga konsumi. Është e rëndësishme të pranojmë një mësim të hershëm, të pranishëm në tradita të ndryshme fetare, si dhe në Bibël. Bëhet fjalë për bindjen se “më pak është më shumë”. Në të vërtetë, grumbullimi i vazhdueshëm i mundësive për të konsumuar e shpërquendron zemrën dhe pengon vlerësimin e çdo gjëje dhe të çdo momenti. Përkundrazi, të bëhemi të pranishëm kthjelltësisht para çdo realiteti, sado i vogël të jetë ai, na

hap shumë më tepër mundësi kuptimi dhe realizimi personal. Përshpirtëria e krishterë propozon një rritje në përkorë dhe një aftësi për të gëzuar me pak. Është një kthim në thjeshtësinë që na lejon të ndalemi e të shijojmë gjërat e vogla, të falënderojmë për mundësitë që jep jeta pa u lidhur me atë që kemi e pa u trishtuar për atë që nuk kemi. Kjo kërkon që ta shmangim dinamikën e sundimit dhe të grumbullimit të thjeshtë të kënaqësive.

223. Përkora, e jetuar me liri dhe vetëdije, është liruese. Nuk është më pak jetë, nuk është fuqi e vogël, por krejt e kundërta. Në të vërtetë, ata që e shijojnë më shumë dhe e jetojnë më mirë çdo moment janë ata që reshtin së çukituri andej këndeje, duke kërkuar gjithmonë atë që nuk e kanë, dhe përjetojnë atë që do të thotë të çmosh çdo person dhe çdo gjë, mësojnë të familjarizohen me realitetet më të thjeshta dhe dinë të gëzojnë prej tyre. Në këtë mënyrë arrijnë t'i kufizojnë

nevojat e paplotësuara dhe pakësojnë lodhjen e ankthin. Mund të kemi nevojë për pak dhe të jetojmë shumë, sidomos kur jemi të aftë t'u japim hapësirë të tjerëve dhe gjejmë kënaqësi në takimet vëllazërore, në shërbim, në shfrytëzimin e karizmave tona, në muzikën dhe në artin, në kontaktin me natyrën, në lutjen. Lumturia kërkon që të dimë t'i kufizojmë disa nevoja që na trullosin, duke mbetur kështu të gatshëm për mundësitë e shumta që jep jeta.

224. Përkora dhe përvujtëria në shekullin e fundit nuk kanë gëzuar një konsideratë pozitive. Por kur dobësohet në mënyrë të përgjithësuar ushtrimi i ndonjë virtyti në jetën personale dhe shoqërore, kjo arrin të shkaktojë çekuilibre të shumta, edhe mjedisore. Prandaj nuk mjafton më të flasim vetëm për integritetin e ekosistemeve. Duhet të kemi guximin të flasim për integritetin e jetës njerëzore, të nevojës për të nxitur dhe për të bashkuar të gjitha vlerat e

mëdha. Zhdukja e përvujtërisë, në një qenie njerëzore tepër të entuziazmuar nga mundësia për të sunduar gjithçka pa asnjë kufizim, mundet vetëm ta dëmtojë shoqërinë dhe mjedisin. Nuk është e lehtë ta pjekim këtë përvujtëri dhe një përkorë të lumtur nëse bëhemi autonomë, nëse e përjashtojmë prej jetës sonë Hyjin dhe uni ynë zë vendin e tij, nëse besojmë se është subjektiviteti ynë ai që përcakton çfarë është e mirë dhe çfarë është e keqe.

225. Nga ana tjetër, asnjë person nuk mund të piqet në një përkorë të lumtur nëse nuk është në paqe me vetveten. Dhe një pjesë e një kuptimi të përshtatshëm të përrshpirtërisë përbëhet në zgjerimin e kuptimit tonë të paqes, që është shumë më tepër se mungesë lufte. Paqja e brendshme e personave është shumë e lidhur me kujdesin për ekologjinë dhe për të mirën e përbashkët, sepse, kur jetohet në mënyrë të njëmendtë, pasqyrohet në një stil jete të ekuilibruar

bashkë me një aftësi për mahnitje që çon në thellësinë e jetës. Natyra është plot me fjalë dashurie, por si do të mund t'i dëgjojmë ato në mes të zhurmës së vazhdueshme, të shpërqendrimit të përhershëm e të akthshëm, apo të kultit të të dukurit? Shumë persona përjetojnë një çekuilibër të thellë që i nxit t'i bëjnë gjërat me shpejtësi për t'u ndier të zënë, në një ngut të vazhdueshëm që nga ana e vet i bën të trondisin gjithçka që kanë përreth vetes. Kjo ndikon në mënyrën me të cilën trajtohet mjedisi. Një ekologi e tërësishme kërkon që të kushtohet pak kohë për të rifituar harmoninë e kthjellët me botën e krijuar, për të reflektuar mbi stilin tonë të jetës dhe idealet tona, për të soditur Krijuesin, që jeton mes nesh dhe në gjithçka na rrethon, dhe prania e të cilit «nuk duhet të ndërtohet, por të zbulohet».^[155]

226. Jemi duke folur për një qëndrim të zemrës, që e jeton gjithçka me vëmendje të kthjellët, që di të mbetet plotësisht i pranishëm para dikujt pa

ndenjur duke menduar për atë që vjen më pas, që i dorëzohet çdo momenti si dhuratë hyjnore për t'u jetuar në plotësi. Jezusi na mësonte këtë qëndrim kur na ftonte të shihnim lilat e fushës dhe zogjtë e qiellit, ose kur, në prani të një njeriu në kërkim, «e shikoi ëmbël» dhe «i pëlqeu» (Mk 10,21). Ai dinte të rrinte plotësisht i pranishëm para çdo qenieje njerëzore dhe para çdo krijese, e kështu na ka treguar një rrugë për ta kapërcyer ankthin e sëmurë që na bën sipërfaqësorë, agresivë dhe konsumistë të shfrenuar.

227. Një shprehje e këtij qëndrimi është të ndalurit për të falënderuar Hyjin para dhe pas vakteve. U propozoj besimtarëve që ta rimarrin këtë zakon të çmueshëm dhe ta jetojnë atë me thellësi. Ky moment i bekimit, edhe pse shumë i shkurtër, na kujton varësinë tonë prej Hyjit për jetën, forcon ndjenjën tonë të mirënjohjes për dhuratat e krijimit, është mirënjohës ndaj atyre që me punën e

tyre i sigurojnë këto të mira, dhe forcon solidaritetin me më nevojtarët.

V. DASHURIA CIVILE DHE POLITIKE

228. Kujdesi për natyrën është pjesë e një stili jete që përmban aftësinë për të jetuar së bashku dhe aftësinë për bashkim. Jezusi na ka kujtuar se e kemi Hyjin si Atin tonë të përbashkët dhe se kjo na bën vëllezër. Dashuria vëllazërore mund të jetë vetëm falas, nuk mundet kurrë të jetë një shpërblim për atë që dikush tjetër realizon, as një hershim për atë që shpresojmë të bëjë. Prandaj është e mundur t'i duam armiqtë. Po ky dhurim falas na bën të duam dhe të pranojmë erën, diellin apo retë, megjithëse nuk i nënshtrohen kontrollit tonë. Prandaj mund të flasim për një *vëllazëri universale*.

229. Duhet të ndiejmë përsëri se kemi nevojë për njëri-tjetrin, se kemi një përgjegjësi ndaj të tjerëve dhe ndaj botës, se ia vlen të jemi të mirë dhe të

ndershëm. Tashmë tepër gjatë kemi qenë në degradim moral, duke vënë në lojë etikën, mirësinë, fenë, ndershmërinë, dhe ka ardhur momenti ta pranojmë se kjo sipërfaqësi e hareshme nuk na ka hyrë në punë. Ky shkatërrim i çdo themeli të jetës shoqërore arrin të na vërë njërin kundër tjetrit për të mbrojtur interesat tona, shkakton lindjen e formave të reja të dhunës e mizorisë dhe pengon zhvillimin e një kulture të re të kujdesit për mjedisin.

230. Shembulli i shenjtës Terezë të Lisieux na fton në praktikën udhës së vogël të dashurisë, që të mos e humbim rastin për një fjalë të sjellshme, për një buzëqeshje, për çfarëdo gjesti të vogël që mbjell paqe e miqësi. Një ekologji integrale është e përbërë edhe prej gjestesh të thjeshta të përditshme në të cilat e thejmë logjikën e dhunës, të shfrytëzimit, të egoizmit. Anasjelltas, bota e konsumit të tepruar është në të njëjtën kohë bota e keqtrajtimit të jetës

në çdo formë të saj.

231. Dashuria, plot me gjeste të vogla kujdesi të ndërsjellë, është edhe civile e politike, dhe dëftohet në të gjitha veprimet që përpiqen të ndërtojnë një botë më të mirë. Dashuria për shoqërinë dhe angazhimi për të mirën e përbashkët janë një formë e shkëlqyer dashurie, që ka lidhje jo vetëm me marrëdhëniet mes individëve, por edhe me «makro-marrëdhëniet, marrëdhëniet shoqërore, ekonomike, politike».^[156] Prandaj Kisha i ka propozuar botës idealin e një «qytetërimi të dashurisë».^[157] Dashuria shoqërore është çelësi i një zhvillimi të njëmendtë: «Për ta bërë shoqërinë më njerëzore, më të denjë për personin, duhet të rivlerësojmë dashurinë në jetën shoqërore – në nivel politik, ekonomik, kulturor – duke e bërë atë normën e vazhdueshme dhe supreme të veprimit».^[158] Në këtë kuadër, së bashku me rëndësinë e gjesteve të vogla të përditshme, dashuria shoqërore na nxit të mendojmë për strategji të mëdha që e

ndalojnë në mënyrë efikase degradimin mjedisor dhe nxisin një *kulturë të kujdesit* që e mbush gjithë shoqërinë. Kur dikush pranon thirrjen e Hyjit për të ndërhyrë së bashku me të tjerë në këto dinamika shoqërore, duhet të kujtojë se ajo bën pjesë në përshpirtërinë e saj, që është ushtrim i dashurisë, dhe që në këtë mënyrë piqet e shenjtërohet.

232. Jo të gjithë janë të thirrur të punojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë në politikë, por në gjirin e shoqërisë lulëzon një larmi e panumërt shoqatash që ndërhyjnë në dobi të së mirës së përbashkët, duke mbrojtur mjedisin natyror dhe urban. Për shembull, shqetësohen për një vend publik (një ndërtesë, një shatërvan, një monument i braktisur, një peizash, një shesh), për të mbrojtur, shëruar, përmirësuar apo zbukuruar diçka që është e të gjithëve. Përreth tyre zhvillohen apo rekuperohen lidhjet dhe lind një jetë e re shoqërore lokale. Kështu një bashkësi lirohet prej

mospërfilljes konsumistike. Kjo do të thotë edhe të kultivojmë një identitet të përbashkët, një histori që ruhet dhe përçohet. Në këtë mënyrë kujdesemi për botën dhe për cilësinë e jetës së më të varfërve, me një ndjenjë solidariteti që është në të njëjtën kohë vetëdije se banojmë në një shtëpi të përbashkët që Hyji na e ka besuar. Këto veprime bashkësiore, kur shprehin një dashuri që dhurohet, mund të shndërrohen në përvoja të forta shpirtërore.

VI. SHENJAT SAKRAMENTALE DHE PUSHIMI KREMTUES

233. Gjithësia zhvillohet në Hyjin, që e mbush krejt atë. Pra, ka një mister për ta soditur në një gjethe, në një shteg, në vesën, në fytyrën e një të varfri.^[159] Ideali nuk është vetëm të kalojmë nga e jashtëmja në të brendshmen për të zbuluar veprimin e Hyjit në shpirt, por edhe të arrijmë ta takojmë në të gjitha gjërat, siç mësonte shën Bonaventura:

«Sa më shumë që njeriu të ndiejë në vetvete efektin e hirit hyjnor apo sa më shumë të dijë të njohë Hyjin në krijesat e tjera aq më e lartë është soditja».^[160]

234. Shën Gjoni i Kryqit mësonte se gjithçka që është e mirë në gjërat dhe në përvojat e botës «gjendet që në fillim në Hyjin në mënyrë të pafundme, ose, më mirë të themi, Ai është secila prej këtyre madhështive që predikohen». ^[161] Nuk është sepse gjërat e kufizuara të botës janë realisht hyjnore, por sepse mistiku përjeton lidhjen e brendshme që ekziston mes Hyjit dhe të gjitha qenieve, e kështu «ndien se Hyji është për të të gjitha gjërat». ^[162] Nëse admiron madhështinë e një mali, nuk mund ta ndajë këtë prej Hyjit, dhe percepton se ky admirim i brendshëm që ai jeton duhet të vihet në Zotin: «Malet kanë disa maja, janë të larta, madhështore, të bukura, të hijshme, të lulëzuara dhe erëmira. Si ato male është i Dashuri për mua. Luginat e vetmuara janë të qeta, të këndshme,

të freskëta, me hije, të pasura me ujëra të ëmbla. Për larminë e pemëve të tyre dhe për këngën e këndshme të zogjve e çlodhin dhe e kënaqin shumë shqisën dhe në vetminë e tyre e në heshtjen e tyre japin freski e pushim: si këto lugina është i Dashuri im për mua».^[163]

235. Sakramentet janë një mënyrë e privilegjuar në të cilën natyra merret prej Hyjit dhe shndërrohet në ndërmjetësim të jetës mbinatyrore. Nëpërmjet kultit jemi të ftuar ta përqafojmë botën në një plan të ndryshëm. Uji, vaji, zjarri dhe ngjyrat merren me gjithë forcën e tyre simbolike dhe trupëzohen në lavdin. Dora që bekon është mjet i dashurisë së Hyjit dhe refleks i afërsisë së Krishtit që ka ardhur të na shoqërojë në ecjen e jetës. Uji që derdhet mbi kokën e fëmijës që pagëzohet është shenjë e jetës së re. Nuk ikim prej botës dhe as nuk e mohojmë natyrën kur duam të takohemi me Hyjin. Kjo mund të perceptohet veçanërisht në përshpirtërinë e Lindjes së krishterë:

«Bukuria, që në Lindje është një prej emrave me të cilët më shpesh është zakon të shprehet harmonia hyjnore dhe modeli i njerëzimit të shndërruar, dëftohet kudo: në format e tempullit, në tingujt, në ngjyrat, në dritat dhe në erërat e mira».^[164] Për përvojën e krishterë, të gjitha krijesat e gjithësisë materiale e gjejnë kuptimin e tyre të vërtetë në Fjalën e mishëruar, sepse Biri i Hyjit e ka trupëzuar në personin e vet një pjesë të gjithësisë materiale, ku ka shtënë një syth të shndërrimit përfundimtar: «Krishterimi nuk e refuzon lëndën, trupësinë; përkundrazi, e vlerëson atë plotësisht në aktin liturgjik, në të cilin trupi njerëzor dëfton natyrën e vet të brendshme si tempull i Shpirtit dhe arrin të bashkohet me Zotin Jezus, edhe Ai i bërë me trup për shpëtimin e botës».¹⁶⁵

236. Në Eukaristi bota e krijuar gjen lartësimin e vet më të madh. Hiri, që priret të dëftohet në mënyrë të ndjeshme, arrin një shprehje të mrekullueshme kur vetë Hyji, i bërë njeri, arrin të lejojë të

hahet prej krijesës së tij. Zoti, në kulmin e misterit të Mishërimit, deshi të arrinte brendësinë tonë nëpërmjet një fragmenti lënde. Jo nga lart, por nga brenda, me qëllim që në vetë botën tonë të mund të takonim Atë. Në Eukaristi është realizuar tashmë plotësia, dhe është qendra jetësore e gjithësisë, qendra plot e përplot me dashuri dhe jetë të pashtershme. I bashkuar me Birin e mishëruar, të pranishëm në Eukaristi, i gjithë kozmosi falënderon Hyjin. Në të vërtetë Eukaristia është në vetvete një akt dashurie kozmike: «Po, kozmike! Sepse edhe kur kremtohet në altarin e vogël të një kishe fshati, Eukaristia gjithmonë kremtohet, në njëfarë kuptimi, në altarin e botës».^[166] Eukaristia bashkon qiellin e tokën, përfaqon dhe depërton në gjithë botën e krijuar. Bota, që ka dalë prej duarve të Hyjit, kthehet te Ai në adhurim të gëzueshëm e të plotë: në Bukën eukaristike «krijimi është i prirur drejt hyjnizimit, drejt dasmës së shenjtë, drejt njësimimit me vetë Krijuesin».^[167]

Prandaj Eukaristia është edhe burim drite e motivimi për shqetësimet tona për mjedisin, dhe na orienton për të qenë rojtarë të të gjithë botës së krijuar.

237. Të dielën, pjesëmarrja në Eukaristi ka një domethënie të veçantë. Kjo ditë, ashtu sikurse e shtuna hebraike, ofrohet si ditë e shërimit të marrëdhënieve të qenies njerëzore me Hyjin, me vetveten, me të tjerët dhe me botën. E diela është dita e Ringjalljes, “e para ditë” e krijimit të ri, fryti i parë i të cilit është njerëzimi i ringjallur prej Zotit, garanci e shndërrimit përfundimtar të të gjithë realitetit të krijuar. Gjithashtu, kjo ditë lajmëron «pushimin e amshuar të njeriut në Hyjin».^[168] Në këtë mënyrë, përshtypshëm e krishterë integron vlerën e pushimit dhe të festës. Qenia njerëzore priret ta kufizojë pushimin soditës në nivelin e të shterpës e të kotës, duke harruar se kështu i hiqet veprës që kryhet gjëja më e rëndësishme: domethënia e saj. Jemi të thirrur të përfshijmë në

veprimin tonë një përmasë marrëse dhe falas, që është e ndryshme nga një joveprimtari e thjeshtë. Bëhet fjalë për një mënyrë tjetër të vepruari që bën pjesë në thelbin tonë. Në këtë mënyrë veprimi njerëzor mbrohet jo vetëm nga një aktivizëm i zbrazët, por edhe nga grykësia e shfrenuar dhe nga izolimi i ndërgegjes që e bën njeriun të kërkojë vetëm përfitimin personal. Ligji i pushimit javor kërkonte që të hiqej dorë nga puna të shtatën ditë, «që të pushojë kau e gomari yt, të marrë frymë djali i shërbëtores sate dhe i huaji» (*Dal 23,12*). Pushimi është një zgjerim i vështimit që lejon të kthehemi për të njohur të drejtat e të tjerëve. Kështu, dita e pushimit, qendra e së cilës është Eukaristia, e përhap dritën e vet mbi krejt javën dhe na nxit ta bëjmë tonin kujdesin për natyrën dhe për të varfrit.

VII. TRINIA DHE MARRËDHËNIA MES KRIJESAVE

238. Ati është burimi i fundit i gjithçkaje, themeli i harmonishëm dhe komunikues i gjithçkaje që ekziston. Biri, që e reflekton, dhe nëpërmjet të cilit gjithçka është krijuar, u bashkua me këtë tokë kur mori formë në kraharorin e Marisë. Shpirti, peng i pafund dashurie, është intimisht i pranishëm në zemrën e gjithësisë duke frymëzuar e nxitur ecje të reja. Bota është krijuar prej tri Vetave si parim i vetëm hyjnor, por secila prej tyre e realizon këtë vepër të përbashkët sipas identitetit të vet personal. Prandaj, «kur sodisim me admirim gjithësinë në madhësinë dhe bukurinë e saj, duhet të lëvdojmë gjithë Trininë».^[169]

239. Për të krishterët, të besosh në një Hyj të vetëm që është bashkësi trinitare të çon të mendosh se i gjithë realiteti përmban në vetvete një gjurmë vërtet trinitare. Shën Bonaventura arriti të

pohonte se qenia njerëzore, para mëkatit, mund të zbulonte se si çdo krijesë «dëshmon se Hyji është trini». Refleksi i Trinisë mund të njihej prej natyrës «kur as ai libër nuk ishte i pakuptueshëm për njeriun, as syri i njeriut nuk ishte i mjegulluar».^[170] Shenjti françeskan na mëson se *çdo krijesë ka në vetvete një strukturë vërtet trinitare, aq reale sa do të mund të plotësohej vetvetiu nëse vështrimi i qenies njerëzore nuk do të ishte i kufizuar, i errët dhe i brishtë. Në këtë mënyrë na tregon sfidën që të provojmë ta lexojmë realitetin në kuptimin trinitar.*

240. Vetat hyjnore janë marrëdhënie subsistente, dhe bota, e krijuar sipas modelit hyjnor, është një rrjet marrëdhëniesh. Krijesat priren drejt Hyjit, dhe nga ana e vet, është karakteristikë e çdo qenieje njerëzore të priret drejt një gjëje tjetër, në mënyrë të tillë që në gjirin e gjithësisë mund të takojmë marrëdhënie të panumërta

e të vazhdueshme që gërshetohen në mënyrë të fshehtë^[171]. Kjo jo vetëm na fton të admirojmë lidhjet e shumta që ekzistojnë mes krijesave, por na bën edhe të zbulojmë një çelës të realizimit tonë. Në të vërtetë, personi njerëzor, sa më shumë rritet, piqet dhe shenjtërohet, aq më shumë hyn në marrëdhënie, kur del prej vetvetes për të jetuar në bashkim me Hyjin, me të tjerët dhe me të gjitha krijesat. Kështu merr në ekzistencën e vet atë dinamizëm trinitar që Hyji e ka ngulitur në të që prej krijimit të tij. Gjithçka është e lidhur, dhe kjo na fton të pjekim një përshpirtëri të solidaritetit global që buron prej misterit të Trinisë.

VIII. MBRETËRESHA E GJITHË BOTËS SË KRIJUAR

241. Maria, nëna që u kujdes për Jezusin, tani kujdeset me dashuri e dhimbje amënore për këtë botë të plagosur. Ashtu sikurse qau me zemër të shporuar për vdekjen e Jezusit, tani ka

dhembshuri për vuajtjen e të varfërve të kryqëzuar dhe për krijesat e kësaj bote të shfarosura nga pushteti njerëzor. Ajo jeton me Jezusin krejtësisht e shndërruar, dhe të gjitha krijesat i këndojnë bukurisë së saj. Është gruaja «e veshur me diell, me hënë nën këmbë, në kokë kezën me dymbëdhjetë yje» (Zb 12,1). E ngritur në qiell, është Nëna dhe Mbretëresha e gjithë botës së krijuar. Në trupin e saj të lavdëruar, së bashku me Krishtin e ringjallur, një pjesë e krijimit ka arritur gjithë plotësinë e bukurisë së vet. Ajo jo vetëm ruan në zemrën e vet gjithë jetën e Jezusit, që «i mbante» me kujdes (krh. Lk 2,19.51), por tani edhe kupton domethënien e të gjitha gjërave. Prandaj mund t'i kërkojmë që të na ndihmojë ta shikojmë këtë botë me sy më të ditur.

242. Së bashku me të, në familjen e shenjtë të Nazaretit, del në pah figura e shën Jozefit. Ai u kujdes dhe i mbrojti Marinë e Jezusin me punën e tij dhe praninë e tij bujare, dhe i liroi nga dhuna

e të padrejtëve duke i çuar në Egjipt. Në Ungjill shfaqet si një njeri i drejtë, punëtor, i fortë. Por prej figurës së tij del në pah edhe një ëmbëlsi e madhe, që nuk është karakteristike e atij që është i dobët por i atij që është me të vërtetë i fortë, i vëmendshëm ndaj realitetit për të dashur dhe shërbyer përvujtërisht. Prandaj është shpallur rojtar i Kishës së gjithëmbarshme. Edhe ai mund të na mësojë të kemi kujdes, mund të na motivojë të punojmë me bujari dhe ëmbëlsi për ta mbrojtur këtë botë që Hyji na e ka besuar.

IX. PËRTEJ DIELLIT

243. Në fund do të takohemi faqe faqas me bukurinë e pafundme të Hyjit (krh. *1 Kor* 13,12) dhe do të mund të lexojmë me admirim të hareshëm misterin e gjithësisë, që do të marrë pjesë së bashku me ne në plotësinë e pa fund. Po, jemi duke udhëtuar drejt së shtunës së amshimit, drejt Jerusalemit të

ri, drejt shtëpisë së përbashkët të qiellit. Jezusi na thotë: «Ja, unë i bëj të reja të gjitha gjërat» (Zb 21,5). Jeta e pasosur do të jetë një mrekulli e bashkëndarë, ku çdo krijesë, e shndërruar në mënyrë të ndritshme, do të zërë vendin e vet dhe do të ketë diçka për t'u dhënë të varfërve përfundimisht të liruar.

244. Në pritje, le të bashkohemi për të marrë përsipër këtë shtëpi që na është besuar, duke e ditur se ajo e mirë që është në të do të merret në festën e qiellit. Së bashku me të gjitha krijesat, le të ecim mbi këtë tokë duke kërkuar Hyjin, sepse «nëse bota ka një fillim dhe është krijuar, kërkon atë që e ka krijuar, kërkon atë që i ka dhënë fillesë, atë që është Krijuesi i saj». ^[172] Le të ecim duke kënduar! Betejat tona dhe shqetësimi ynë për këtë planet të mos na e heqin gëzimin e shpresës.

245. Hyji, që na thërret në përkushtimin bujar dhe që të japim gjithçka, na jep forcat dhe dritën për të cilat kemi nevojë

që të ecim përpara. Në zemrën e kësaj bote mbetet gjithmonë i pranishëm Zoti i jetës që na do shumë. Ai nuk na braktis, nuk na lë vetëm, sepse është bashkuar përfundimisht me tokën tonë, dhe dashuria e tij na bën gjithmonë të gjejmë rrugë të reja. Atij i qoftë lavdi!

246. Pas këtij reflektimi të zgjatur, të gëzueshëm dhe dramatik njëkohësisht, po propozoj dy lutje, një që mund ta bashkëndajmë me të gjithë ata që besojnë në një Hyj krijues të gjithëpushtetshëm, dhe një tjetër që ne të krishterët të dimë të marrim përsipër angazhimet ndaj botës së krijuar që Ungjilli i Jezusit na propozon.

Lutja për tokën tonë

O Hyj i Gjithëpushtetshëm,
që je i pranishëm në krejt gjithësinë
dhe në më të voglën ndër krijesat e tua,
Ti që rrethon me dashurinë tënde

gjithçka që ekziston,
na e jep forcën e dashurisë tënde
në mënyrë që të kujdesemi
për jetën dhe për bukurinë.
Na mbush me paqe, që të jetojmë si
vëllezër e motra pa i bërë dëm askujt.
O Hyj i të varfërve,
na ndihmo t'i lirojmë të braktisurit
dhe të harruarit e kësaj toke
të cilët vlejné para syve të tu.
Shëroje jetën tonë,
që ta mbrojmë botën dhe të mos e
grabisim atë, që të mbjellim bukuri
dhe jo ndotje e shkatërrim.
Preki zemrat e atyre që kërkojnë vetëm
përfitime në dëm të të varfërve dhe të
tokës.
Na mëso të zbulojmë vlerën e çdo gjëje,
të sodisim me mahnitje, të pranojmë se
jemi thellësisht të bashkuar me të gjitha
krijesat në ecjen tonë drejt dritës tënde
të pafund.
Faleminderit sepse je me ne çdo ditë.
Na përkrah, të lutemi, në luftën tonë
për drejtësi, dashuri dhe paqe.

Lutja e krishterë me botën e krijuar

Po të të lëvdojmë, o Atë, me të gjitha krijesat e tua, që janë të bashkuara nga dora jote e fuqishme.

Janë tuat, dhe janë plot me praninë tënde dhe me ëmbëlsinë tënde.

Ti qofsh lëvduar!

O Bir i Hyjit, Jezus,

prej teje janë krijuar të gjitha gjërat.

Ke marrë formë në kraharorin amënor të Marisë, je bërë pjesë e kësaj toke, dhe e ke shikuar këtë botë me sy njerëzorë.

Sot je i gjallë në çdo krijesë me lavdinë tënde si i ringjallur.

Ti qofsh lëvduar!

O Shpirt Shenjt, që me dritën tënde e orienton këtë botë drejt dashurisë së Atit dhe shoqëron ofshamën e krijimit, edhe ti jeton në zemrat tona për të na nxitur nga e mira.

Ti qofsh lëvduar!

O Zot Hyj, Një e Trini,

bashkësi e mrekullueshme dashurie të

pafundme, na mëso të të sodisim
në bukurinë e gjithësisë, ku gjithçka na
flet për ty.

Zgjoje lavdin tonë dhe mirënjohjen tonë
për çdo qenie që ke krijuar.

Na dhuro hirin që të ndihemi të
bashkuar në mënyrë intime
me gjithçka që ekziston.

O Hyj i dashurisë, na e trego vendin
tonë në këtë botë si mjete të dashurisë
tënde për të gjitha qeniet e kësaj toke,
sepse as edhe një prej tyre nuk është e
harruar prej teje.

Ndriçoji ata që kanë në dorë pushtetin
dhe paratë që të mos bien në mëkatin
e mospërfilljes, ta duan të mirën e
përbashkët, t'i nxisin të dobtit,
dhe të kujdesen për këtë botë ku
banojmë.

Të varfrit dhe toka janë duke bërtitur:
O Zot, na merr ne me fuqinë tënde dhe
dritën tënde, për të mbrojtur çdo jetë,
për të përgatitur një të ardhme më të
mirë,
që të vijë Mbretëria jote

e drejtësisë, e paqes, e dashurisë dhe e
bukurisë.

Ti qofsh bekuar!

Amen.

*Dhënë në Romë, pranë Shën Pjetrit, më
24 maj, e Kremtja e Rrëshajëve, e vitit 2015,
i treti i Pontifikatit tim.*

Franciscus

- [1] Kënga e krijesave: Burime Françeskane (BF) 263.
- [2] Let. ap. Octogesima adveniens (14 maj 1971), 21: *AAS* 63 (1971), 416-417.
- [3] Fjalimi në FAO për 25-vjetorin (16 nëntor 1970), 4: *AAS* 62 (1970), 833.
- [4] Let. enc. Redemptor hominis (4 mars 1979), 15: *AAS* 71 (1979), 287.
- [5] Krh. Katekeza (17 janar 2001), 4: *Insegnamenti* 24/1 (2001), 179.
- [6] Let. enc. Centesimus annus (1 maj 1991), 38: *AAS* 83 (1991), 841.
- [7] *Ibid.*, 58: fq. 863.
- [8] Gjon Pali II, Let. enc. Sollicitudo rei socialis (30 dhjetor 1987), 34: *AAS* 80 (1988), 559.
- [9] Krh. Id., Let. enc. Centesimus annus (1 maj 1991), 37: *AAS* 83 (1991), 840.
- [10] Fjalimi drejtuar Trupit diplomatik të akredituar pranë Selisë së Shenjtë (8 janar 2007): *AAS* 99 (2007), 73.
- [11] Let. enc. Caritas in veritate (29 qershor 2009), 51: *AAS* 101 (2009), 687.
- [12] Fjalimi në Deutscher Bundestag, Berlin (22 shtator 2011): *AAS* 103 (2011), 664.
- [13] Fjalimi drejtuar klerit të Dioqezës së Bolzano-Bressanone (6 gusht 2008): *AAS* 100 (2008), 634.
- [14] Mesazhi për Ditën e lutjes për mbrojtjen e botës së krijuar (1 shtator 2012).
- [15] Fjalim në Santa Barbara, Kaliforni (8 nëntor 1997); krh. John Chryssavgis, *On Earth as in Heaven: Ecological Vision and Initiatives of Ecumenical*

Patriarch Bartholomew, Bronks, Nju Jork, 2012.

[16] *Ibid.*

[17] *Konferenca në Manastirin e Utstein*, Norvegji (23 qershor 2003).

[18] *Fjalimi «Global Responsibility and Ecological Sustainability: Closing Remarks»*, Takimi I i Halkit, Stamboll (20 qershor 2012).

[19] Toma nga Celano, *Vita prima di San Francesco*, XXIX, 81: BF 460.

[20] *Legenda Maior*, VIII, 6: BF 1145.

[21] Krh. Toma nga Celano, *Vita seconda di San Francesco*, CXXIV, 165: BF 750.

[22] Konferenca e Ileshkvinjve Katolikë të Afrikës së Jugut, *Pastoral Statement on the Environmental Crisis* (5 shtator 1999).

[23] Krh. *Përshëndetja drejtuar personilet të FAO-s* (20 nëntor 2014): AAS 106 (2014), 985.

[24] Konferenca V e Përgjithshme e Episkopatit Latino-amerikan dhe të Karaibeve, *Dokumenti i Aparecida-s* (29 qershor 2007), 86.

[25] Konferenca e Ileshkvinjve Katolikë të Filipineve, Letra baritore *What is Happening to our Beautiful Land?* (29 janar 1988).

[26] Konferenca Ileshkvore Boliviane, Letra baritore mbi mjedisin dhe zhvillimin njerëzor në Bolivi *El universo, don de Dios para la vida* (2012), 17.

[27] Krh. Konferenca Ileshkvore Gjermane. Komisioni për Punët Shoqërore, *Der Klimawandel: Brennpunkt globaler, intergenerationeller und ökologischer Gerechtigkeit* (shtator 2006), 28-30.

[28] Këshilli Papnor i Drejtësisë dhe Paqes, *Përmbledhja e Doktrinës Shoqërore të Kishës*, 483.

[29] *Katekeza (5 qershor 2013): Insegnamenti 1/1 (2013)*, 280.

[30] Ipeshkvinjtë e Rajonit Patagonia-Komahue (Argjentinë), *Mensaje de Navidad* (dhjetor 2009), 2.

[31] Konferenca e Ipeshkvinjve Katolikë të Shteteve të Bashkuara, *Global Climate Change: A Plea for Dialogue, Prudence and the Common Good* (15 qershor 2001).

[32] Konferenca V e Përgjithshme e Episkopatit Latinoamerikan dhe të Karaibeve, *Dokumenti i Aparecida-s* (29 qershor 2007), 471.

[33] Nxit. ap. *Evangelii gaudium* (24 nëntor 2013), 56: *AAS* 105 (2013), 1043.

[34] Gjon Pali II, *Mesazhi për Ditën Botërore të Paqes 1990*, 12: *AAS* 82 (1990), 154.

[35] Id., *Katekeza (17 janar 2001)*, 3: *Insegnamenti 24/1 (2001)*, 178.

[36] Gjon Pali II, *Mesazhi për Ditën Botërore të Paqes 1990*, 15: *AAS* 82 (1990), 156.

[37] *Katekizmi i Kishës Katolike*, 357.

[38] Krh. *Angelus në Osnabrück (Gjermani) me personat e paaftë, 16 nëntor 1980: Insegnamenti 3/2 (1980)*, 1232.

[39] Benedikti XVI, *Homelia për fillimin kremtor të shërbesës së Shën Pjetrit (24 aprile 2005): AAS* 97 (2005), 711.

[40] Krh. *Legenda Maior*, VIII, 1: *BF* 1134.

[41] *Katekizmi i Kishës Katolike*, 2416.

[42] Konferenca Ipeshkvore Gjermane, *Zukunft*

der Schöpfung – Zukunft der Menschheit. Erklärung der Deutschen Bischofskonferenz zu Fragen der Umwelt und der Energieversorgung (1980), II, 2.

[43] *Katekizmi i Kishës Katolike*, 339.

[44] *Hom. in Hexaemeron*, 1, 2, 10: PG 29, 9.

[45] *Komedia Hyjnore. Parajsa*, Kënga XXXIII, 145.

[46] Benedikti XVI, *Katekeza (9 nëntor 2005)*, 3: *Insegnamenti* 1 (2005), 768.

[47] Id., Let. enc. *Caritas in veritate* (29 qershor 2009), 51: *AAS* 101 (2009), 687.

[48] Gjon Pali II, *Katekeza (24 prill 1991)*, 6: *Insegnamenti* 14/1 (1991), 856.

[49] Katekizmi mëson se Hyji ka dashur të krijojë një botë në ecje deri në përsosurinë e saj të fundit, dhe se kjo kërkon praninë e papërsosurisë dhe të së keqes fizike: krh. *Katekizmi i Kishës Katolike*, 310.

[50] Krh. Konc. II Ekum. i Vat. Kusht. barit. *Gaudium et spes* mbi Kishën në botën bashkëkohore, 36.

[51] Toma i Akuinit, *Summa Theologiae* I, q. 104, neni 1, ad 4.

[52] Id., *In octo libros Physicorum Aristotelis expositio*, lib. II, lectio 14.

[53] Në këtë perspektivë vendoset ndihmesa e P. Teilhard de Chardin; krh. Pali VI, *Fjalim në një stabiliment kimik-farmaceutik (24 shkurt 1966)*: *Insegnamenti* 4 (1966), 992-993; Gjon Pali II, *Letër drejtuar të nderuarit Atë George V. Coyne (1 qershor 1988)*: *Insegnamenti* 11/2 (1988), 1715; Benedikti XVI, *Homelia në kremtimin e Mbrëmësore në Aosta*

(24 korrik 2009): *Insegnamenti* 5/2 (2009), 60.

[54] Gjon Pali II, *Katekeza* (30 janar 2002), 6: *Insegnamenti* 25/1 (2002), 140.

[55] Konferenca e Ipeshkvinjve Katolikë të Kanadasë. Komisioni i Punëve Shoqërore, Letra baritore “*You Love All That Exists... All Things Are Yours, God, Lover of Life*” (4 tetor 2003), 1.

[56] Konferenca e Ipeshkvinjve Katolikë të Japonisë, *Reverence for Life. A Message for the Twenty-First Century* (1 janar 2001), 89.

[57] Gjon Pali II, *Katekeza* (26 janar 2000), 5: *Insegnamenti* 23/1 (2000), 123.

[58] Id., *Katekeza* (2 gusht 2000), 3: *Insegnamenti* 23/2 (2000), 112.

[59] Paul Ricœur, *Philosophie de la volonté. 2. Finitude et Culpabilité*, Paris 2009, 216.

[60] *Summa Theologiae* I, q. 47, neni 1.

[61] *Ibid.*

[62] Krh. *ibid.*, neni 2, ad. 1; neni 3.

[63] *Katekizmi i Kishës Katolike*, 340.

[64] *Kënga e krijesave: BF* 263.

[65] Krh. Konferenca Kombëtare e Ipeshkvinjve të Brazilit, *A Igreja e a questão ecológica*, 1992, 53-54.

[66] *Ibid.*, 61.

[67] Nxiti. ap. *Evangelii gaudium* (24 nëntor 2013), 215: *AAS* 105 (2013), 1109.

[68] Krh. Benedikti XVI, Let. enc. *Caritas in veritate* (29 qershor 2009), 14: *AAS* 101 (2009), 650.

[69] *Katekizmi i Kishës Katolike*, 2418.

[70] Konferenca e Episkopatit Domenikan, Letra baritore *Sobre la relación del hombre con la*

naturaleza (15 mars 1987).

[71] Gjon Pali II, Let. enc. *Laborem exercens* (14 shtator 1981), 19: AAS 73 (1981), 626.

[72] Let. enc. *Centesimus annus* (1 maj 1991), 31: AAS 83 (1991), 831.

[73] Let. enc. *Sollicitudo rei socialis* (30 dhjetor 1987), 33: AAS 80 (1988), 557.

[74] *Fjalim drejtuar vendasve dhe campesinosve të Meksikës, Cuilapán* (29 janar 1979), 6: AAS 71 (1979), 209.

[75] *Homelia në Meshën e krentuar për bujqërit në Recife, Brazil* (7 korrik 1980), 4: AAS 72 (1980), 926.

[76] Krh. *Mesazhi për Ditën Botërore të Paqes 1990*, 8: AAS 82 (1990), 152.

[77] Konferenca Ipeshkvore Paraguajane, Letra baritore *El campesino paraguayo y la tierra* (12 qershor 1983), 2, 4, d.

[78] Konferenca Ipeshkvore e Zelandës së Re, *Statement on Environmental Issues*, Uellington (1 shtator 2006).

[79] Let. enc. *Laborem exercens* (14 shtator 1981), 27: AAS 73 (1981), 645.

[80] Për këtë arsye shën Justini mundi të fliste për «fara të Fjalës» në botë: krh. *II Apologia* 8, 1-2; 13, 3-6: PG 6,457-458; 467.

[81] Gjon Pali II, *Fjalim drejtuar përfaqësuesve të shkencës, të kulturës dhe të studimeve të larta në Universitetin e Kombeve të Bashkuara, Hiroshima* (25 shkurt 1981), 3: AAS 73 (1981), 422.

[82] Benedikti XVI, Let. enc. *Caritas in veritate*

(29 qershor 2009), 69: *AAS* 101 (2009), 702.

[83] Romano Guardini, *Das Ende der Neuzeit*, Uyrzburg 1965⁹, 87.

[84] *Ibid.*

[85] *Ibid.*, 87-88.

[86] Këshilli Papnor i Drejtësisë dhe i Paqes, *Përmbledhja e Doktrinës Shoqërore të Kishës*, 462.

[87] Romano Guardini, *Das Ende der Neuzeit*, 63-64.

[88] *Ibid.*, 64.

[89] Krh. Benedikti XVI, Let. enc. *Caritas in veritate* (29 qershor 2009), 35: *AAS* 101 (2009), 671.

[90] *Ibid.*, 22: fq. 657.

[91] Nxiti. ap. *Evangelii gaudium* (24 nëntor 2013), 231: *AAS* 105 (2013), 1114.

[92] Romano Guardini, *Das Ende der Neuzeit*, 63.

[93] Gjon Pali II, Let. enc. *Centesimus annus* (1 maj 1991), 38: *AAS* 83 (1991), 841.

[94] Krh. Deklarata *Love for Creation. An Asian Response to the Ecological Crisis*, Bashkëbisedim i nxitur nga Federata e Konferencave të Ipeshkvinjve të Azisë (Tagaytay, 31 janar - 5 shkurt 1993), 3.3.2.

[95] Gjon Pali II, Let. enc. *Centesimus annus* (1 maj 1991), 37: *AAS* 83 (1991), 840.

[96] Benedikti XVI, *Mesazhi për Ditën Botërore të Paqes 2010*, 2: *AAS* 102 (2010), 41.

[97] Id., Let. enc. *Caritas in veritate* (29 qershor 2009), 28: *AAS* 101 (2009), 663.

[98] Krh. Vinçenci i Lerinsit, *Commonitorium primum*, kap. 23: *PL* 50, 668: «Ut annis scilicet consolidetur, dilatetur tempore, sublimetur aetate».

- [99] Nr. 80: *AAS* 105 (2013), 1053.
- [100] Konc. II Ekum. i Vat, Kusht. barit. *Gaudium et spes* mbi Kishën në botën bashkëkohore, 63.
- [101] Krh. Gjon Pali II, Let. enc. *Centesimus annus* (1 maj 1991), 37: *AAS* 83 (1991), 840.
- [102] Pali VI, Let. enc. *Populorum progressio* (26 mars 1967), 34: *AAS* 59 (1967), 274.
- [103] Benedikti XVI, Let. enc. *Caritas in veritate* (29 qershor 2009), 32: *AAS* 101 (2009), 666.
- [104] *Ibid.*
- [105] *Ibid.*
- [106] *Katekizmi i Kishës Katolike*, 2417.
- [107] *Ibid.*, 2418.
- [108] *Ibid.*, 2415.
- [109] *Mesazhi për Ditën Botërore të Paqes 1990*, 6: *AAS* 82 (1990), 150.
- [110] *Fjalimi në Akademinë Papnore të Shkencave* (3 tetor 1981), 3: *Insegnamenti* 4/2 (1981), 333.
- [111] *Mesazhi për Ditën Botërore të Paqes 1990*, 7: *AAS* 82 (1990), 151.
- [112] Gjon Pali II, *Fjalimi në Asamblenë e 35-të të Përgjithshme të Shoqatës Mjekësore Botërore* (29 tetor 1983), 6: *AAS* 76 (1984), 394.
- [113] Komisioni Ipeshkvor i Baritores Shoqërore të Argjentinës, *Una tierra para todos* (qershor 2005), 19.
- [114] *Deklarata e Rios mbi mjedisin dhe zhvillimin* (14 qershor 1992), Parimi 4.
- [115] Nxiti. ap. *Evangelii gaudium* (24 nëntor 2013), 237: *AAS* 105 (2013), 1116.
- [116] Benedikti XVI, Let. enc. *Caritas in veritate*

(29 qershor 2009), 51: *AAS* 101 (2009), 687.

[117] Disa autorë kanë dëftuar vlerat që shpesh jetoohen, për shembull, në *villas, chabolas* apo *favelas* të Amerikës Latine: krh. Juan Carlos Scannone, S.J., «La irrupción del pobre y la lógica de la gratitud», en Juan Carlos Scannone y Marcelo Perine (edd.), *Irrupción del pobre y quehacer filosófico. Hacia una nueva racionalidad*, Buenos Aires 1993, 225-230.

[118] Këshilli Papnor i Drejtësisë dhe i Paqes, *Përmbledhja e Doktrinës Shoqërore të Kishës*, 482.

[119] Nxiti. ap. *Evangelii gaudium* (24 nëntor 2013), 210: *AAS* 105 (2013), 1107.

[120] *Fjalimi në Deutscher Bundestag*, Berlin (22 shtator 2011): *AAS* 103 (2011), 668.

[121] *Katekeza* (15 prill 2015): *L'Osservatore Romano*, 16 prill 2015, fq. 8.

[122] Konc. II Ecum. i Vat., Kusht. barit. *Gaudium et spes* mbi Kishën në botën bashkëkohore, 26.

[123] Krh. nr. 186-201: *AAS* 105 (2013), 1098-1105.

[124] Konferenca Ipeshkvore Portugeze, Letra baritore *Responsabilidade solidária pelo bem comum* (15 shtator 2003), 20.

[125] Benedikti XVI, *Mesazhi për Ditën Botërore të Paqes 2010*, 8: *AAS* 102 (2010), 45.

[126] *Deklarata e Rios mbi mjedisin dhe zhvillimin* (14 qershor 1992), Parimi 1.

[127] Konferenca Ipeshkvore Boliviane, Letra baritore mbi mjedisin dhe zhvillimin njerëzor në Bolivi *El Universo, don de Dios para la Vida* (2012), 86.

[128] Këshilli Papnor i Drejtësisë dhe i Paqes, *Energjia, Drejtësia dhe Paqja*, IV, 1, Qyteti i Vatikanit (2013), 56.

[129] Benedikti XVI, Let. enc. *Caritas in veritate* (29 qershor 2009), 67: *AAS* 101 (2009), 700.

[130] Nxiti. ap. *Evangelii gaudium* (24 nëntor 2013), 222: *AAS* 105 (2013), 1111.

[131] Këshilli Papnor i Drejtësisë dhe i Paqes, *Përmbledhja e Doktrinës Shoqërore të Kishës*, 469.

[132] *Deklarata e Rios mbi mjedisin dhe zhvillimin* (14 qershor 1992), Parimi 15.

[133] Krh. Konferenca Ipeshkvore Meksikane. Komisioni Ipeshkvor për Baritoren Shoqërore, *Jesucristo, vida y esperanza de los indígenas y campesinos* (14 janar 2008).

[134] Këshilli Papnor i Drejtësisë dhe i Paqes, *Përmbledhja e Doktrinës Shoqërore të Kishës*, 470.

[135] *Mesazhi për Ditën Botërore të Paqes 2010*, 9: *AAS* 102 (2010), 46.

[136] *Ibid.*

[137] *Ibid.*, 5: fq. 43.

[138] Benedikti XVI, Let. enc. *Caritas in veritate* (29 qershor 2009), 50: *AAS* 101 (2009), 686.

[139] Nxiti. ap. *Evangelii gaudium* (24 nëntor 2013), 209: *AAS* 105 (2013), 1107.

[140] *Ibid.*, 228: *AAS* 105 (2013), 1113.

[141] Krh. Let. enc. *Lumen fidei* (29 qershor 2013), 34: *AAS* 105 (2013), 577: «Drita e fesë, meqenëse është e bashkuar me të vërtetën e dashurisë, nuk është e huaj për botën materiale, sepse dashuria jetohej gjithmonë në trup e shpirt; drita e fesë është dritë e

mishëruar, që rrjedh prej jetës së ndritshme të Jezusit. Ajo ndriçon edhe lëndën, shpreson në rendin e saj, pranon se në të hapet një rrugëtim harmonie dhe kuptimi gjithnjë e më të gjerë. Vështrimi i shkencës merr kështu një dobi prej fesë: kjo e fton shkencëtarin të mbetet i hapur ndaj realitetit, në të gjithë pasurinë e tij të pashtershme. Feja zgjon ndjenjën kritike, pasi nuk e lejon kërkimin që të kënaqet me formulat e tij dhe e ndihmon të kuptojë se natyra është gjithmonë më e madhe. Duke ftuar në mrekullimin para misterit të botës së krijuar, feja i zgjeron horizontet e arsyes për ta ndriçuar më mirë botën që hapet para studimeve të shkencës».

[142] Nxit. ap. *Evangelii gaudium* (24 nëntor 2013), 256: *AAS* 105 (2013), 1123.

[143] *Ibid.*, 231: fq. 1114.

[144] *Das Ende der Neuzeit*, Uyrzburg 1965⁹, 66-67.

[145] Gjon Pali II, *Mesazhi për Ditën Botërore të Paqes 1990*, 1: *AAS* 82 (1990), 147.

[146] Benedikti XVI, Let. enc. *Caritas in veritate* (29 qershor 2009), 66: *AAS* 101 (2009), 699.

[147] Id., *Mesazhi për Ditën Botërore të Paqes 2010*, 11: *AAS* 102 (2010), 48.

[148] *Karta e Tokës*, Hagë (29 qershor 2000).

[149] Gjon Pali II, Let. enc. *Centesimus annus* (1 maj 1991), 39: *AAS* 83 (1991), 842.

[150] Id., *Mesazhi për Ditën Botërore të Paqes 1990*, 14: *AAS* 82 (1990), 155.

[151] Nxit. ap. *Evangelii gaudium* (24 nëntor 2013), 261: *AAS* 105 (2013), 1124.

[152] Benedikti XVI, *Homelia për fillimin kreator të shërbesës së Shën Pjetrit* (24 prill 2005): AAS 97 (2005), 710.

[153] Konferenca e Ipeshkvinjve Katolikë të Australisë, *A New Earth. The Environmental Challenge* (2002).

[154] Romano Guardini, *Das Ende der Neuzeit*, 72.

[155] Nxit. ap. *Evangelii gaudium* (24 nëntor 2013), 71: AAS 105 (2013), 1050.

[156] Benedikti XVI, Let. enc. *Caritas in veritate* (29 qershor 2009), 2: AAS 101 (2009), 642.

[157] Pali VI, *Mesazhi për Ditën Botërore të Paqes 1977*: AAS 68 (1976), 709.

[158] Këshilli Papnor i Drejtësisë dhe i Paqes, *Përmbledhja e Doktrinës Shoqërore të Kishës*, 582.

[159] Një mësues shpirtëror, Ali Al-Khawwas, duke nisur nga përvoja e tij, theksonte nevojën për të mos i ndarë tepër krijesat e botës nga përvoja e Hyjit në brendësi. Thoshte: «Pra nuk duhet t'i qortojmë me paragjykim njerëzit që kërkojnë ngazëllimin në muzikë e në poezi. Ka një “sekret” të hollë në secilën prej lëvizjeve dhe tingujve të kësaj bote. Fillestarët arrijnë të kuptojnë se çfarë thonë era që fryn, pemët që përkulen, uji që rrjedh, mizat që gumëzhijnë, dyert që kërcëllojnë, kënga e zogjve, pickimi i telave, fishkëllima e flautit, psherëtima e të sëmurëve, ofshama e të brengosurit...» (Eva De Vitray-Meyerovitch [bot.], *Anthologie du soufisme*, Paris 1978, 200.

[160] *In II Sent.*, 23, 2, 3.

- [161] *Cántico Espiritual*, XIV, 5.
- [162] *Ibid.*
- [163] *Ibid.*, XIV, 6-7.
- [164] Gjon Pali II, Let. ap. *Oriente lumen* (2 maj 1995), 11: *AAS* 87 (1995), 757.
- [165] *Ibid.*
- [166] Id., Let. enc. *Ecclesia de Eucharistia* (17 prill 2003), 8: *AAS* 95 (2003), 438.
- [167] Benedikti XVI, *Homelia në Meshën e Korpit të Krishtit* (15 qershor 2006): *AAS* 98 (2006), 513.
- [168] *Katekizmi i Kishës Katolike*, 2175.
- [169] Gjon Pali II, *Katekeza* (2 gusht 2000), 4: *Insegnamenti* 23/2 (2000), 112.
- [170] *Quaest. disp. de Myst. Trinitatis*, 1, 2, përf.
- [171] Krh. Toma i Akuinit, *Summa Theologiae* I, q. 11, neni 3; q. 21, neni 1, ad 3; q. 47, neni 3.
- [172] Bazili i Madh, *Hom. in Hexaemeron*, 1, 2, 6: *PG* 29, 8.